

TAHA MUDEVVER

**ISLAMI GJATË SHEKIJVE  
TË FUNDIT NË ANDALUZI  
DHE NË PERANDORINË  
OSMANE**

Shkup  
1415/1995

Titulli i originalit:  
TAHA EL-MUDEVVER  
"MEXHDUL-ISLAMI FIL-KURUNIL-EHIRETI  
FIL ANDALUS VE FIL MEMLEKETIL - UTHMANIJE"

Botuar nga:  
MATBA'ATUL - "ITTIHAD" - DAMASK

Përktheu:  
Muhamed MUSTAFA

CIP - Katalogizacija vo publikacija  
Narodna i univerzitetska biblioteka  
"Kliment Ohridski", Skopje

**El-Mudevver, Taha**

Islami gjatë shekujve të fundit në Andaluzi dhe në Perandorinë Osmane / Taha  
Mudevver ; përktheu Muhamed Mustafa. - Shkup :  
Logos-A, 1995. - 134 str. ; 27 sm. - (Biblioteka Historia)

Prevod na deloto: "Mexhdul-Islami fil-kurunil-ehireti fil Andalus ve fil  
memleketil-Uthmanije". - Fusnoti kon tekstot.

**ISBN 9989-601-17-8**

a) [panija - Istorija - 8-15 v. b)  
Osmanska imperija - Istorija - 13-19 v.

TAHA MUDEVVER  
**ISLAMI GJATË SHEKUJVE TË FUNDIT NË ANDALUZI  
DHE NË PERANDORINË OSMANE**

<b><i>KREU I PARË</i></b> .....	<b>13</b>
<b>PJESA E PARË</b> .....	<b>15</b>
DOBËSIMI I SHTETIT ISLAM ANDALUZIAN NË PERËNDIM _	15
<b>PJESA E DYTË</b> .....	<b>33</b>
ÇLIRIMET E FUNDIT ISLAME NË LINDJE .....	33
<b><i>KREU I DYTË</i></b> .....	<b>63</b>
<b>PJESA E PARË</b> .....	<b>65</b>
SI FILLOI EVROPA TË ZGJOHET .....	65
<b>PJESA E DYTË</b> .....	<b>81</b>
BASHKIMI EVROPIAN KUNDËR PERANDORISË OSMANE _	81
<b><i>KREU I TRETË</i></b> .....	<b>89</b>
SHKAQET E DOBËSIMIT TË SHTETIT OSMAN .....	91
<b><i>KREU I KATËRT</i></b> .....	<b>101</b>
<b>PJESA E PARË</b> .....	<b>103</b>
DEPËRTIMI I EVROPËS NË LINDJE .....	103
<b>PJESA E DYTË</b> .....	<b>121</b>
ÇËSHTJA ORIENTALE .....	121
<b>PËRFUNDIM</b> .....	<b>137</b>
KUR DO TA RIPËRTËRIJNË MUSLIMANËT FAMËN E TYE TË LARTË .....	137



*Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Falënderimi i takon All-llahut të Plotfuqishëm e të Lartmadhëruar, kurse paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të dërguarin Muhammed a.s.!

Vendosa që të sqaroj parimin e progresit të Perëndimit dhe dekadencën e Lindjes, posaçërisht të muslimanëve, në këtë vepër që titullohet *"Islami gjatë shekujve të fundit në Andaluzi dhe në Perandorinë osmane."* Gjithashtu do të cekë të vërtetat që i kam kuptuar gjatë studimit, hulumtimit dhe përsiatjes rreth Lindjes e Perëndimit, rezultatet që i kam arritur gjatë thellimit në brendinë e librave historikë të vjetër e të rinj dhe faktorët e progresit të Perëndimit dhe të dekadencës së Lindjes.

Do të përpiqem ta krahasoj vlerën e rilindjes islame me vlerën e rilindjes së popujve tjerë, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, për të sqaruar metodat, mënyrat dhe faktorët që e atribuojnë progresin e muslimanëve si të amshueshëm.

E lus All-llahun të më mundësojë një akt të tillë qëllimpastër dhe të më udhëzojë në rrugët e të vërtetave ngase shpresoj gjithmonë të zbuloj rrugën e vërtetë.

Ai është Udhëzues në rrugë të drejtë!

*Autori*



## DISA FJALË

Në këtë vepër autori detajisht bën fjalë për ditët e fundit të muslimanëve në Andaluzi dhe shkallën e progresit të tyre që e kanë arritur për shkak të zbatimit të mësimave të fesë së pastër që urdhëron në devotshmëri, mirëbërësi dhe ndalon të këqijat, derisa e kanë formuar shtetin islam në parajsën andaluziane e që koha nuk ka mundur ta fshijë deri më sot.

Ai gjithashtu cekë shkaqet e zhdukjes së atij autoriteti të lartë për shkak të zilisë, urrejtjes dhe devijimit nga qëllimet islame, të cilat i kanë praktikuar emirët, mbretërit dhe udhëheqësit që ishin të zhytur në kënaqësi e korrupsion dhe e kishin lënë pas dore çështjen e popullit të tyre derisa kanë luftuar mes vete, edhe pse ishin vëllezër të gjakut, fesë e rrjedhës, vetëm për shkak të sulltanatit të përkohshëm dhe çështjeve të pavlera. Gjendja e tillë u mundësoi armiqve që pritnin në kurthë t'i sulmojnë qytetet, t'i pushtojnë nga arabët pas një sundimi të gjatë e të frytshëm dhe t'i torturojnë e t'i vrasin muslimanët në mënyrë të pashembullt në historitë e popujve.

Pas një sqarimi të tillë me plot vuajtje e keqardhje, autori përqëndrohet në ditët e fundit të muslimanëve në Lindje, ku kish lulëzuar civilizimi i vendeve osmane për shkak të çlirimeve islame. Muslimanët kishin fuqi dhe autoritet aq shumë saqë i kishin frikuar shtetet e Evropës. Evropa kërkonte ndihmë prej tyre në një anë, dhe ndiente njëfarë frike në anën tjetër.

Civilizimi islam do të arrinte edhe në viset më të largëta të Evropës, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, Veri e Jug sikur të mbështeteshin mbretërit dhe sulltanët në All-llahun e Lartmadhëruar dhe në shenjtërinë e idesë islame gjatë depërtimeve, sundimit dhe zgjerimit të tyre.

Gjatë rrëfimit të ngjarjeve historike, autori i vë në pah edhe rezultatet negative të ndarjes, mosmarrëveshjes dhe të grindjes mes mbretërve dhe emirëve në një anë dhe braktisjes së mësimave fetare për drejtësinë dhe kontrollimin e epsheve dëmtuese në anën tjetër, gjë që ka shkaktuar humbjen e sulltanatit dhe pushtetit pas formimit dhe themelimit që zgjatën shekuj të tërë.

Jemi të bindur se autori dëshiron t'ua tërheq vëmendjen muslimanëve e ta ripërtërijë famën e tyre duke e cekur në veprën e tij fuqinë dhe autoritetin, ndarjen dhe amoralitetin dhe i nxitë ta rikthejnë famën e tyre, me shembuj dhe leksione nga historia e tyre e afërt.

Ky është shkaku që na shtyri ta botojmë këtë vepër të vlefshme historike në dobi të vëllezërve tanë.

Qëllimi ynë është ta fitojmë pëlqimin e All-llahut xh.sh.

*Botuesi*

## BIOGRAFIA E AUTORIT

Profesori i ndjerë, Taha Mudevver, autor i këtij libri, ka qenë një ndër zhurnalistët më të njohur arabë, bile ka qenë kryesues i një shkolle zhurnalistike që ka përgatitur shumë dijetarë të njohur në Siri dhe Liban.

I ndjeri kreu shkollën fillore në Bejrut kurse mësimet e larta në Universitetin e Stambollit, kur edhe kthehet në Bejrut. Në vitin 1910 ka qenë redaktor i gazetës "Er-re'jul-am", e cila ka luajtur rol të rëndësishëm në ngjarjet me të cilat ballafaqohej Shteti osman para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore.

Kështu, emri i të ndjerit fillon të shkëlqejë, përfiton autoritet të madh në Stamboll e Bejrut saqë bashkëkohanikët e tij konfirmonin se i ndjeri e ka arritur atë pozitë në qarqet e larta të Shtetit osman të cilën e gëzonte vetëm një numër i caktuar.

I ndjeri ka gëzuar autoritet të lartë në Shtetin osman deri në okupimin francez të Sirisë dhe Libanit, në vitin 1918. Ai me qëndrimin e tij trimëror kundër okupimit francez përfiton shumë simpatizues në Liban, kurse me artikujt e tij i nxiste ndjenjat e popullit. Për këtë shkak shpeshherë maltretohej kurse gazeta ndalohej.

Pas keqësimit të gjendjes nga presioni i francezëve në Liban, e transferon gazetën në Haleb, ku i ndihmon edhe vëllai i tij i ndjerë prof. Munir Mudevver. Pastaj kthehet në Bejrut ku

shoqërohet ngushtë me Ahmed Nami Begun, i cili, kur caktohet kryetar i Sirisë në vitin 1926, kërkon prej tij ta ritransferojë përsëri gazetën e tij në Damask. Ai ia plotësoi këtë dëshirë afër tre vjet me radhë ngase më vonë daljen e gazetës e ndalon qeveria e të ndjerit Taxhudin el-Husejnit.

Prej vitit 1929, i ndjeri largohet krejtësisht nga gazetaria dhe i qaset shkrimit të librave. Me kulturën e tij të lartë, me njohuritë e gjera dhe me lapsin e përpiktë boton disa libra tejet të rëndësishëm për bibliotekën arabe: "Rilindja arabe", "Socializmi në Islam", "Civilizimet dhe fetë" ndërsa librin "Islami gjatë shekujve të fundit në Andaluzi dhe në Perandorinë osmane" nuk arriti ta botojë për shkak të vdekjes së tij.

Sot, pasardhësit e tij e realizojnë dëshirën e babait të tyre të ndjerë me botimin e këtij libri të vlefshëm.

Mendimet që i shprehte Taha Mudevver në gazetën e tij arabe dhe në veprat e tij të vlefshme do ta ndriçojnë rrugën e gjeneratave të ardhshme në njohjen e civilizimit të stërgjyshërve të tyre, famën e popullit të tyre dhe do t'i nxisin të përfitojnë virtyt dhe nder.

Zoti e mëshiroftë të ndjerin dhe e zëvendësoftë me të tjerë që do të jenë gjithashtu të sinqertë, shkrimtarë besimtarë dhe dijetarë në vepër.

*Prof. Nasuf Babil*

**KREU I PARË**  
**PËRFUNDIMI I FAMËS SË ISLAMIT**



## **PJESA E PARË**

### **DOBËSIMI I SHTETIT ISLAM ANDALUZIAN<sup>1</sup> NË PERËNDIM**

Çdo shfletues i historisë së popujve muslimanë prej fillimit deri në fund të shek. X h, do të kuptojë nivelin e progresit të tyre, territorin e gjerë dhe parimet e civilizimit me dritën e të cilit është ndriçuar Perëndimi dhe ka përparuar ashtu siç e shohim sot.

Vlera e muslimanëve dhe përhapja e civilizimit të tyre, nuk mund të krahasohet në aspektin social, edukativ dhe tradicional me asnjë civilizim tjetër të mëparshëm si p.sh. me civilizimin e egjiptasve, persianëve dhe të romakëve, e nëse dëshiron të bindesh në këtë të vërtetë, mjafton t'i shikosh gjurmët e këtij civilizimi që ekzistojnë deri sot në Andaluzi. Ai i cili e lexon librin arkeologjik të Gustav Leopoldit me titull "Civilizimi arab", habitet që në fillim nga komentet dhe detajizimet e civilizimit arab-islam, edhe atë vetëm në Andaluzi. Këtë e vërteton çdo mendim dhe konkluzion të tij me piktura dhe fotografi që e mahnisin çdo musliman bashkëkohor dhe e pikëllojnë në të njëjtën kohë, ngase mahnitet me kronologjinë

---

<sup>1</sup>Spanja e sotme (përkthyesi).

dhe përkryerjen e gjurmëve arkeologjike të cilat i kanë lënë arabët në Andaluzi dhe janë të pakrahasueshme me ato të Evropës, përpos progresit dhe civilizimit të tij, kurse pikëllohet nga zhytja e muslimanëve në injorancë e dekadencë dhe nga braktisja e atij civilizimi famëlartë pas një kohe të shkurtë që ekziston në Spanjën e sotme - Andaluzinë e djeshme.

Ndoshta lexuesi habitet pse e argumentojmë vetëm me librin e Leopoldit civilizimin dhe progresin e popullit musliman, e jo me libra të tjerë, vetëm e vetëm të shohim se çka shkruajnë të huajt dhe si e argumentojnë progresin e muslimanëve, përkryerjen dhe qytetërimin e tyre.

Historia dhe historianët nuk e kanë kthyer anash interesimin e tyre nga hulumtimi i këtij civilizimi famëlartë, pra i gjenë të gjitha historitë islame dhe evropiane përplot informata për civilizimin islam dhe famën e tij të madhe që e kanë përhapur muslimanët me intelektet dhe me mësimet e fesë së tyre të pastër.

Sikur të dëshironim t'i cekim shkollat të cilat i kanë ndërtuar muslimanët në Andaluzi, bibliotekat shkencore, institutet fetare e letrare, do të përpilonim libra të mëdhenj. Mjafton të cekim vetëm një pjesë të vogël, prej të cilës lexuesi mund të kuptojë madhësinë e këtij populli që shtrihej në tre kontinente nën flamurin e paqes dhe të drejtësisë, pra në Evropë, Azi dhe Afrikë, kur kontinentet tjera ishin ende të pazbuluara.

Sipërfaqja e territorit të tyre i ka tejkaluar muret, kodrat dhe luginat, në mënyrë të pakrahasueshme me ndonjë shtet tjetër. Perandoria islame, prej vitit 30-657 hixhri kishte 12.000.000 milje katrorë, apo prej Kine nëpër Tibet, Indi, Turkmeni, Afganistan, Persi, Azi të Vogël, Siujdhesën Arabe, Egjipt,

bregdetin e Afrikës Veriore, Bengazi deri në Gjibraltar<sup>2</sup>, si në Lindje e Perëndim ashtu edhe në Veri e Jug, p.sh. prej vendeve më të largëta të Etiopisë, Sudanit, Saharës së Madhe dhe asaj të Vogël, luginës së Nilit, Anadollisë, Algjerit të Detit Mesdhe, gjysmës së Italisë, Spanjës, Portugalisë deri në Francën Jugore, pastaj gjatë periudhës së Perandorisë osmane Islami ishte përhapur edhe në Greqi, në ujdhesat e Arkipelagut, Bizant ose në shtetin Romak, Maqedoni, Serbi, Malin e Zi, Moldavi, Bullgari, deri në Vjenën e Austrisë, pastaj në veri të Anadollit, në malet e Kaukazit, në vendet e tatarëve në pjesën jugore të mbretërisë ruse dhe në Poloni.

Këto ishin territoret e vendeve islame në fillim dhe në mes të periudhës së çlirimeve, kjo ishte edhe fuqia e tyre e mbështetur në drejtësi dhe njohje.

Tash na mbetet ta cekim dobësimin dhe dekadencën e muslimanëve si dhe shkaqet e një gjendjeje të këtillë. Nuk kemi ndërmarrur ndonjë hap të caktuar rreth parimit të famës islame, vendosjes së muslimanëve dhe ndikimit të tyre në botë e as që i kemi cekur shkaqet dhe faktorët që ua lehtësuan muslimanëve distribuimin e civilizimi të tyre.

\* \* \*

Pasi që pak më parë cekëm progresin e Shtetit islam në Andaluzi, njeriu habitet me dekadencën dhe dobësimin e një shteti të fuqishëm islam në Andaluzi dhe me të drejtë vajton me lotë të përgjakur atë famë të lartë që u bë viktimë e injorancës, mosinteresimit të emirëve muslimanë, përçarjeve, luftërave dhe copëtimeve të brendshme derisa papritmas i sulmojnë armiqtë,

---

<sup>2</sup>Ka për qëllim Tripolin, Tunizin dhe Marokon.

ua uzurpojnë faltoret, ua marrin atë që ata e kanë civilizuar, ndërtuar dhe reformuar, i dëbojnë, xhamitë i shndërrojnë në kisha dhe i shfrytëzojnë pallatet e tyre të mëdha, kurse muslimanët e ndarë rrënkoin dhe u vetëdijësuan se sikur të mos vepronin ashtu, sikur të mos ishin ndarë e përçarë as nuk do t'ua mundësonin armiqve okupimin e vendeve të tyre dhe shkatërrimin e civilizimit të tyre që i kishin fituar me përpjekje të mëdha. Ata u penduan por vonë ngase Andaluzia me pasuritë, pallatet dhe institutet e saj kaloi në duart e francezëve. Ata e kanë rikthyer vendin e tyre por jo ashtu siç e kishin lënë. Spanjollët atë e braktisën si shkretëtirë të thatë me qytete të shkatërruara, kurse pas kthyerjes së tyre gjetën kopshte dhe parqe me lumenj si në xhennet (parajsë), fushat e tyre i gjetën pjellore dhe të frytshme, fshatrat u ngjanin qyteteve si dhe pallate të reja të pakrahasueshme deri më sot: hamame, xhami, institute dhe shkolla...!

Muslimanët e vërejnë gjendjen e tyre të mjerë dhe për herë të parë e kuptojnë dëmin e madh që ua kanë shkaktuar vendasit e mëparshëm. Kështu ata vajtojnë me të madhe, thurin elegji dhe nuk gjejnë në vete fuqi të mjaftueshme për mëkëmbje ngase ishin të përçarë dhe pas pak kohe zhyten në gjumë, dekadencë, injorancë sikur të mos kishin humbur kurrëgjë - si dhe sikur të mos kishte ndodhur ndonjë katastrofë.

Arabët muslimanë pas largimit nga Andaluzia fillojnë të kërkojnë fuqi për ta rikthyer pasurinë e tyre por nuk e gjejnë dot.

Mjerë për popullin i cili pasi që e ka tronditur tokën me ushtarët dhe kalorësit e tij dhe ka çliruar qytete e shtete, vetëdijësohet pas humbjes së margaritarit më të çmueshëm dhe

orvatet ta rikthejë pasurinë që e ka trashëguar nga stërgjyshërit e tij të fituar me përpjekje të mëdha dhe jetën e miliona njerëzve, por nuk gjenë në vetë fuqi për një aksion të tillë...!

Si do ta gjenin kur ishin të ndarë me ambicie provinciale, kur fuqitë e përbashkëta i kishin humbur duke i shfrytëzuar në luftë kundër njëri-tjetrit e jo kundër armiqve!!!

### **Faktorët e dobësimit**

Përçarjet dhe mosmarrëveshjet e emirëve ishin shkaqe të dobësimit, decadencës dhe të shkatërrimit të Perandorisë islame në Andaluzi. Prej vitit 139 h. deri në vitin 418 h. në Perandorinë islame andaluziane ekzistonte vetëm një halif, kurse më vonë, emirët dhe udhëheqësit filluan të përçahen derisa janë bërë 20 halifë, 50 provinca dhe dhjetëra vilajete të pavarura, vetëm për shkak të zilisë dhe lakmisë ndaj pushtetit, dhe kështu fillon grindja dhe përçarja, pastaj lufta derisa kthehen francezët dhe e rikthejnë Andaluzinë ngase mezi pritnin një oportunitet të tillë nga arabët.

Për fat të keq, muslimanët i kishin mbyllur sytë dhe nuk ishin të vetëdijshëm për rreziqet që i kanoseshin perandorisë së tyre të formuar shekuj me radhë. Periudha e fundit që e prezenton unitetin e tyre është ajo e halifit Hishami i tretë mes viteveve 412-418 h.

Më vonë, Perandoria andaluziane filloi të copëtohet në emirate të pavarura. Transmetohet nga halifi famëkeq, i njohur si Ebu Bekër, se ministri Ebul-Hazën, i njohur si Xhehver, i shkruar pas vendimit të emirëve në Kordovë për pozitën e tij si halif. Hishami në atë kohë ishte i vendosur në pallatin "El-Bint",

në bregdet, edhe atë te Ebu Abdull-llahu, i njohur si El-Mutega-lib. Kështu prezenton dhe ia dhuron halifatin në muajin Rebiul-ev-vel 418 h. dhe e quan me titull El-Mu'tedd Bil-lahi. Për këtë shkak janë shkaktuar intriga dhe gjakderdhje mes emirëve afër tre vjet me radhë derisa janë pajtuar që të arrijnë në Kordovë, kryeqytet i halifatit, në vitin 420 h, mirëpo pas një kohe të shkurtë disa ushtarë të tij rebelohen dhe shkaktojnë trazira të mëdha. Për këtë shkak, Hishami së bashku me shërbëtorët dhe gratë e tij shpërngulet në Xhaminë e Madhe e më vonë në qytetin Leridë, gjatë periudhës së emirit Ibn Hud, pastaj shkon në Saragozë, Tortozë dhe më në fund vdes i vetmuar në Meragë në vitin 407/h. Ky ishte edhe sundimtari i fundit nga familja emevite në Andaluzi.

Ishte kjo një paraqitje e shkurtë e ngjarjeve të fundit në Shtetin islam andaluzian. Edhe pse paraqitja është e shkurtë, i vërejmë gjërat e përgjithshme dhe çështjet e mëdha që ndikuan negativisht në halifatin andaluzian.

Vijon çështja e Andaluzisë dhe e muslimanëve pas humbjes së fronit të halifatit.

Pas përfundimit të emevitëve, Perandorinë andaluziane fillojnë ta udhëheqin disa vezirë dhe i pari prej tyre pas Hishamit ishte veziri Xhehver, të cilin e cekëm më parë. Ai e mbajti postin katërmbëdhjetë vjet, pastaj erdhi i biri i tij Muhammed ibn Xhehver, i njohur me titullin Ebu-Velid i cili qëndroi afër tetë vjet. Pas tij erdhi Me'mun ibn Dhen-nuni i Toledos, i cili vdiq pas një kohe të shkurtë. Atë e trashëgoi një berberian i quajtur Musa ibn Akkashe derisa pësoi disfatë nga Dhafir Bihaulil-lah dhe kështu vilajeti i Kordovës bie nën dominimin e Seviljes.

Pastaj formohet shteti i Husejnive, më vonë ai i Samamidëve e kështu me radhë deri në formimin e shtetit të Beni Ahmerëve në Granadë. Granada ishte qendra e fundit e muslimanëve në Andaluzi kurse Beni Ahmerët emirët e fundit në te.

Është shënuar një ngjarje lidhur me sulltan Pajazatin e Dytë, që ka ngjarë në vitin 892 h. dhe që argumenton vështirësitë e Beni Ahmerëve dhe tërheqjen e tyre për shkak të presionit të madh nga sundimtarët spanjollë, të cilët i kishin rikthyer vendet andaluziane nga muslimanët, gjatë kohës së përçarjeve dhe luftërave të brendshme që ua kishin humbur fuqinë.

Ngjarja vijon kështu: "Njërit nga udhëheqësit e Beni Ahmerëve, të quajtur El-Muntesir, i është kërcënuar rreziku nga mbreti Filip i Kastiljes dhe ka kërkuar ndihmë nga Shteti osman në Lindje kur sulltan ishte Pajaziti i Dytë. Shteti osman në atë kohë gëzonte autoritet të lartë dhe fuqi të madhe, kishte anije që lundronin në Detin Mesdhe dhe që i çlironin bregdetet e Evropës Jugore dhe të Afrikës Veriore. Pas arritjes së mesazhit të Muntesirit me emisarin e tij special të quajtur Nasir ibn Abdull-llah-Dhakirij, sulltan Pajaziti i Dytë urdhëron menjëherë njërin prej emirëve të detit, të quajtur Kemal Reis, të përgatitet me anijet osmane dhe të shkojë në bregdetin e Andaluzisë për t'i ndihmuar udhëheqësit të Granadës kundër Filipit të lartpërmendur.

Në atë kohë Pajaziti i Dytë (All-llahu e mëshiroftë) i luftonte memelukët në Egjipt mirëpo dëshira e tij për ta ngritur flamurin islam në viset më të largëta të detit romak ishte më e madhe. Kështu, Kemal Reisi nisët me anijet osmane drejt bregdetit të Spanjës, mirëpo kthehet pa e realizuar qëllimin e tij edhe atë me urdhërin e vet sulltan Pajazitit për shkak të largësisë së

madhe ndërmjet Andaluzisë dhe Shtetit osman, si dhe për shkak se i biri i sulltan Pajazitit, emiri Xhem, ishte në një udhëtim nëpër Evropë.

Pajaziti kujdesej që Evropa të mos mendojë se një aksion i tillë paraqet bashkimin e muslimanëve kundër Evropës dhe se përgatiten luftëra fetare, ashtu siç kishte ndodhur më parë. Kështu, emiri Kemal Reis kthehet nga bregdeti i Spanjës në vitin 892 h. pa gjuajtur asnjë gjyle topi kundër mbretërisë së Filipit katolik por vetëm i ishte kërcënuar.

Pak më parë cekëm tre probleme që janë të rëndësishme dhe kanë lidhshmëri të ngushtë me këtë hulumtim.

### ***Problemi i parë***

Gjendja politike e Evropës në atë kohë ishte ashtu siç është edhe sot dhe sulltan Pajaziti kishte kujdes që mos t'i nxisë ndjenjat fetare të Evropës me të ndihmuarit e shtetit të Beni Ahmerëve islamë në Andaluzi, sepse një ndihmë e tillë mund të konsiderohej si bashkim islam kundër kontinentit krishter. Kështu, ai e ndërron mendimin tij dhe urdhëron kthimin e anijeve osmane. Ai me këtë gjest bën një gabim trashanik vetëm për shkak të imagjinatës së tij, sepse Beni Ahmerët kishin nevojë për ndihmën e tij, jo për shkak të lidhjeve fetare por për shkak të mbrojtjes së Shtetit islam, i cili po qe se forcohej, Lindja dhe sulltani do të kishin dobi të mëdha dhe Islami do të vazhdonte deri më sot.

Ky gjest politik që ka ndodhur para 82 vjetëve, më rikujton përpjekjet e qeverive tona sot për të kooperuar, të bashkuara mes vete pa kurrfarë dallimi dhe për ta mbrojtur qenien e tyre

në bazë të lidhjeve ekzistuese. Qeveritë tona bëjnë përpjekje të tilla nga faktori, që e kishte frikuar edhe vetë sulltan Pajazitin e Dytë kur i kishte dërguar anijet në Andaluzi, por pas pak kohe i kishte kthyer vetëm për t'u mbrojtur nga ideja që mund të lindte në shtetet evropiane dhe t'i dëmtonte Lindjen e Perëndimit.

I madhëruar është All-llahu!

Popujt dhe mbretëritë janë ende ashtu siç kanë qenë para 82 vjetëve, ndjenjat dhe iluzionet dominuese njerëzore janë të pandryshueshme edhe pse janë në kulm të civilizimit.

Mendojmë se shek XV h. nuk është më i zhvilluar se shek X, ngase ndjenjat dhe politika janë ende të njëjta.

### ***Problemi i dytë***

Historia e mesjetës na rrëfen se ardhja e anijeve franceze dhe angleze në ujërat e Shtetit osman në vitin 1904 gjatë kohës së sulltan Abdulhamidit, i ka përgjasuar lundrimin të anijeve osmane në bregdetin spanjoll në vitin 1487, gjatë periudhës së Filipit të Dytë.

Vërejmë se shkaqet dhe faktorët janë të njëjtë!

Me kalimin e kohës, ndryshon forma e këtij fenomeni shoqëror, sepse një kohë anijet tona lundronin nëpër bregdetin e Perëndimit për shkaqe politike e fetare, kurse tash i gjejmë anijet e Perëndimit në bregdetin e Lindjes për shkaqe dhe faktorë të njëjtë.

I Madhëruar është Ai që e ndryshon gjendjen!

***Problemi i tretë*****Kooperimi i muslimanëve**

Mjafton që e cekëm pak më parë gabimin e sulltan Pajazitit kur i ka rikthyer anijet e tij para se ta kryejnë detyrën e tyre për shkak të iluzionit të tij politik ndaj shteteve evropiane.

Nuk kemi cekur se vetëm udhëtimi i anijeve ishte argument për bashkëpunimin e muslimanëve dhe se vet sulltan Pajaziti e dëshironte një gjë të tillë. Ky është një gjest pozitiv i tij ashtu siç është gjest negativ kthimi i anijeve, mirëpo nuk dimë se a ishte kjo ngjarje e caktuar nga qielli apo nga mosbashkëpunimi i muslimanëve në atë kohë derisa e humbnin fuqinë e tyre të madhe pa kurrfarë ndikimi në zemrat e tyre.

Realiteti është se populli islam atë bashkëpunim dhe unitet që e ka patur në fillim e shndërroi në diç krejt ndryshe, saqë vërejmë se Beni Ahmerët e Granadës, kur merr fund koha e tyre, e braktisin emiratin islam në Andaluzi, të shkatërruar e të dobësuar, kurse në emiratet islame të Lindjes e Perëndimit nuk ka ekzistuar keqardhje apo mëshirë për ta!

*Problemi i katërt***Dobësimi i tepërt i mbretërve të fundit andaluzianë**

Mesazhi i Ibn Hazmit<sup>3</sup>, dërguar sulltan Pajazitit argumenton shkallën e dobësimit dhe dekadencën e emirëve të fundit në Andaluzi.

Ky është edhe shembull për të tjerët!

Muntësiri e dinte fuqinë e armikut të tij dhe dobësinë e fuqisë së vet kundër atij armiku dhe për këtë shkak kërkoi ndihmë prej halifatit të muslimanëve në Lindje. Mbretëritë që kërkojnë ndihmë nga jashtë për mbrojtje janë në prag të vdekjes. E tillë ishte edhe mbretëria e Beni Ahmerëve, ngase pas një kohe të shkurtë e braktisën Andaluzinë.

Për ta plotësuar çështjen e dobësimit dhe të shkatërrimit të shtetit andaluzian, do të përmendi edhe disa detaje tjera:

Spanjollët filluan të korrin fitore në Andaluzi prej vitit 475 h, edhe atë pas okupimit të qytetit të parë islam, Toledos, që konsiderohej ndër qytetet më të rëndësishme në siujdhesën e gjelbërt në kohën e mbretit Alfonso, kurse emir në të ishte Kadir Bil-lah ibn Me'mun Jahja ibn Dhen-nun.

Abdull-llah ibn Ferexh el-Behsij për këtë ngjarje thotë kështu:

*Nxitni kuajt o banorë të Andaluzisë  
se qëndrimi në të nuk është i sigurt,*

---

<sup>3</sup>Emiri i Granadës e ka dërguar atë si misionar te sulltan Pajaziti i Dytë për të kërkuar ndihmë kundër mbretit Filip.;

*Ai që është afër të keqes nuk është i sigurt,  
si mund të jetohet bashkë me gjarpërinjtë?*

Nga këto vargje e kupton dobësinë dhe dekadencën e madhe që i kishin kapluar zemrat në Andaluzi.

Spanjollët nuk e kanë rikthyer vendin nga muslimanët por nga vajtuesit, që i kishin zemrat përplot frikë. Fjala e këtij poeti ka ndikuar në frikë dhe dorëzim, i kanë humbur shpresat dhe e kanë harruar mbrojtjen e vendit të tyre. Pra, për këtë shkak ka ndodhur ajo që ndodhi.

Pas hyrjes në Toledo, Alfonso me krenari ka kërkuar prej Mu'temid ibn Abbad, emir i Kordovës, Seviljes dhe i Baxhes të paguaj më tepër se haraçi i rëndomtë<sup>4</sup>, dhe t'ia dorëzojë të gjitha fortifikatat e Kordovës e të jetojë në shkretëtirë.

Emiri refuzon kategorikisht një kërkesë të tillë dhe kështu Alfonso niset me një ushtri të madhe kundër tij. Ibn Abbadi kërkon ndihmë prej Jusuf ibn Tashfinit, sulltan i Magribit me qendër në Fas, prej Mutevekkil Umer ibn Habbus es-Sanhaxhit, emir i Granadës. Kështu, kacafyten këto ushtri me ushtrinë e Alfonsos dhe zhvillojnë një luftë të rreptë, ku Alfonso dështon kurse muslimanët fitojnë. Kjo luftë, për shkak të zhvillimit të saj në vendin Zelaka quhet "lufta e Zelakës".

Nga kjo luftë mund të kuptohet se muslimanët kanë qenë të bashkuar, mirëpo për ta njohur shkallën e zilisë, ndarjes dhe urrejtjes së fshehur në zemrat e emirëve muslimanë, do të cekim një gjë që mund t'i habitë lexuesit, vetëm për shkak se jemi të obliguar t'i argumentojmë shkaqet e përfundimit të perandorisë së muslimanëve në Andaluzi.

---

<sup>4</sup>Mu'temid ibn Abbadi, emir i Kordovës dhe Seviljes, u paguante mbretërve spanjollë xhizje si shenjë nënshtrimi,

Pasi që kthehet Jusuf ibn Tashefimi në Magribin arab si fitues, e len në Andaluzi komandantin e tij të shquar, emirin Sira bin Ebi Bekër të luftojë një kohë në vendet franceze. Më vonë ai i shkruan sulltanit të tij Jusufit, dhe i ankohet se andaluzianët nuk i ofrojnë ndihmë në luftë kundër francezëve. Për këtë shkak, sulltani i jep urdhër t'i sulmojë vendet islame, dhe kështu fillon luftën kundër emirëve të Beni Hudit dhe i okupon territoret e tyre, pastaj vazhdon kundër Beni Tahirit në lindje të Andaluzisë, kundër Beni Samadihit, kundër Mutevekkil Umer ibn Muhammedit, emir i Badahas dhe në fund kundër Mu'temid ibn Abbadit<sup>5</sup>, emir i Seviljes, të cilin e zë rob kurse pasurinë dhe territorin ia okupon.

Kur e vëren Tashefimi këtë fitore, i hipë anijes në Fas dhe për herë të dytë udhëton në Andaluzi. Pas arritjes në shkretëtirën e Granadës, del emiri Abdull-llah ibn Belkin dhe e përshëndetë. Para se të kthehet në Granadë, Tashefimi e sulmon, e okupon Granadën dhe e konfiskon krejt pasurinë.

Kështu, situata ishte e tendosur deri kur francezët e çlirojnë qendrën britaneze afër Saragozës në vitin 480 h. e jo në vitin 456 h, siç transmetohet në librat "Nefhut-tib" dhe "El-esir".

Në këtë ngjarje spanjollët kanë vrarë 100.000 muslimanë dhe shumë i kanë robëruar, ndërsa kanë konfiskuar plaçka të mëdha lufte. Më vonë kur francezët e çlirojnë Toledon dhe qytetet tjera me radhë nëpër vendet islame, gjykatësi Hu

---

<sup>5</sup>Sulltan Tashefimi i ka ndihmuar Mu'temid ibn Abbasit kundër mbretit francez, pra vet paramendo se si e ka kapluar zilia dhe urrejtja pa kurrfarë shkakut kundër tij. Kjo ngjarje është një ndër shkaqet e marrjes së Andaluzisë nga duart e arabëve. Shkak i fitoreve franceze, në rend të parë, ishte zhytja e andaluzianëve në kënaqësi dhe epshe.;

Ahmed ibn Hixhaf, në Valenci e zen Ibn Dhen-nunin e lartpërmendur në pallatin e tij dhe e vret. Pas dorëzimit të Toledos në duart e francezëve, emiri i Saragozës, Jusuf ibn Hudi e therë gjykatësin Ebu Ahmed (ose e djeg me zjarr) dhe e okupon Valencinë. Në vitin 630 h, spanjollët e sulmojnë afër Saragozës në drejtim të Detit Mesdhe dhe vrasin 20.000 muslimanë, sipas transmetimit të "Nefhut-tib".

Armiqtë pastaj e shfrytëzojnë rastin e luftës mes Ebu Muhammed Bejasit dhe emirit Adil dhe hyjnë në emiratin e Adilit në Elche, në vitin 630/h.

Po në të njëjtin vit, Andaluzia ngritet në kryengritje kundër Me'mun ibn Abdulmu'minit për shkak të vendosjes së Ibn Hudit në Murci. Në Almeri vendoset Ebu Abdull-llah ibn Muhammed el-Temimi ku dashurohet në një robëreshë dhe në një luftë për shkak të saj e vret Ibn Hudin. Më vonë vjen Ibn Ahmeri i Granadës dhe e pushton gjersa vijjnë francezët dhe ua marrin Beni Ahmerëve në vitin 639/h.

Kështu, çdo ditë francezët pushtojnë disa vende prej muslimanëve deri në vitin 645 h. kur e okupojnë krejt Andaluzinë Lindore dhe i dëbojnë muslimanët nga ato vende, si p.sh. nga Sevilja, Murcia, Kastilja, Kordova etj.

Kështu përshkruhet gjendja e muslimanëve gjatë atyre viteve të tjera në faqen 589 të librit "Tarihul-urfit-tibi:"..Pas hyrjes së spanjollëve në shumë vende andaluziane banorët e Andaluzisë ende inspirohen nga disfatat e mbretërve dhe fatkeqësitë që të hakmerren me poezi e prozë... Njëri prej tyre për rënien e Velencies në duart e spanjollëve thotë:

*"Oj Valencë, në përkujtimoren tënde rrjedh*

*gjak e jo ujë..."*

Kurse Toledoja përshkruhet kështu:

*"A nuk ka qenë qendër kryesore e fesë,  
ashtu siç dëshironte Zoti;  
Gjithë banorët e saj janë dëbuar  
dhe janë shndërruar në atë që është caktuar".*

Përgjithësisht, pasi që shkuan nga duart e muslimanëve kryeqendrat e njohura andaluziane si p.sh. Kordova, Sevilja, Toledo dhe Mursia, muslimanët janë tubuar në Granadë, që ishte në duart e Beni Ahmerëve. Gjendja e muslimanëve vazhdon të acarohet për shkak se spanjollët e vazhdojnë okupimin e vendit deri në vitin 800 h. e posaçërisht paraqiten për sulmin e Granadës. Emiri i Granadës kërkon ndihmë prej mbretit të Marokos (Beni Merrin) por ai refuzon. Refuzimi i tij nuk e pengon fitoren e muslimanëve dhe shkatërrimin e armiqve të tyre, mirëpo, pas fitores, Beni Ahmerët, për fat të keq, ndahen mes vete edhe pse gjendja ishte tejet e tendosur dhe kishin një përvojë të hidhur gjatë viteve të kaluara.

Në Granadë ishte emiri Hasan Ali ibn Sa'd en-Nasrij el-Galibij el-Ahmerij, kurse në Malagë emiri Ebul-Hasan. Emiri i Malagës kishte ushtri të madhe dhe për këtë shkak kishte filluar të zhytet në kënaqësitë e epshit, kurse çështjet administrative ua kishte dorëzuar vezirëve të tij. Kështu, mbretëron dështimi dhe amoraliteti, fatkeqësia dhe tirania kurse emiri fshehet me robëreshat dhe këngëtarët e tij ngase

mendonte se armiku nuk do të afrohet për shkak të fuqisë të tij.

All-llahu ia dërgon një fortunë me shi dhe ia shkatërron begatitë e tokës. Kështu fillon përçarja mes popullit dhe vezirëve për shkak të fëmijëve të emirit, ngase disa i kishte me një romake kurse të tjerët me gruan e tij muslimane. Populli ndahet në dy tabore dhe çdo tabor anonte kah emiri i tij. Këtë rast e shfrytëzojnë spanjollët dhe e sulmojnë qytezën Alhane në vitin 887 h.

Fëmijët e emirit Ebul-Hasan Abdull-llah Muhammed dhe të emirit Ebul-Haxhxhaxh Jusuf Ali shkojnë në Guadex pas kryengritjes së tyre kundër etërve të tyre. Banorët e Granadës i pranojnë si udhëheqës kurse etërit e tyre largohen në Malagë. Në vitin 888 h. në luginën e Malagës konfrontohen muslimanët dhe francezët ku zhvillohet një luftë e rreptë. Në atë luftë, francezët e robërojnë sulltanin Ebu Abdull-llah dhe e dërgojnë në vendin e tyre.

Pas vdekjes së sulltanit Ebul-Hasan, banorët e Granadës e caktojnë vëllain e tij, sulltanin Ebu Abdull-llah.

Në vitin 890 h. armiku okupon disa fortifikata të Malagës dhe Rana's dhe i nënshtron banorët e Malagës perëndimore.

Pastaj francezët janë drejtuar kah Granada, mirëpo muslimanët korrin fitore kundër tyre.

Në vitin 891 h. për shkaqe politike lirohet sulltani Ebu Abdull-llah, eventualisht për të shkaktuar grindje tek muslimanët gjatë zgjedhjes mbretërore, gjë që me të vërtetë edhe ndodhë, ngase gjatë kryengritjes në Granadë për shkak të zgjedhjes sunduesi i Kastiljes i sulmon muslimanët dhe okupon disa vende e fortifikata.

Në vitin 892 h. sunduesi i Kastiljes, e dërgon për së dyti herë Ebu Abdull-llahin për t'i nxitë muslimanët. Mbreti spanjoll kastilian i ofronte pasuri të madhe atij.

Ky tradhtar u ndihmonte francezëve në çlirimin e Andaluzisë deri kur mbreti kastilian depërtoi në Granadë, (qendra e fundit në Andaluzi) pas rrethimit shtatëmuorë në vitin 897/h. Muslimanët ishin të obliguar t'i dorëzohen armikut, por pas plotësimit të 67 kushteve, siç transmetohet në "Tarihu takvimilbuldan", p.sh.: sigurimi i jetës, pasurisë, lejimi i praktikës fetare, të qëndrojnë xhamitë dhe vakëfet ashtu siç janë, të mos e udhëheqë arabin francezi apo hebreu dhe të mos dëmtohet krishteri i islamizuar; muslimani i krishterizuar të qëndrojë disa ditë derisa të qartësohet gjendja e tij, të mos obligohet muslimani në mikpritjen e spanjollëve, të mos hyjnë nëpër shtëpitë e tyre, të jenë arabët të sigurt me pasurinë dhe fëmijët e tyre, të mos pengohet muezini, falësi i namazit, agjëruesi dhe të mos paguajnë tatim për vite të caktuara, etj.

Pas një kohe të shkurtë, apo në vitin 904 h, spanjollët e shkelën fjalën e dhënë ngase priftërinjtë i obligojnë të gjithë krishterët e islamizuar t'i rikthehen krishterimit.

Pas tendosjes së situatës, disa vendas të Granadës i vrasin udhëheqësit dhe për këtë shkak të gjithë muslimanët bëhen të krishterë, ngase vendimi për vrasje del nga kompetencat e sulltanit, eventualisht, ata që nuk bëhen të krishterë vriten, kurse ata që shpëtojnë nga kjo gjakderdhje emigrojnë.

Është interesant se territoret që i kanë çliruar arabët gjatë një periudhe trevjeçare, spanjollët kanë mundur t'i rikthejnë pas tetë shekujve.

Gjendja ishte e tillë derisa ishin bërë të krishterë të gjithë, kurse të tjerët kishin ikur nëpër male, mirëpo francezët edhe ata i kishin vrarë, përveç disa muslimanëve të disa vendeve që kishin luftuar me sukses kundër francezëve e pastaj kishin emigruar në Maroko, Tuniz, Algjer, Sham dhe Konstantinopojë. Muslimanët e fundit e braktisën Andaluzinë në vitin 1017 h, kurse sulltan i fundit ishte Ebu Abdull-llah Muhame ibn sulltan Ebil Hasan.

Me përfundimin e shtetit të tij merr fund Perandoria islame në Andaluzi dhe në vend të muslimanëve, spanjollët i trashëgojnë gjurmët e civilizimit arab, i shndërrojnë xhamitë në kisha dhe ushtrojnë tortura pa precedentë në histori mbi muslimanët e pafajshëm.

Kështu, derisa muslimanët i mbronin të krishterët dhe i respektonin marrëveshjet me ta, ata vepronin në mënyrë të kundërt, ashtu siç pamë pak më parë.

Nga kjo që u cek rreth ditëve të fundit të muslimanëve në Andaluzi shihet qartë se vetë muslimanët e kanë dëmtuar vetveten e jo francezët, ngase francezët kanë ardhur për ta rikthyer vendin e tyre të dikurshëm.

Muslimanët i ka zënë gjumi në kohën kur duheshte ta mbrojnë vendin, janë ndarë në sekte e grupacione, kanë luftuar njëri me tjetrin një kohë...

Këto janë ndër shkaqet kryesore, të cilat ua kanë trasuar rrugën spanjollëve dhe ua kanë mundësuar fitoren kundër muslimanëve dhe dëbimin e tyre, bile edhe krishterimin e tyre!?

## **PJESA E DYTË**

### **ÇLIRIMET E FUNDIT ISLAME NË LINDJE**

Nga ajo që u cek më parë për historinë e Andaluzisë dhe skakun e shkatërrimit të saj, kuptojmë se faktori kryesor i shkatërrimit qëndron në mosmarrëveshjet më mesin e muslimanëve dhe në luftimin e tyre në mes vete derisa shkatërrohet shteti i tyre.

Derisa një situatë e tillë mbretëronte te muslimanët e Perëndimit, Perandoria osmane me qendër në Stamboll dhe Mbretëria abaside në Egjipt, grindeshin për shkak të halifatit.

Për t'u habitur është se gjatë një shekulli, shek. X h, dhe përafërsisht në një vit shkatërrohen shteti abasid në Egjipt (në vitin 922/h) dhe shteti i ehvanëve në Andaluzi (pas disa viteve).

Dallimi mes këtyre dy shteteve qëndron aty se me shkatërrimin e shtetit islam në Andaluzi formohet shteti krishter, kurse në Lindje nuk ngjanë e njëjta gjë sepse pas shtetit abasid islam erdhi Shteti osman islam. Pra, muslimanët nuk e humbin shtetin e tyre por i shikonin osmanlinjtë me krenari dhe e konsideronin fitore ngase shteti abasid ishte dobësuar tepër dhe ishte përplot mosmarrëveshje gjatë periudhës së fundit të halifëve abasidë deri në kohën e halifit El-Mutevekkil i Tretë.

Sulltan Selimi i Parë i njohur si "Javuz"<sup>1</sup> shkon në Egjipt dhe e merr prej Mutevekkilit të Tretë halifatin pasi që vëren dobësinë e shtetit abasid dhe mundësinë e kalimit të halifatit atje ku nuk është e preferuar, ngase halifati konsiderohet lidhje e vetme që i bashkon të gjithë muslimanët rreth fronit të halifit.

Sulltani në atë rast ka vepruar mirë, sepse me humbjen e halifatit prej duarve të abasidëve që shkonin vazhdimisht në dobësim e sipër, ndoshta të gjitha vendet islame prej Marokos deri në Indi do të luftonin mes vete për ta mbrojtur atë thesar të shenjtë.

Pas kësaj hyrjeje të shkurtë mendojmë t'i kthehemi kësaj pjese për ta realizuar qëllimin tonë.

Pasi që ky hulumtim ka të bëjë me betejat e fundit islame në Lindje gjatë shekujve të fundit dhe me dobësimin e dekadencën e shteteve islame dhe të muslimanëve, atëherë do të fillojmë me ardhjen e sulltan Sulejmanit, të njohur me titullin "Kanuni" për shkak të besnikërisë së tij ndaj drejtësisë dhe kanunit.

Nuk i kemi cekur sulltanët që i paraprijnë atij, ngase tema jonë këtu përqëndrohet në betejat e fundit islame në Lindje pas shkatërrimit të shtetit islam në Perëndim.

Sulltan Sulejman Kanuni, halif i dytë osman dhe sulltan i dhjetë, hipi në fronin e sulltanatit në vitin 926 h. në moshën 26-vjeçare. Çështjeve të administratës së perandorisë u qaset me seriozitet dhe që në fillim fillon me reformat e ushtrisë dhe zmadhimin e flotës islame derisa ua tejkalon shumë shteteve në Detin Mesdhe.

---

<sup>1</sup>Ky term është term turk dhe do të thotë mprehtësi apo pronar i shpatës së mprehtë;

Gjithashtu edhe ushtria e tij organizohet në mënyrë më të përkryer sipas standardeve të atëhershme ushtarake.

Vetë sulltan Sulejman Kanuni, Zoti e mëshiroftë, e ka udhëhequr ushtrinë e tij 13 herë dhe gjithmonë ka korrur sukses kundër armiqve të tij.

Ekspeditat ushtarake të tij do t'i cekim një pas një sepse me përfundimin e tyre përfundojnë edhe çlirimet islame në Lindje, pastaj fillon dobësimi gradual i Shtetit osman ashtu siç kishte ndodhur me shtetin andaluzian, kurse shtetet fillojnë të shkëputen nga Perandoria islame.

Gjithashtu do t'i cekim edhe faktorët të cilët na kanë sjellur në këtë gjendje në të cilën gjendemi sot.

### *Çlirimet e para*

## **Sulltan Sulejmani dhe ekspedita e tij e parë**

Para se t'i cekim ekspeditat e këtij sulltani famëlartë, mendojmë se është e arsyeshme të përshkruhet gjendja e atëhershme e Evropës si hyrje në ekspeditat dhe çlirimet e tij për shkak të lidhjes së ngushtë me jetën e këtij sulltani famëlartë e luftarë dhe me çlirimet e tij të suksesshme.

Koha e sulltan Sulejman Kanunit është vështirë të krahasohet me kohët e udhëheqësve të Lindjes dhe të Perëndimit për shkak të luftërave dhe fitoreve të shumta në te.

Shtetet evropiane në atë kohë kishin filluar të këndellen nga gjumi mirëpo aktiviteti i tyre në luftërat fetare e vonon Evropën

për një interval të gjatë. Franca atëherë përgatitej për një rol të ri politik gjithashtu edhe Anglia, Polonia, Venediku dhe Rusia, ndërsa Spanja dhe Franca ishin shtete në këndellje e sipër.

Kur erdhi sulltan Sulejman Kanuni në fron, Evropa ishte në periudhën transitore dhe të luftërave fetare për shkak të doktrinës së Luterit e cila njihet si doktrinë protestante.

Pasi që më vonë do t'i cekim shkaqet e zgjuarjes së shteteve të Perëndimit, t'i kthehemi hulumtimit kryesor rreth çlirimit të merhumit, sulltan Sulejman Kanunit.

#### *Ekspedita e parë - çlirimi i Beogradit*

Pas hipjes së sulltan Sulejmanit në fronin e sulltanatit dhe pas rregullimit të disa çështjeve të brendshme, disa vezirë të tij propozojnë udhëheqjen e tij personale në ushtri gjatë aksioneve luftarake. Vezirët e tij e nxisin kundër mbretit të Hungarisë për shkak të mospërurimit të tij me rastin e ardhjes së sulltanit në fronin osman. Për këtë shkak, Shteti osman i shpallë luftë dhe e dërgon kryevezirin Beri Pashën, i cili e rrethon fortifikatën e fortë të Beogradit, kurse më vonë edhe sulltan Sulejmani i bashkangjitet me një ushtri të fuqishme dhe që të dy e çlirojnë qytetin të cilin nuk ka mundur ta çlirojë as sulltan Mehmet Fatihu në vitin 927/h.

#### *Ekspedita e dytë - çlirimi i Rodosit*

Disa luftëtarë kryqtarë e sundonin Rodosin dhe e kishin rrethuar me një fortifikatë të madhe saqë edhe vet Mehmet

Fatih u kishte hasur në vështirësi me ta. Pasi që Shteti osman dominonte në Egjipt, e pa të arsyeshme domosdonë e çlirimit të Rodosit për shkak të pozitës së tij mes Egjiptit dhe Stambollit. Sulltan Sulejmani e dërgoi vezirin Mustafa Pashë<sup>2</sup>; si udhëheqës të 600 apo sipas një transmetimi tjetër të 700 luftanijeve dhe më vonë edhe vet sulltan Sulejmani i cili ishte nisur prej Marmarës, i ishte bashkuar. Kështu anijet osmane pas rrethimit gjashtëmuor, luftës që zhvillohej natë e ditë dhe humbjeve të mëdha e çlirojnë Rodosin në vitin 929 h. ose 1522 së bashku me disa ujdhesa tjera dhe kështjellën Bodrum. Më 18. sefer 929 h. sulltan Sulejmani kthehet në Stamboll<sup>3</sup>.

#### *Ekspedita e tretë - depërtimi në Hungari dhe Beteja e Budimit*

Pas çlirimit të Beogradit, hungarezët vazhdimisht nxitnin trazira dhe për këtë shkak, sulltan Sulejmani në vitin 932 h. e kalon lumin Danub dhe çliron dy kështjella. Në vazhdim

---

<sup>2</sup>Transmetohet se luftëtarët francezë, që ishin afër 700, i kishin sulmuar osmanët dhe se kishin vrarë qindra osmanlinj. Kështu, Beri Pasha ka urdhëruar t'i sulmojnë me rërë. Sipas historianit Xhesnaj, këtë metodë së pari e kanë zbuluar osmanlinjtë gjatë rrethimit të Rodosit. Ushtria osmane numëronte afër 40,000 lundruer, 20,000 marinarë, 2000 mercenarë dhe 8000 jeniçerë, kështu ushtria e sulltanit numëronte afër 100,000 ushtarë!!!;

<sup>3</sup>Dihet se sulltan Sulejmani ua ka siguruar krishterëve jetën e tyre, pasuritë dhe ju ka lejuar liri të plotë fetare, ua ka falur haraçin për 5 vjet; kur e ka takuar udhëheqësin e tyre, i ka pëlqyer shkathhtësia e tij dhe ka thënë: Më vjen shumë keq që ndahem prej këtij vigani trim" dhe pastaj udhëheqësi udhëton për në Maltë.

konfrontohet ushtria osmane me atë hungareze dhe vritet mbreti hungarez Luisi i Dytë. Ushtrinë osmane e udhëhiqnin dy komandantë: Hashru Begu, bir i një emiri arab dhe Bali Begu nga një familje e njohur në Egjipt. Për këtë shkak ushtria hungareze ka ikur kurse osmanlinjtë e kanë çliruar kështjellën e Budimit dhe e kanë përhapur kulturën osmane aty.

Pastaj sulltani në atë territor cakton një zëvendës të quajtur Xhon Zabuli dhe kthehet në Stamboll. Gjatë kthimit çliron edhe dy kështjella tjera<sup>4</sup>.

#### *Ekspedita e katërt - rrethimi i Vjenës*

Në vitin 936 h, sulltan Sulejmani e ka dërguar kryevezirin e tij Ibrahim Pashën që ta rrethojë Vjenën. Shkaku i rrethimit qëndronte në atë se mbreti francez Fransoa i Parë kishte kërkuar ndihmë prej sulltan Sulejman Kanunit për ta mposhtur fuqinë e mbretit Sharlkan, perandor i Spanjës, i cili kishte depërtuar atëherë në Evropë. Mbreti francez dëshironte ta okupojë Karlin në Austri me ushtrinë osmane ngase Sharlkani dëshironte ta caktojë vëllain e vet Ferdinandin mbret të Austro-Hungarisë.

---

<sup>4</sup>Në historinë e Ibrahim Baxhurit turk thuhet se gjatë këtyre ngjarjeve muslimanët kanë korrur sukses jashtëzakonisht të madh, me ç'rast kanë konfiskuar 300 topa dhe plaçka tjera luftarake. Sulltani gjatë luftës atje i ka vizituar të gjitha njësitë dhe nën flamurin e secilës njësi e ka lutur All-llahun për ndihmë e fitore me lot në sy para ushtarëve dhe komandantëve të tij, me qëllim që t'ua sugjerojë demosdoshmërinë e mbështetjes në Zot gjatë luftërave. Kjo sjellje ishte karakteristike e përgjithshme e të gjithë sulltanëve osmanë.

Kështu, Ibrahim Pasha, pas rrethimit trejavor të Vjenës, detyrohet të tërhiqet për shkak të mosarritjes së topave të mëdhenj dhe u kthye në Stamboll para se të arrijë dimri.

*-(Fillimi i privilegjeve të të huajve) -*

Sulltan Sulejman Kanuni bën gabim të rëndë politik me pranimin e kontratës politike mes Francës dhe Shtetit osman që ishte realizuar nëpërmjet emisarit special të mbretit Fransoa dhe që u kishte garantuar të huajve privilegje të cilat i gëzojnë deri në ditët e sotme.

Se kontrata e tillë politike ishte grusht vdekjeprues për Perandorinë osmane, do të sqarojmë me detaje të plota dhe parashtrim të përpiktë.

Sa u përket marrëdhënieve mes Shtetit osman dhe atij francez, vlejné të cekem bisedimet ndërmjet dy mbretërve të asaj kohe që i ngjajnë shkresës së zotëriut dërguar shërbëtorit ose të sunduesit dërguar punëtorit, gjë që vërteton autoritetin e lartë të sulltanit të Shtetit osman gjatë atyre shekujve të kaluar! Për shkak të dobësimit të politikanëve në kohën e sulltan Sulejmanit të huajt i kanë fituar ato privilegje të mallkuara.

Sipas historianëve evropianë dhe osmanë si p.sh. Safali Mid'hat dhe Neobosi, dobësimi politik në Shtetin osman fillon të vërehet që atëherë e pastaj fillon dobësimi administrativ që ua ka zmadhuar të huajve të drejtat e tyre në pushtet dhe ndërhyrjen në çështjet osmane. Pra, ky dobësim shkakton dëme të mëdha, të cilat në vazhdim do t'i cekë më hollësisht.

Është për t'u habitur se si e ka pranuar Shteti osman një gjë të tillë të rrezikshme, pa marrë parasyshë se sa i fuqishëm ka qenë!

Siç po shihet, shpirtmirësia e Sulejman Kanunit e ka arritur atë shkallë saqë ai në politikë nuk ka mundur ta dallojë të mirën prej të keqes dhe ndodhi ajo që ndodhi!

Askush nuk është i fuqishëm përpos All-llahut të Lartmadhëruar!

*Ekspedita e pestë - vendet gjermane dhe kontrata paqësore me Austrinë*

Në vitin 938 h. udhëheqësi i Hungarisë, Xhon Zabuli, dërgon emisarë ngase emirët e Hungarisë refuzonin ta respektonin autoritetin e tij pos Ferdinandin, mbret i Austrisë dhe vëllain e tij, Sharlkanin, mbret i Spanjës. Gjithashtu sulltan Sulejmani u informua se Ferdinandi përgatitej për rrethimin e qendrës osmane. Gjithashtu edhe ambasadorët e Fransoas e nxitnin sulltanin në Stamboll kundër Karlit të Madh, gjë që shkakton hidhërimin e tij, përgatitjen e një ushtrie të madhe prej afro 100,000 ushtarësh dhe nisjen për në Vjenë duke i shpallur luftë Sharlkanit dhe vëllait të tij Ferdinandit, mbretit të Austrisë. Qëllimi i tij kryesor ishte që t'i kërcënohet e jo t'i shpallë luftë të vërtetë ngase nuk i kishte marrur me vete topat e rrethimit, dhe kështu, ushtria osmane kishte depërtuar në brendësi të Austrisë. Kjo ekspeditë quhet "Ekspedita në vendet gjermane".

Pasi që ushtarët e Austro-Hungarisë ishin strehuar nëpër kështjella të fuqishme, sulltan Sulejmani nuk u kishte shpallur

luftë, përpos rrethimit dhe sulmit të disa kështjellave posaçërisht në Shtajer e pastaj kthehet nëpër rrugën e Gracit në Stamboll.

Mbreti Ferdinand pasi që vërejti se nuk ka fuqi që t'i bëjë ballë sulltan Sulejmanit, i dërgonte dhurata dhe ambasadorë, nënshkruan kontratën që të mos ndërhyjë në çështjet e Hungarisë, bile kjo ishte edhe kontrata e parë.

Disa historianë gjermanë e kanë kritikuar Ferdinandin sepse ai i drejtohej kryeministrit Ibrahim Pasha me fjalën "Vëllai im" dhe se e ndjente veten si vezir të sulltanit turk. Në të njëjtën mënyrë e trajtonin edhe shtetet e Evropës!!

#### *Ekspedita e gjashtë - Çlirimi i Tebrizit e Bagdadit*

Sulltanët osmanë kishin vendosur të dominojnë në të gjitha vendet islame që ishin rreth shtetit të tyre dhe t'i shpëtojnë nga emirët e provincave pas transferimit të halifatit tek ata, derisa t'i bashkojnë të gjitha territoret e vendeve islame dhe t'i përforcojnë eventualisht kundër tradhtive të brendshme e të jashtme.

Sulltan Sulejmani ka patur fat sepse formoi perandori të gjerë që fillonte prej Algjerit deri në Persi, Rusinë Jugore, Austri deri në skaj të vendeve egjiptase.

Një pushtet të tillë nuk ka formuar asnjë sundues musliman përpos në fillim të çlirimeve.

## Rifillimi

Pas kthimit të sulltan Sulejmanit nga Austria si ngadhënjimtar, Shah Tohmasebi çohet në kryengritje kundër tij në Azerbajxhan në vitin 941 h<sup>5</sup>, dhe kështu e dërgon kryeministrin Ibrahim Pashën në Tebriz e më vonë edhe vet i bashkangjiten dhe i nënshtrohen emirët persianë si Shah Kejlani dhe guvernatori i Shirvanit;

Pas qetësimit të Tahmasibit, sulltan Sulejmani kalon me ushtrinë e tij prej Huzistanit në Irak deri në Bagdad nëpër Hamadan, ku e pret guvernatori Dhulfikar Han me mirëseardhje.

Udhëtimi i sulltanit prej Tebrizi deri në Bagdad ka zgjatur dy muaj e gjysëm në këmbë dhe njëherit konsiderohet si shkathtësi e jashtëzakonshme ushtarake që e kishin arritur ushtarët dhe prijësit e shkathët. Ai ka qëndruar në Bagdad katër muaj duke bërë përpjekje ta riformojë administratën e shtetit dhe t'i mbrojë interesat e popullit. Me drejtësinë e tij ai e riktheu kohën e halifëve të hershëm si p.sh. të Harun Reshidit dhe Me'munit. Pastaj udhëtoi në Stamboll duke kaluar nëpër vendet e kurdëve pas rikalimit nëpër Azerbajxhan dhe ngadhënjimit kundër Shah Tahamsibit, i cili përsëri kishte shkaktuar trazira.

---

<sup>5</sup>Azerbajxhani i takonte Shtetit Persian, kurse shteti i Iranit e rikthen atë prej Shtetit osman në vitin 1175/h.;

## **Vrasja e Ibrahim Pashës**

Pas qetësimit të gjendjes, sultani u kthehet çështjeve të shtetit të tij.

Një ndër gjërat e dhimbshme që kanë ngjarë atëherë është vrasja e vezirit të tij, Ibrahim Pashës i cili ishte shumë inteligjent dhe i shkathët.

Shkaku i vrasjes së tij qëndronte në atë se ai kishte filluar të ndjejë njëlloj krenarie ngase sultani i shqyrtonte të gjitha çështjet e perandorisë me te. Sultani e vrau atë në një natë të muajit të Ramazanit në pallatin e tij në vitin 942 h, edhe atë duke qenë në gjumë<sup>6</sup>.

*Ekspedita e shtatë dhe e tetë*

## **Rrethimi i Korfuzit -**

Hakmarrja e Barbaros Hajruddin Pashës (shqiptar - N.A.) dhe ekspedita e tij në Detin Mesdhe - Beteja e Prevezës - çlirimi i Indisë dhe Adenit - çlirimi i Gjenovës dhe nënshtrimi i

---

<sup>6</sup>Shkaku i vrasjes së këtij veziri ceket në librin "Kumhul ahbari", ku thuhet se ai e ka nxitur sultan Sulejman Kanunin ta vret Iskender Xhillij Defterdar në Bagdad për shkak të njëfarë konflikti mes tij dhe ministrit. Në një ëndërr sultani sheh se ka gabuar dhe kështu pas kthimit në Stamboll e vret, ashtu siç cekëm më parë. Thuhet se Iskender Xhillijju ka qenë shumë i pasur dhe se ua ka mësuar fëmijëve të tij leximin dhe moralin ndërsa prej trungut familjar të tij kanë dalur shtatë vezirë famëlartë.

Italisë - pasqyrë politike - historia ripërsëritet - ndryshimi i kohëve.

Gjatë shfletimit të historisë për detajizimin e ekspeditave të sulltan Sulejman Kanunit dhe çlirimeve të tij, vërejmë një pasqyrë historike që është cekur në udhëtimet detare osmane. Në atë histori gjejmë se rrethimi i Korfuzit i ngjanë lëvizjes dhe intrigave që i ka nxitur Italia në trojet shqiptare. Intrigat e para Italia i bëri kur emiratet e saja ishin të ndara, pra në vitin 1536 kurse të dytat në vitin 1911. Mes intrigave të para italiane kundër Shtetit osman dhe atyre të dytave janë plot 375 vjet dhe ende vazhdon të shkaktojë trazira në territorin e shtetit për t'i realizuar qëllimet e veta. Çdokush që i shfleton ngjarjet e kryengritjes malësore vëren se Italia ka qenë shkaktare e saj, mirëpo All-llahu nuk ka lejuar që ky shtet t'i realizojë qëllimet e veta edhe pse një kohë bukur të gjatë përdori metodën e shpifjeve dhe intrigave.

Kështu, historia përsëritet, kryengritja e dytë shqiptare përfundon në vitin 1911 me fitore të shtetit italian ashtu siç përfundon edhe kryengritja e vitit 1536.

Pra, lexuesi mund të vërejë se emiratet italiane kanë vepruar asisoi që të hakmerren ndaj sulmeve osmane.

Sulltan Mehmet Fatihu e kishte dërguar qysh më herët Ahmed Pashën në bregdetin e Italisë dhe e kishte çliruar Apoloninë, mirëpo më vonë, shteti i Spanjës e rikthen ate.

Është interesante se Franca, e cila e kishte nxitur Italinë në vitin 1911 ta sulmojë Tripolin, gjithashtu e nxiti edhe sulltan Sulejman Kanunin ta sulmojë Italinë në vitin 1537.

O Zot!

Çfarë intriga në shtetet evropiane, edhe atë në kohën e civilizimit!!!

Historia argumenton se Evropa e mesjetës ka qenë më e zhvilluar moralisht se në kohët e mëvonshme që njihen si "periudha e civilizimit".

Franca ndërmori një hap të tillë për shkak të lidhjeve të saja me sulltan Sulejman Kanunin, ashtu siç cekëm më parë dhe siç do të cekim në vazhdim.

Italia e kuptoi një aksion të tillë dhe për këtë shkak filloi të nxisë dhe të shpifë për ta penguar sulmin osman që ishte duke u përgatitur nën udhëheqjen e Barbaros Hajrudin Pashës, mirëpo një gjë e tillë nuk e ka brengosur sulltan Sulejmanin, prandaj ai urdhëroi që të ndërmerren dy sulme; i pari në det nën udhëheqjen e Hajrudinit kurse i dyti në tokë nën udhëheqjen e vet sulltanit. Një gjë e tillë edhe ndodhi, ngase të dy grupet janë nisur në prill të vitit 943 h. - 1537.

Sulmi detar përbëhej prej 180 anijeve luftarake kurse ai tokësor prej 150.000 ushtarësh dhe kështu arrijnë në Bregdetin Adriatik.

Populli italian veç kishte dëgjuar për nisjen e anijeve osmane prej Stambollit dhe për këtë shkak, banorët e bregdetit ishin transferuar në brendësi, kurse Papa (Paolo i Tretë) kishte ikur nga Roma dhe kishte urdhëruar të mbrohet ajo. Kështu, jehona e anijeve osmane i kishte tronditur zemrat e italianëve. Nisja e osmanëve nga Dardanelet nuk e kishte hutuar vetëm Italinë por mbarë Evropën dhe për këtë shkak të gjitha qeveritë evropiane, përpos asaj franceze ngase ajo kishte lidhur marrëveshje me Shtetin osman, filluan të bashkohen e të

përgatiten për kundërsulm nën udhëheqjen e admiralit italian Andrea.

Sulltani pasi që e kishte qetësuar kryengritjen e shqiptarëve, e kishte urdhëruar flotën osmane të nisët në Itali dhe ta rikthejë Apoloninë nën udhëheqjen e Asker Lufti Pashës, ngase Hajrudin Pasha kishte shkuar deri në Aleksandri për të sjellur municion dhe ushqim për ushtrinë. Lufti Pasha me sukses e ka rikthyer Apoloninë dhe i ka zënë robë shumë italianë pastaj është kthyer, mirëpo, gjatë kthimit ballafaqohet me flotën evropiane të udhëhequr nga admiralit Andrea ngase ky admiral kishte dëgjuar për udhëtimin e Hajrudinit në Egjipt, dhe kështu pas një beteje të ashpër, evropianët ikin dhe fillojnë t'i ndjekin anijet që lundronin në afërsi të tyre dhe i fundosin. Admirali Andrea rastësisht është ballafaquar me pesë anije osmane që ishin nën udhëheqjen e Ali Reisit dhe që ishin nisur në drejtim të flotës osmane dhe i ka sulmuar derisa i ka fundosur kurse marinarët i ka robëruar.

Kjo ka ndikuar tepër në sulltan Sulejmanin ngase kishte lidhur kontratë me Venedikun që të mos luftojë kundër osmanëve. Pasi që vendqëndrimi i flotës evropiane ishte në territorin e Venedikut, sulltan Sulejmani i sulmon anijet evropiane dhe çliron 143 fshatra. Pas qëndrimit katërmujor kthehet në Stamboll gjatë stinës së dimrit.

## **Hakmarrja e Barbaros Hajrudin Pashës**

### **Ekspedita në Detin Mesdhe**

Pasi që admiralit Andrea i dëmtonte anijet e tregtarëve osmanë, Barbarosi kërkon prej sulltan Sulejmanit që t'i japë leje për

kalimin e stinës së dimrit në det. Sulltani e lejon edhe pse kishte frikë nga deti në dimër mirëpo, Barbarosi i përgjigjet me këto fjalë të njohura: "Ekselencia ime, unë jam robi yt, i lindur në det dhe i rrethuar me ujë, pra nuk i frikohem atij" dhe niset me 60 anije në det.

Qëllimi i Barbarosit ishte hakmarrja ndaj Andreas dhe italianëve që kishin fundosur me qëllim disa anije osmane. Së pari e ka sulmuar Skinosin e pastaj Imrozin, Khiosin etj., ku edhe ka plaçkitur plaçka të mëdha luftarake dhe është kthyer në Stamboll. Më vonë përsëri kthehet dhe i vazhdon sulmet derisa e rrethon ujdhesën e Kretës ku çliron 300 fshatra, pastaj vazhdon dhe e çliron edhe ujdhesën e Karpathos.

Në realitet, nga ekspeditat e emirit të detit, Barbaros Hajrudinit, shteti ka fituar 25 ujdhesa; 12 prej tyre kanë pranuar t'i takojnë Shtetit osman kurse të tjerat kanë paguar haraç.

## **Beteja e Barbarosit me Andrian**

- Beteja e Prevezës -

Pas fitoreve të mëdha të sulltan Sulejmanit, nën nxitjen e papës Paolo i Tretë janë bashkuar anijet e Venedikut, Gjenovës, Maltës, Spanjës dhe Portugalisë në krye me admiralin Andrea për t'i sulmuar dhe shkatërruar anijet osmane ngase kishin shkaktuar dëme të mëdha në vendet dhe tregtitë e tyre si dhe kishin mbjellur frikë në zemrat e tyre.

Ata e kanë quajtur këtë sulm të madh me emrin "sulmi kryqtar".

Këtë gjë e ka dëgjuar sulltan Sulejman Kanuni dhe i ka dërguar anijet luftarake në krye me Barbarosin edhe pse aty ishin Turguti, Salih Reisi dhe Ibrahim Reisi.

Numri i anijeve kryqtare ishte 600 kurse i atyre osmane vetëm 122, pra dallimi mes fuqive të tyre ishte shumë i madh, mirëpo, emiri i detit, Barbarosi nuk është demoralizuar por i ka ndarë anijet në tre grupe, i ka udhëzuar komandantë, i ka inkurajuar, u ka dhënë instruksione dhe i ka nxitur që të thyejnë bllokadën në çfarëdo mënyre qoftë. Njërën pjesë e ka caktuar si rezervë që t'i pengojë sulmet e armikut nga të dy anët dhe ta pengojë kthimin. Kështu, anijet e armikut fillojnë t'i rrethojnë anijet osmane.

Në ditën e tretë të Xhumadijel-ula, 945 h, anijet osmane formojnë një gjysëmrrreth dhe fillojnë t'i afrohen armikut afër Ajamoros për ta ndarë në katër grupe. Pjesën rezervë ia dorëzon Turgut Reisit dhe e le pas, kurse tri pjesët tjera i drejton në një vijë. Pjesën e mesme e udhëhiqte ai, të djathtën Salih Reisi dhe të majtën Ali Reisi.

Qëllimi i Barbarosit ishte ta thyej vijën luftarake të armikut dhe ta ndajë.

Gjithashtu, edhe anijet e armikut ishin ndarë në katër grupe. Papritmas, kanë filluar të fryejnë erërat jugore që i kanë frikuar osmanët dhe për këtë shkak i janë lutur All-llahut xh.sh., dhe i kanë ngjitur ajetet e Kur'anit në të dy anët e anijeve. Pas ndaljes së erës, beteja ka filluar në mënyrë të çuditshme sepse britmat e muslimanëve më tepër e kanë hutuar armikun se krismat e topave. Gjatë përleshjes, admirali Andrea është orvatur shpesh ta pengojë prapavijën e Hajrudin Pashës, por si

do të mund ta bënte një vepër të tillë kur atë vigan nuk mund ta befasojë asgjë.

Për fat të mirë cakarritja e topave osmanë ishte më e madhe se ajo e armikut, gjë që i ka ndihmuar Barbarosit t'i shpartallojë anijet e shumta të armikut. Në këtë betejë, nga trimëria e ushtarëve osmanë dhe mençuria e Barbarosit, armiqtë kanë filluar të frikohen dhe të ikin kur ka filluar të bie muzgu i mbrëmjes, edhe pse numri i tyre ishte shumë më i madh. Turgut Reisi i ka ndjekur dhe ka konfiskuar disa anije, kurse të tjerat i ka fundosur.

Para se të agojë mëngjesi, brohoritjet e ushtarëve osmanë ngadhënjimtarë janë ngritur në qiell sepse kremtonin fitoren e muajit shtator të vitit 1538. Në mëngjesin e të nesërmes, deti ishte përplot mbeturina nga anijet e shkatërruara të armikut. Andrea në atë betejë humbi 128 anije.

Profesori anglez Frizi, thotë se ajo ishte një ndër betejat më të mëdha detare në atë kohë, kurse sipas admiralëve Rodni, Sent Vinsent dhe Nelson si dhe sipas të gjithë udhëheqësve të njohur detarë britanezë që i kanë lexuar detajet e kësaj beteje pas 200 vjetëve, shkathhtësia e Barbaros Hajrudin Pashës në këtë luftë apo thyerja e vijave të armikut është shndërruar në metodë, të cilën e kanë ndjekur më vonë si Nelsoni ashtu edhe të tjerët.

Pasha jetën time, kjo është mburrja më e madhe e udhëheqësve muslimanë në fillim të shekujve të fundit.

Pas ngadhënjimit, Barbarosi u kthye në Stamboll sipas urdhërit të sulltanit. Këtë fitore e kanë festuar të gjitha trojet osmane, kurse sulltani i ka shpërblyer luftëtarët me dhurata më të çmueshme.

### **Çlirimi i Adenit dhe ekspedita në Indi**

Në vitin 946 h, sulltani i Indisë ka dërguar një ambasador në Stamboll që të kërkojë ndihmë prej sulltan Sulejman Kanunit kundër sulmeve të portugezëve në Indi dhe kundër tiranisë së Himaja Shahit, mbretit mongol. Sulltani i ka dërguar anijet osmane prej Suezi nën udhëheqjen e Sulejman Pashës, i cili në fillim ka shkuar në Aden. Emiri i Adenit, Amir ibn Davud i ishte dorëzuar menjëherë Sulejman Pashës pa kurrfarë lufte ose përlëshje, mirëpo ai (Sulejman Pasha) e kishte vrarë për shkak të pasurisë së tij të madhe, gjë që kishte ndikuar shumë në Indi dhe Jemen dhe i kishte larguar prej osmanëve.

Pas arritjes në Indi, Sulejman Pasha e kishte rrethuar kështjellën "Dijo", mirëpo për shkak të mungesës së municionit ishte kthyer në Stamboll, kurse indianët, pas shkuarjes së tyre nënshkruajnë paqe me portugezët.

Sipas transmetimit të historisë së udhëtimeve detare osmane, një ndër shkaqet e ekspeditës së sulltan Sulejmanit ka qenë tentimi i një emiri portugez ta okupojë Mekken, Kudusin, Egjiptin dhe Siujdhesën Arabe, mirëpo pas sulmit islam në Lindje, aspiratat e tij kanë përfunduar para se të fillojë t'i realizojë dhe kështu ka pranuar të vazhdojë si guvernator i Indisë pas largimit të Sulejman Pashës.

### **Çlirimi i Gjenovës dhe mposhtja e Italisë**

Në vitin 947 h, luftërat që zhvilloheshin vazhdimisht ndërmjet Barbarosit dhe Venedikut, përfundojnë me ngadhënjimin e Hajrudin Pashës, eventualisht me mposhtjen e Italisë, apo të

pushtetit të Venedikut. Ata i kanë ofruar sulltan Sulejman Kanunit dorëzimin dhe kontratë paqësore, kurse sulltani e ka pranuar atë ofertë pas marrjes së kështjellave të bregdetit të Dalmacisë dhe të Algjerit si haraç dhe 300.000 lira si kompensim luftarak<sup>7</sup>.

### **Rikthimi i Algjerit**

Perandori Karl vuante nga sulmi osman në Detin Mesdhe dhe e konsideronte si nënçmim. Për këtë shkak përgatiti afro 270 anije dhe e sulmoi Algjerin më 28 Xhumadijel-ula 968/h- 1542 me 50.000 ushtarë, mirëpo një velijull-llah i quajtur Dede i është lutur All-llahut t'ua lëshojë armiqve një shtrëngatë<sup>8</sup>, gjë e cila me të vërtetë edhe ka ndodhur si përgjigje ndaj lutjes së tij. Një numër i madh i anijeve është fundosur kurse të tjerat kanë ikur.

Kështu Emiri Hasan, sundues i Algjerit, e rikthen vendin prej pushtetit të spanjollëve.

---

<sup>7</sup>Historia e Shtetit osman, Abdurrahman Sheref Nadhir el-Mearif.

<sup>8</sup>Këtë ngjarje e transmeton "Mu'xhemut-tarihi" dhe historiani anglez Xhon Devenport;

### **Luftërat e Hungarisë dhe pushtimi i pjesërishtëm**

Siç cekëm më parë, lidhjet ndërmjet Sulejmanit dhe mbretit të Hungarisë, Ferdinand ishin të mira deri në vitin 948 h, kur vdes Xhon Zabuli dhe e trashëgon i biri i tij Stefani, mirëpo, pasi që ky nuk ishte i moshërritur e zëvendësoi e ëma e tij, Izabela. Pasi që mbreti Ferdinand nuk e pranonte lidhjen mes Stefanit dhe të jatit të tij, e sulmon Inkrausin, dhe për këtë mbretëresha Izabela ka kërkuar ndihmë prej sulltan Sulejmanit. Sulltani menjëherë ka dërguar një ushtri të madhe në krye me vezir Sufi Muhammed Pashën. Më vonë edhe sulltani është nisur mirëpo, në mes të rrugës është informuar se Ferdinandi e ka ndërruar mendimin dhe kështu, duke e parë rëndësinë e Hungarisë, e cakton Sulejman Pashën si udhëheqës besnik, mirëpo Ferdinandi pasi nuk dëshironte t'i nëshetrohej sulltan Sulejmanit, fillon të shpifë e ta nxisë popullin austriak kundër sulltanit.

Sulltani e dërgon emirin e detit, Barbarosën në Spanjë për t'i bërë presion Karlit, vëllait të mbretit Ferdinand, kurse ai vet të depërtojë në brendësi të Hungarisë. Kështu, fillon t'i çlirojë qytetet njërin pas tjetrit derisa i çliron të gjithë në vitin 950/h.

## **Luftimet e fundit të Barbarosit dhe vdekja e tij**

Këto ishin ngjarjet në Hungari, kurse emiri i detit, Barbaros Hajrudin Pasha i ka marrur me vete 100 anije luftarake për në Spanjë që ta sulmojë perandorin Sharlkan<sup>9</sup>, mirëpo një ngjarje ia ka ndryshuar drejtimin.

Mbreti i Francës, Fransoa i Parë, kishte filluar të xhelozojë ndaj Sharlkanit që e kishte përfituar perandorinë e Gjermanisë ngase vetë mbreti francez kishte dashur ta përfitojë. Kështu pasi që Sharli ishte bërë mbret dhe perandor i Gjermanisë, Austrisë, Belgjikës, Sicilisë etj, Fransoa i Parë i kishte shpallur luftë me pretekst se Sharli e kishte destabilizuar baraspeshën evropiane, që përfundon me robërimin e Fransoasë më 24. shkurt 1525/h. Nëna e Fransoas kërkoj ndihmë prej sulltan Sulejman Kanunit, kur Perandoria osmane ishte në zenitin e saj dhe ishte zgjeruar prej burimit të Nilit deri në Oqeanin Indian, Kaukaz, Maroko, në Evropën e Mesme deri në kufijtë gjermanë. Sharli kishte ardhur në Nicë të Francës për ta rrethuar atë mirëpo sulltani e kishte urdhëruar Barbarosën t'i shkojë në ndihmë Fransoas së Parë, i cili kishte kërkuar ndihmë prej sulltanit për herë të dytë. Kështu, emiri i detit ishte nisur me 100 anije luftarake në vitin 1543/949 h. për t'i ndihmuar.

Barbarosi pas shkatërrimit të Sicilisë, niset për në Marsej dhe prej aty vazhdon në Tulon, ku francezët i shprehin mirëseardhje. Kështu pas bashkimit të anijeve franceze dhe

---

<sup>9</sup>Ky perandor në historinë evropiane njihet si Don Karlos;

osmane, nën udhëheqjen e Barbarosit nisen për në Nicë ta shpëtojnë nga duart e Karlit.

Sipas historisë së ekspeditave detare osmane, Barbaros Hajrudin Pasha i ka kritikuar përgjegjësit e anijeve franceze për shkak të mungesës së disiplinës në radhët e tyre si dhe ka deklaruar se anijet e tyre janë më të fuqishme për luftë.

Kjo kritikë e argumenton aftësinë ushtarake osmane dhe organizimin ushtarak tokësor e detar në krahasim me ushtrinë e Evropës, gjë që e pranojnë edhe vetë historianët anglezë si p.sh. Xhon Devenport.

Pas arritjes në Tulon Barbarosi ka marrur prej mbretit Fransoa i Parë 800.000 monedha ari për flotën osmane dhe pastaj është kthyer në Stamboll në prill të vitit 1544. Kjo ekspeditë e Barbarosit ka shkaktuar frikën e shteteve evropiane prej Francës dhe i ka detyruar të nënshkruajnë paqe që ishte në favor të Fransoas së Parë, ngase duke i falënderuar ndihmës detare nga Barbarosi, sulltan Sulejmani i rrethon vendet gjermane nga ana e kufijve të Austrisë.

O Zot! Këtë shërbim që ia ka ofruar shteti i madhëruar osman Francës nuk duhet ta harrojë asnjëherë ngase me shpatën e osmanëve ka shpëtuar nga sulmet e Karlit të Madh, por e gjithë kjo mvaret nga niveli i moralit të popujve e posaçërisht të francezëve.

## **Vdekja e Barbarosit**

Një ose dy vjet pas kthimit nga xihadi në Detin Mesdhe, që e ka lartësuar autoritetin osman, Hajrudin Pasha transferohet në rahmetin e Zotit të Madhëruar nga një sëmundje kronike e

pashërueshme në ditën e gjashtë të xhumadijel-ula 953 h. apo në ditën e katërt të korrikut 1546 në Stamboll.

Ai gjatë shërbimit dymbëdhjetëvjeçarë në Shtetin osman e ka lartësuar dritën e fesë e të shtetit, ka mbjellur frikë në zemrat e shteteve evropiane dhe e ka përparuar taktikën detare në një shkallë më të lartë se ajo e evropianëve.

Historianët e konsiderojnë si udhëheqës më të madhëruar detar në botë për shkak të aftësisë, shkathtësisë dhe trimërisë së tij.

Ai është udhëheqësi detar osman i nëntëmbëdhjetë.

Është për t'u habitur se poetët e asaj kohe kanë thurur elegji historiografike për vdekjen e tij, ku në fund thuhet: "Ka vdekur sunduesi i detit".

Zoti e mëshiroftë dhe e caktoftë në xhennetet e Tija të gjera!

Vარი i tij në Beshiktash ekziston edhe sot.

## **Paqja mes Karlit dhe Ferdinandit**

Kur kanë filluar vazhdimisht problemet e Karlit të Madh me Barbarosën dhe të Ferdinandit me ushtarët osmanë afro pesë vjet me radhë, që të dy kanë kërkuar prej sulltan Sulejmanit paqe dhe pas ndërmjetësimeve të gjata, i kanë miratuar çlirimet osmane islame në Austro-Hungari në vitin 954 h, dhe kanë pranuar të paguajnë 30.000 florinj haraç vjetor.

Kur Shteti osman e arrinë këtë autoritet të lartë, sulltan Sulejmani pikëllohet për shkak të vdekjes së fëmijëve të tij, Muhammedit dhe Xhihangirit.

I pari ka vdekur në Magnezi kurse i dyti në Haleb, Zoti i mëshiroftë!

### **Çlirimi i Iranit dhe ngjarja e sulltan Mustafasë**

Në vitin 955 h. Kasi Mirza i është ankuar sulltan Sulejmanit për tiraninë e vëllait të tij, Tahma Sibit, mbret i Iranit<sup>10</sup>, edhe atë në kohën kur vet sulltan Sulejmani vuante nga Tahma Sibi, dhe kështu ka përgatitur një ushtri nën udhëheqjen e tij personale derisa ka arritur në Tibriz pas rikthimit të kështjellës Van, kurse një pjesë të ushtrisë e ka dërguar në Gruzi nën udhëheqjen e Kara Ahmed Pashës dhe e ka qetësuar gjendjen atje.

Pas qetësimit të Tahma Sibit, sulltani kthehet, mirëpo Tahma Sibi e shfrytëzon këtë rast dhe sulmon disa vende, gjë që ka shkaktuar rikthimin e sulltan Sulejmanit dhe nënshkrimin e parë paqësor dhe zyrtar me Iranin.

Gjatë këtij udhëtimi vritet i biri i sulltan Sulejmanit, emir Mustafa, vali i Karamanit në një kurthë të vajzës së sulltanit Mehermah dhe të burrit të saj, kryeministrit Rustem Pasha, të cilët e kishin akuzuar për sharjen e të jatit të tij me qëllim që t'ia përforcojnë Shehzade Pajazitit, vëllait të Mehermahit, ardhjen në pushtet pas vdekjes së të jatit të tij në vend të emir Mustafës. Për këtë shkak, sulltani e vret të birin pa kurrfarë mëshire afër Konjës.

---

<sup>10</sup>Është interesant se sulltan Sulejman Kanuni gjatë tërë jetës së tij ka qenë mbështetës për të nënshtruarit, Zoti e mëshiroftë!;

Kjo është pika e zezë e historisë së Sulejmanit të njohur, që i ka pikëlluar edhe banorët e perandorisë.

### **Kthimi në ngjarjet e Hungarisë dhe çlirimi i Timishoarës**

Në ngjarjet e Hungarisë, që i cekëm pak më lartë, pamë se mbretëresha Izabela kishte kërkuar ndihmë prej sulltan Sulejmanit për ta mbrojtur nga sulmet e mbretit Ferdinand kundër birit të saj Stefanit pas tutorimit të saj të mbretërisë në vitin 948 h. Enjëjta gjë ka ndodhur edhe pas dhjetë vjetëve, eventualisht në vitin 958 h. kur Ferdinandi përsëri e sulmon dhe për këtë shkak sulltan Sulejmani e dërgon vezirin e tij Sokol Muhammed Pashën me 80.000 luftëtarë së bashku me vezirin e dytë Kara Ahmed Pashën. Kështu, ata çliruan disa kështjella derisa arritën në Timishoarë, ku edhe hynë pas një rrethimi dhe lufte të gjatë, e pastaj që të dy u kthyen në Stamboll në vitin 959/h.

### **Ekspeditat e Ali Reisit, Turgut Reisit dhe vdekja e tij para ujdhesës së Maltës**

Sulltan Sulejman Kanuni shpeshherë mendonte ta pushtojë Indinë dhe kështu atje dërgon një flotë nën udhëheqjen e Beri Reisit mirëpo ajo ballafaqohet me flotën portugeze dhe detyrohet të kthehet për shkak të epërsisë luftarake të saj. Pastaj sulltani e dërgon edhe flotën e dytë nën udhëheqjen e Ali Reisit, i cili çliron disa qytete lindore në jug të Siujdhesës

Arabe, i sulmon anijet e portugezëve si dhe kthehet nëpër tokë pas endjes së tij katërvjeçare në Persi dhe Indi dhe në vitin 963 h. i sjell sulltan Sulejmanit në Stamboll oferta të disa emirëve që kërkonin paqe me sulltanin.

Në historinë e "Mir'atul-memalik" dhe "El-Muhit" transmetohen ekspeditat e tij ngase nuk kemi mundësi t'i cekim këtu.

Pas kthimit të Turgut Reisit nga luftërat e tij kundër kusarëve të Detit Mesdhe, sulltan Sulejmani e autorizon t'i çlirojë Xherbën dhe Maltën.

Turgut Reisi pas një beteje të gjatë e çliron me sukses Xherbën me ç'rast i rritet fama dhe e fiton titullin "Pashë" prej sulltanit si dhuratë ndërsa Evropa fillon t'i frikohet ashtu siç i frikoheshte mësuesit të tij Barbaros Hajrudin Pashës.

Pas rrethimit të Maltës u shkaktua një mosmarrëveshje mes tij dhe Mustafë Pashës i cili ishte udhëheqës i flotës osmane, gjë që shkaktoi vrasjen e Turgut Pashës para kështjellës së Maltës (Zoti e mëshiroftë!), dhe tërheqjen e anijeve osmane në vitin 972 h. Gjatë kësaj beteje, ata nuk e kishin çliruar kështjellën por vetëm e kishin shkatërruar.

Sulltani ishte fatkeq me fëmijët e tij. (U cek më parë vrasja e djalit të tij, Mustafës), pastaj edhe grindja e gjatë mes dy fëmijëve të tij, Selimit dhe Pajazitit<sup>11</sup> për pozitë për shkak të intrigave të Rustem Pashës e që përfundon me ikjen e Pajazitit së bashku me fëmijët e vet në Persi dhe me strehimin te emiri Tahma Sibi, guvernator i Tibrizit, i cili i mbron katër vjet dhe në fund i lajmëron në Stamboll. Thuhet se Tahma Sibi ka qenë i

---

<sup>11</sup>Gruaja e sulltanit, Rokslana, e që njihej te turqit me emrin "Hurum" përpiquej ta sigurojë pozitën për djalin e saj Selimin, qoftë edhe me vrasjen e fëmijëve të sulltan Sulejmanit;

detyruar t'i vret të gjithë për shkak se Pajaziti kishte thurë një poezi ku cekej disfata e tij në luftën me sulltan Sulejmanin, dhe kështu kishte filluar t'i urrejë e më në fund i kishte vrarë "Zoti i mëshiroftë"!

#### *Ekspedita e trembëdhjetë dhe e fundit*

Në vitin 974 h. sulltan Sulejmani ishte dobësuar dhe mërzitur për shkak të vdekjes së fëmijëve të tij, kurse Maksimiliani, i biri i Ferdinandit, mbretit të Austrisë, mendonte se Shteti osman është dobësuar, kështu që e kishte ndalur pagimin e xhizjes dhe e kishte sulmuar Erdelin.

Kur kupton sulltan Sulejmani, përgatitë afro 80.000 ushtarë dhe niset për në Beograd. Kjo ishte ekspedita e trembëdhjetë dhe e fundit që kur kishte qëndruar në fronin e sulltanatit osman dyzet e tetë vjetë. Ai me sukses depërton në Hungari dhe përsëri e nënshton më 21. sefer 974 h, kur edhe vdes në moshën 74-vjeçare. Gjatë periudhës së tij dyzetetëvjeçare të qëndrimit në fronin e Perandorisë osmane popullit musliman në Lindje i siguroi autoritet dhe fuqi të madhe aq sa nuk mund të krahasohet me udhëheqësit tjerë të Islamit, eventualisht pas shekullit të dytë hixhrij, derisa edhe mbretërit e Evropës i janë përlur.

Me vdekjen e tij përfundojnë çlirimet islame në Lindje dhe fillon periudha e dobësimit dhe dekadencës, përpos disa çlirimeve në kohën e të birit të tij, sulltan Selimit të Dytë.

Gjatë ekspeditave dhe çlirimeve të sulltan Sulejman Kanunit nuk e kemi cekur rikthimin e Tripolitanisë në vitin 959/1551 nën udhëheqjen e Turgut Pashës, eventualisht pas okupimit

spanjoll prej emirit Muhammed ibn Hasan, i cili ishte zhytur në kënaqësitë e epshit, e që kishte zgjatur 43 vjet, apo prej vitit 916 h. deri në 959 h. Sulltan Sulejmani e ka caktuar pastaj Turgut Pashën vali të Tripolitanisë.

Periodha e sulltanatit të Sulejman Kanunit ishte periudhë e çlirimeve të suksesshme islame.

Sulltani kishte sukses në luftëra, ishte i shkathët dhe sillej me urtësi në raste kritike, i shkatërronte tradhtarët, quhej "Kanuni" ngase kishte qëndrim të denjë ndaj kanunit që e kishte përpiluar për interesat e vendit të tij në atë kohë. Në kohën e tij industria ka qenë e zhvilluar, shkenca ishte përhapur në krahë me kohën e stërgjyshërve të tij, kurse ushtria dhe marina luftarake kishin arritur aq progres, organizim dhe fuqi të madhe sa që ua kanë tejkaluar ushtrive të shteteve evropiane.

Emrat e qyteteve më të njohura që i ka çliruar janë: Beogradi, Rodosi, Tibrizi, Bagdadi, Timishoara, Adeni, Algjeri, Tripoli etj.

Para se të shuhet drita e jetës së tij, Shteti islam osman filloi të dobësohet në Lindje sepse çlirimet e këtij sulltani konsiderohen çlirime të fundit islame në Lindje pas shuarjes së Shtetit andaluzian islam në Perëndim.

Çdo gjë ndodhë sipas caktimit të All-llahut xh.sh.

Në përfundim të themi se sulltan Sulejmani ka lënë perandori të gjerë që shtrihet në tre kontinente: Rumeli, Bosnjë, Budim, Timishoarë, Sofje, Manastir, Shkodër, Janinë, Qustendil, Selanik, Shkup, Prizren, Prishtinë, Anadoll, Qipro, Sham, Tripoli, Rakka, Mosul, Dijarbakër, Van, Bagdad, Basra, Hassa, Jemen, Ankarë, Konja, Anatoli, Etiopi, Egjipt, Tripoliadë, Tunis, Algjer, Hixhaz, Hungari, disa vende të

Austrisë, Iran, bregdeti i Italisë, të gjitha ujdhesat e Detit Mesdhe, etj.

Çfarë pushteti të madh kemi humbur sot për shkak të injorancës, gjumit, vetëmashtrimit dhe politikës së gabuar!!!



**KREU I DYTË**  
**SHKAQET E ZGJIMIT EVROPIAN**



## **PJESA E PARË**

### **SI FILLOI EVROPA TË ZGJOHET**

Pas cekjes së dobësimit dhe shkatërrimit të Shtetit andaluzian islam, parashtrimin të shkaqeve të shkatërrimit, dhe pas çlirimeve të fundit islame në Lindje, mendojmë të cekim edhe shkaqet që e kanë përparuar Evropën, përgatitjen për rikthimin e vendeve të tyre nga duart e muslimanëve, pastaj dominimin dhe kolonializimin e vendeve islame.

Është e vërtetë se Andaluzia ishte qendër ku vinin emirët dhe bijtë e tyre për të mësuar në shkollat e larta islame edhe atë që nga shekulli i tetë (hixhrij), apo kur janë vendosur muslimanët në mbarë Andaluzinë.

Evropiani kthehej atëherë i pasuruar me njohuri nga shkencat moderne të asaj kohe që u shërbenin njerëzve, mirëpo si do t'i plotësonte zbrazëtirat e sociologjisë, teshri'it apo që sot njihen si "shkencat e jurisprudencës", jetës së pavarur, jetës revolucionare, eventualisht të çdo shkence shoqërore!

I mësuari kthehej në vendlindjen e tij, vërente dekadencën dhe mjerimin e madh përderisa në Andaluzinë islame lulëzonte jeta përparimtare, dhe fillonte të ngjallë jetën e re që e mbante në zemër prej Andaluzisë evropiane.

Grupacionet për të mësuar kanë vazhduar të shkojnë prej Evropë në Andaluzi deri në fund të shekullit të nëntë hixhrij, kur ka filluar të ngjallet shpirti i rilindjes në disa vende të Evropës, posaçërisht në jug dhe në qendër të Francës, pra aty ku banonin spanjollët autoktonë dhe francezët.

Gustav Leopoldi, historian i njohur francez, në librin e tij "Civilizimi arab në Andaluzi", ka cekur disa delegacione shkencore që i ka dërguar Evropa në<sup>1</sup> Andaluzi për t'i mësuar shkencat moderne (të atëhershme).

Kjo rilindje i nxiti spanjollët ta rikthejnë vendin e tyre dhe kanë patur fat sepse rrethanat ua mundësuan një veprim të tillë, eventualisht, për shkak të mosmarrëveshjeve, ndarjeve dhe armiqësive që ekzistonin mes emirëve muslimanë në Andaluzi. Në ato troje, spanjollët i kanë sulmuar muslimanët afër një shekull e gjysmë dhe kanë zhvilluar luftëra të ashpra derisa përfundojnë me ngadhënjimin e tyre dhe me dëbimin e muslimanëve nga pjesa e pasur me gjurmë të tyre në Spanjë.

Faktori i dytë i luftërave spanjolle kundër muslimanëve ishte frika nga kthimi i sërishëm i tyre dhe nga sulmi i dytë ndaj Francës pas dështimit të parë, duke u mbështetur në inteligjencën, civilizimin dhe diturinë e tyre të gjerë.

Gjithashtu edhe priftërinjtë kanë luajtur rol të rëndësishëm në nxitjen e emirëve spanjollë ngase ata frikoheshin më tepër prej rikthimit islam se të gjithë pjesëtarët tjerë të popullit.

Si në Perëndim ashtu edhe në Lindje ngjarjet ishin të njëjta por me një formë interesante politike dhe pikëlluese.

---

<sup>1</sup>Tre delegacione franceze, një anglez e disa spanjollë. Delegacionin e parë francez e ka udhëhequr Elizabeta, e bija e hallës së Lujit të gjashtë, kurse atë anglez princesha angleze.

Kur i cekim shkaqet e dobësimit të territoreve islame (posaçërisht Shtetit osman), vërejmë se udhëheqësit osmanë bënë presion mbi banorët e ujdhesave dhe të vendeve që i nënshtronin, ndonjëherë silleshin në mënyrë njerëzore e ndonjëherë jo, me haraçe të mëdha, përkundër metodës së çliruesve të parë dhe kështu, Evropa i bashkon forcat detare për shkatërrimin e fuqisë osmane, dhe sikur të mos ekzistonte mosmarrëveshja mes Karlit të Madh spanjoll dhe Fransoas së Parë francez, Evropa do të bashkohej dhe përsëri do të zhvilloheshin kryqëzatat mes Lindjes e Perëndimit. Luftërat do të ishin aq të rrepta sa që do ta humbnin jetën shumë njerëz për shkak të zbulimit të topave që nuk ekzistonin gjatë periudhës së parë të kryqëzatave.

Evropa e kuptoi se nuk mundet ta shkatërrojë Shtetin osman pos me shkencë dhe metoda politike, dhe kështu, filloi ta shpërndajë shkencën nga Andaluzia dhe aksiomatikisht i ka fituar edhe metodat politike. Evropa në fillim ka filluar me lidhjet politike mes sulltan Sulejman Kanunit dhe Fransoas së Parë, mbretit francez, bile edhe mosmarrëveshjet mes dy mbretërve të mëdhenj Karlit të Madh dhe Fransoas kanë ndikuar në mënyrë të tërthortë në Shtetin osman për shkak të moskujdesit të politikanëve osmanë.

Çdo gjë ndodhë sipas dëshirës së All-llahut!

Thamë se për shkak të grindjes me Karlin e Madh, Fransoa i Parë ka kërkuar ndihmë prej sulltan Sulejman Kanunit, ngase ai e kishte robëruar dhe dërguar në Spanjë, dhe për këtë shkak mbreti Fransoa kishte dërguar emisarin francez, Zhan Frankianin nga fundi i vitit 1525 në Stamboll, gjë që e vërteton fuqinë osmane të atëhershme.

Autoritetin e lartë të sulltan Sulejmanit dhe fuqinë e Perandorisë osmane e vërteton edhe mesazhi i sulltanit dërguar për çlirimin e Fransoas së Parë në vitin 932 h.

Letra e sulltanit fillon kështu:

*"Prej Sulejmanit...*

*Në emër të All-llahut, Bamirësit dhe Mëshiruesit të Përgjithshëm!*

*Me madhërinë e All-llahut Fuqiplotë e të Lartmadhëruar, me mrekullitë e profetit të fundit, Muhammedit a.s. që është shembull i besimtarëve dhe me shpirtrat e shenjtë të të katërve: Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Aliut (r.a.), dhe të gjithë evlijave të All-llahut, unë jam sulltan i sulltanëve, zemërgjerë, kurorëzues i mbretërve, hija e Zotit në tokë, sulltan i Detit Mesdhe, të Zi, Anadollit, Rumelisë, Karamanëve, Dijarbekrit, Kurdistanit, Azerbajxhanit, Persisë, Shamit, Halebit, Egjiptit, Mekkes, Medines, Kudusit, i mbarë vendeve arabe, Jemenit dhe i shumë territoreve tjera që i kanë çliruar etërit e mi fisnikë dhe stërgjyshërit viganë me fuqi të papërshkruar (Zoti i shpëtoftë), si dhe i vendeve që i kam çliruar unë.*

*Prej meje, sulltan Sulejman Hanit ibn sulltan Selim Hanit ibn sulltan Pajazit Hanit, Frensisit, mbretit të vilajetit të Francës. Më ka ardhur letra, që e keni dërguar me emisarin tuaj Frankijanin e aftë e që më informoi me të për disa çështje, dhe gojarisht më njoftoi se armiku i juaj e ka okupuar territorin tuaj dhe se ju jeni tash i burgosur si dhe kërkoni që të përpiqem që t'ju liroj. Çdo gjë që keni thënë është shtruar para nesh dhe është e njohur për ne*

*detalisht. Çdo gjë e kam kuptuar dhe nuk është për t'u habitur burgosja e mbretërve e as dobësimi i tyre.*

*Bëhu zemërgjerë e mos kujto shumë sepse etërit e mi fisnikë dhe stërgjyshërit viganë (Zoti i shpëtoftë) nuk kanë ikur nga lufta për çlirimin e vendeve dhe për përballimin e armikut; edhe ne jemi në rrugën e tyre dhe në çdo kohë çlirohen vendet e vështira dhe kështjellat e fuqishme ndërsa kuajt tanë natë e ditë janë të shaluar.*

*Zoti e lehtëson mirësinë me dëshirën e vet!*

*Çështjet tjera do t'i kuptoni nga emisari i juaj i përmendur dhe ta dini se do të liroheni në fillim të muajit të tretë hixhrij të vitit 932 h. në vendin e Sulltanatit të lartë të Konstantinopojës, të mbrojtur e preventiv".*

Sulltani, pas dërgimit të letrës që ruhet sot në muzetë e Francës, me të vërtetë e realizon premtimin e tij dhe e lufton Ferdinandin, mbret i Austrisë dhe vëlla i Karlit të Madh, derisa ngadhënjën (detalisht kemi folur për këtë në çlirimet e sulltan Sulejmanit - kreu i parë) dhe e shpëton Francën prej tiranisë së tij.

Kështu, marrëdhëniet mes osmanëve dhe Francës janë përforcuar dhe zmadhuar në mënyrë të jashtëzakonshme.

Në vitin 1532, sulltan Sulejmani priti një emisar të Francës në Beograd (zotëriun Renson), pas kthimit nga rrethimi i Vjenës, kryeqytet i Austrisë, me reshtimin e ushtarëve në të dy anët e emisarit dhe topat kanë gjuajtur për nder të tij, kurse emisarët e mbretërve tjerë i ka pritur me nënçmime. Edhe Franca është dashur të veprojë në mënyrë të tillë ndaj Shtetit osman për shkak të ndihmave dhe shërbimeve që ia ka ofruar.

Sulltan Sulejmani i ndjerë gjithashtu ka qenë i obliguar të kuptojë një gjë të tillë, mirëpo, siç shihet, ai ka dashur t'ia tregojë Francës madhështinë dhe dëshirën e tij në likuidimin e armiqve të tij e të saj.

Franca e ka shfrytëzuar me mjeshtri këtë shoqëri, bile edhe këtë naivitete të politikanëve të Shtetit osman. Ajo e dërgoi në fillim të shtatorit të vitit 1536 ambasadorin La Forie, i cili me shkathësitë e tij ka mundur të nënshkruajë me sulltan Sulejman Kanunin kontratën e verifikuar edhe në divanin e sulltanatit ku thuhet se francezët që vijnë nga Franca për të banuar në Shtetin osman gëzojnë disa privilegje.

Teksti origjinal është arabizuar nga kodi i Baron de Testa:

"Le ta dinë të gjithë se në muajin... të vitit 942 (sipas hixhretit të Muhammedit) apo në shkurt të vitit 1536, në Stambollin famëlartë mes z. Zhan de Lafories, të caktuar si kancelar dhe ambasador i ekselencës, emirit të thelluar në krishterim dhe mbretit të Francës, Fransoas, te perandori famëlartë, i fuqishëm e ngadhënjyes, sulltan Sulejman Hakani turk (deri në fund të titujve të tij) dhe mes emirit famëlartë, të fuqishëm dhe kryesor në ushtrinë e sulltanit, pas shqyrtimeve rreth luftës dëmtuese dhe paqes që siguron qetësi e kënaqësi e nënshkruajnë kontratën që i përmban nenet vijuese:

*NENI I PARË*<sup>2</sup>: Të ty kontaktuesit, si zëvendës të ekselencës së halifit më të madh dhe të mbretit të Francës nënshkruajnë për paqe të vërtetë dhe marrëveshje të sinqertë gjatë tërë jetës së të dyve në të gjitha territoret, vilajetet, kështjellat, qytetet,

---

<sup>2</sup>Këtë kontratë të marrur nga libri "Historia e Shtetit osman", e cekim vetëm për ta informuar lexuesin se sa të pakujdesshëm kanë qenë politikanët osmanë në kohën e Kanunit.

limanet, gjiret, detet, ujdhesat, territoret e nënshtruara ose që hyjnë nën mbrojtjen e tyre më vonë, ashtu që ju lejohet banorëve të të dy vendeve të udhëtojnë me anije të sigurta ose të pasigurta nëpër të dy vendet, qëndrimin në të dy vendet ose kthimin në gj, qytet, etj., me qëllim tregtie sipas dëshirës së tyre dhe me liri të plotë pa kurrfarë dëmtimi të tyre ose të tregtisë së tyre.

*NENI I DYTË:* Banorëve të të dy palëve u lejohet shitblerja e të gjithë artikujve të lejuar, udhëtimi dhe transportimi i tyre tokësor e detar prej një mbretërie në tjetrën me pagesë tatimi të zakonshme qysh më herët, ashtuqë francezët paguajnë në Shtetin osman ashtu siç paguajnë turqit, si dhe turqit në Francë paguajnë njëjtë sikur francezët pa kurrfarë pagesa ose tatime tjera.

*NENI I TRETË:* Çdoherë kur cakton mbreti i Francës konsull në Stamboll ose në qytetet tjera të Perandorisë osmane si p.sh. caktimi i tashëm i konsullit në Aleksandri, pritet dhe trajtohet ashtu siç i takon, obligohet të dëgjojë, gjykojë e vendosë sipas kanunit dhe ndërgjegjes së tij në çdo rast që është në kompetencat e tij, prej çështjeve qytetare e penale mes përkatësve të mbretit të Francës pa ndërhyrjen e gjykatësit, kadisë së shariatit (subashit) ose të ndonjë funksionari tjetër. Nëse ndokush prej francezëve refuzon respektimin e urdhërave ose vendimeve të konsullit, konsulli mund të kërkojë ndihmë prej funksionarëve të ekselencës së sulltanit për aplikimin e tyre. Sidoqoftë, nuk i lejohet kadiut të shariatit ose ndonjë funksionari tjetër të gjykojë konfliktet mes tregtarëve francezë dhe të tjerëve që i përkasin mbretit të Francës edhe

nëse kërkojnë prej tyre një akt të tillë; edhe nëse gjykon në raste të tilla, gjykimi kategorisht anulohet dhe nuk aplikohet.

*NENI I KATËRT:* Paditë qytetare që i ngrenë turqit, mbledhësit e haraçit ose njerëzit tjerë të ekselencës së sulltanit kundër tregtarëve ose shtetasve tjerë francezë si dhe gjykimet nuk lejohen, derisa paditësit nuk kanë leje ose fakt zyrtar prej kadiut të shariatit apo të konsullit francez, e nëse e kanë atëherë një akt i tillë realizohet vetëm me praninë e përkthyesit të konsullatës.

*NENI I PESTË:* Nuk u lejohet gjykatësve të shariatit ose funksionarëve tjerë të Shtetit osman të marrin parasyshë çfarëdo padie penale ose ndonjë vendim kundër tregtarëve dhe shtetasve të Francës në bazë të ankesave të turqve, mbledhësve të haraçit ose të shtetasve tjerë të Shtetit osman, por gjykatësi ose funksionari që është kompetent për akte të tilla, obligohet të thirrë praninë e të paditurve në Portën e Lartë eventualisht në zyrën zyrtare të kryeministrit. Në rast se nuk ekziston porta e tillë (gjegjësisht nëse ndodhë diçka jashtë Stambollit), thirren para funksionarëve më të mëdhenj të Shtetit osman dhe atëherë do të vlejë pranimi i dëshmisë së mbledhësit të haraçit dhe personit francez kundër njëri-tjetrit.

*NENI I GJASHTË:* Nuk lejohet të gjykohen tregtarët francezë, shfrytëzuesit dhe shërbëtorët e tyre për çështjet fetare para kadisë, sanxhakbegut, subashit ose funksionarëve tjerë por gjykohen para Portës së Lartë, kurse në anën tjetër u lejohet praktikimi i ceremonive fetare; nuk mund të obligohen në Islam ose të konsiderohen muslimanë derisa vet, pa dhunë, nuk deklarohen.

*NENI I SHTATË:* Nëse një ose më shumë shtetas të Francës lidhin kontratë me ndonjë osman apo kanë ble rë prej tij artikuj apo kanë marrur prej tij borxh dhe del jashtë territoreve osmane para realizimit të kontratës, kategorisht nuk pyetetet konsulli, as të afërmit e tij e as ndonjë person francez, gjithashtu as mbreti i Francës nuk përgjigjet për diçka, por obligohet paditësi të kërkojë prej të paditurit ose pasurisë së tij nëse gjendet në territoret e shtetit francez ose nëse ka në të pasuri.

*NENI I TETË:* Nuk lejohet të shfrytëzohen tregtarët francezë, shfrytëzuesit, shërbëtorët ose anijet dhe gjërat që gjenden në to, topat, municioni ose tregtia pa pëlqimin e tyre në shërbim të ekselencës së sulltanit famëlartë ose të ndonjë njeriu tjetër në tokë e në det, derisa ta pranojnë vet vullnetarisht një gjë të tillë.

*NENI I NËNTË:* Tregtarët francezë dhe shtetasit tjerë të Francës kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë të gjitha pasuritë me testament pas vdekjes natyrore ose jonatyrore dhe ndahet pasuria sipas porosive të testamentit, e nëse vdes pa testament, e trashëgon trashëguesi ose zëvendësi i tij me dije të konsullit nëse ka konsullatë e nëse jo, atëherë me dijen e kadisë së vendit. Nëse ka konsullatë, kadiu ose funksionari i financave nuk kanë kurrfarë të drejtë në caktimin e trashëgimisë, e nëse ndodhë diçka e tillë, atëherë i dorëzohet konsullit ose zëvendësit të tij nëse e kërkon para tashëgimtarit ose zëvendësit të tij. Konsulli obligohet t'ia dërgojë (trashëgiminë) pronarit të saj dhe t'ia dorëzojë.

*NENI I DHJETË:* Me anë të kësaj kontrate mes ekselencës së sulltanit dhe mbretit francez, të gjithë shtetasit që gjenden në vendet e të dyve, në anije, në territor ose provincë që i përket

autoritetit të të dyve, në rast robërimi, qoftë me shitblerje ose robërim lufte, menjëherë lirohen vetëm me kërkesë ose deklaratë të ambasadorit, konsullit ose ndonjë të autorizuari tjetër, edhe nëse ndonjëri prej tyre e ka ndërruar fenë dhe besimin e tij. Prej tash e tutje nuk i lejohet ekselencës së sulltanit ose mbretit të Francës e as udhëheqësve të detit, luftëtarëve ose ndonjë personi tjetër që i përket njërit prej të dyve ose atë që e shfrytëzojnë, qoftë në tokë ose në det, marrja, shitblerja, burgosja e robërve të luftës, vlerësimi i kusarëve, konfiskimi i pasurisë së tundshme e të patundshme. Nëse eventualisht ndodhë diçka, lajmërohet mbreti dhe dënohet për shkak të mosrespektimit të kushteve paqësore si shembull për të tjerët, i rikthehen gjësendet e konfiskuara pronarit, e nëse jo, atëherë ndalohet hyrja e tij dhe bashkëpunëtorëve të tij në shtet; pushteti të cilit i përket e konfiskon pasurinë e tij dhe e kompenson të dëmtuarin nga pasuria e konfiskuar; i dëmtuari mbështetet për kompensim në garantuesit e kësaj kontrate e që janë autoritetet ushtarake nga pala osmane dhe gjykatësit suprem nga pala e mbretit të Francës.

*NENI I NJËMBËDHJETË:* Nëse ballafaqohen anijet e shteteve në kontratë me ato të shtetit tjetër, detyrohen t'i lartësojnë flamujt e shtetit që i përkasin për të mos u konfiskuar e as të maltreohen nga anijet luftarake. Nëse eventualisht shkaktohet ndonjë dëm obligohet menjëherë kompensimi. Nëse takohen anijet e të dy shteteve, lartësohet flamuri, përsëndesin me një gjuajtje topi dhe përgjigjen sinjerisht në rast pyetjeje rreth shtetit përkatës. Pas

marrëveshjes mes tyre nuk lejohet të kontrollohen me forcë e as të pengohen.

*NENI I DYMBËDHJETË:* Nëse arrinë ndonjë anije franceze rastësisht apo me qëllim në ndonjë qytet ose bregdet të shtetit të Lartë, e furnizon me ushqim dhe paguhet me çmim të realltë pa e detyruar me zbritjen e gjërave për të përfituar çmimin pastaj lejohet të shkojë kudo që dëshiron. Nëse arrinë në Stamboll dhe dëshiron të del pas lajmit për dalje nga dogana, pagimit të obligueshëm dhe kontrollimit me lejen e përgjegjësit, nuk lejohet kontrollimi i saj në asnjë vend tjetër pos në qendrën e Dardaneleve pa kurrfarë pagese, as te Gryka e as në ndonjë vend tjetër përveç asaj që është paguar, qoftë kërkesa në emër të ekselencës së sulltanit ose të ndonjë funksionari tjetër.

*NENI I TREMBËDHJETË:* Nëse fundoset ose shkatërrohet anija e njërit prej të dy shteteve rastësisht ose jorastësisht në territoret përkatëse, ai që shpëton është i lirë dhe i merr gjërat që i takojnë pa kurrfarë pengese.

Nëse fundosen të gjithë njerëzit, sendet e shpëtuarat i dorëzohen konsullatës ose zëvendësit për t'ua dërguar pronarëve. Kapidan pasha, sanxhak beu, subashi, kadiu e as funksionarët tjerë të shtetit nuk kanë të drejtë të marrin diçka, e nëse marrin dënohen rreptësisht. Funksionarët obligohen t'i ndihmojnë të autorizuarit për pranimin e gjërave të përmendura.

*NENI I KATËRMBËDHJETË:* Nëse ikë ndonjë rob prej osmanëve dhe kërkon mbrojtje në shtëpinë ose anijen e francezit, lypet në shtëpinë ose anijen e francezit. Nëse gjendet tek ai, francezi dënohet me dijen e konsullit kurse robi i kthehet

zotëriut të tij. Eventualisht, nëse nuk gjendet në shtëpinë ose anijen francezit, atëherë nuk pyetet për të fare.

*NENI I PESËMBËDHJETË:* Çdo shtetas i Francës nëse nuk ka qëndruar në territoret e Shtetit të Lartë plot dhjetë vjet pandërprerë, nuk obligohet të paguaj haraç ose tatim tjetër, as t'i mbrojë vendet fqinje, as në depo të ekselencës së sulltanit, as të punojë në kantier anijesh e as ndonjë punë tjetër. E njëjta gjë vlen edhe për shtetasit osmanë në Francë. Mbreti francez ka kushtëzuar që të jetë për papën dhe mbretin e Anglisë vëlla dhe aleat i përhershëm si dhe të jenë pjesëmarrës në këtë kontratë nëse dëshirojnë por me kusht që ta lajmërojnë ekselencën e sulltanit dhe të kërkojnë pëlqimin e tij brenda afatit tetëmuajorë, që fillon me datën kur është shkruar.

*NENI I GJASHTËMBËDHJETË:* Ekselencia e sulltanit dhe mbreti i Francës ia dërgojnë njëri - tjetrit verifikimin e kësaj kontrate brenda gjashtë muaj prej datës së nënshkrimit, me premtim se të dy do ta mbrojnë dhe se do t'i këshillojnë të gjithë funksionarët, kaditë, nëpunësit tjerë dhe të gjithë banorët që t'i mbrojnë të gjitha tekstet me përpikshmëri e për të mos pretenduar ndokush se nuk e di këtë kontratë, kopjet e saj do të shpërndahen në Stamboll, Aleksandri, Egjipt, Marsej dhe në të gjitha vendet e njohura, si në tokë ashtu edhe në det, që u takojnë të dy shteteve;

Përfundon...!!!"

Kjo është kontrata që e ka realizuar Franca me Shtetin osman duke i falënderuar shkathtësisë së ambasadorëve të saj.

Kemi bërë përpjekje të gjejmë dobinë që e ka fituar Shteti osman prej kësaj kontrate, por hasim vetëm dëm të madh, pastaj habitemi me nenet që i ka pranuar Shteti osman për

kufizimin e vetvetes, edhe pse shteti nuk kishte nevojë për një kontratë të tillë duke e marrë parasyshë fuqinë dhe madhësinë e tij.

Nga e gjithë kjo që u cek konkludojmë dy gjëra:

1. Francezët kanë përparuar në shkencë për shkak të afërsisë së tyre me vendin e shkencës (Andaluzinë) dhe marrjes së shkencës prej andaluzianëve, kurse osmanët përkundrazi, asgjë nuk kanë marrur prej shkencave të vëllezërve të tyre andaluzianë, por e kanë lënë Perëndimin të përparojë me të. Pas shkatërrimit të shtetit andaluzian, osmanët e kanë kuptuar qëllimin e Evropës për shkatërrimin e shtetit islam por ishte shumë vonë.

2. Në kushtet paqësore të Francës gjejmë intriga dhe komplete nga brendësia e sulltanatit dhe nuk mohohet që Ibrahim Pasha el-Muhtedi (ministër i sulltan Sulejmanit) të jetë aktori kryesor.

Përgjithësisht, kjo kontratë ishte faktor shumë i rëndësishëm për ndërhyrjen e Francës, e më vonë edhe të shteteve të Evropës në çështjet e Perandorisë osmane, posaçërisht në krizat e fundit deri më sot.

Sipas mendimit tim, njerëzit e tillë si Ibrahim Pasha, Rustem Pasha e kanë futur Shtetin osman në këtë kurthë për t'i nënçmuar muslimanët. Kjo ishte njëherit edhe fitore rikthyesë e Evropës. Ky dorëzim është një ndër lëshimet më të mëdha të sulltan Sulejman Kanunit, që ka shkaktuar pas vdekjes së tij, në trupin e shtetit, shumë sëmurje dhe dëme prej të cilave ende vuajmë.

Larg është shpëtimi i shtetit prej kësaj fatkeqësie!

I madhëruar është All-llahu, i cili lartëson dhe poshtëron!

Gjendja keqësohet edhe më tepër kur këto kontrata të vjetra, të cilat i kishin përfituar Franca dhe Anglia prej sulltan Sulejmanit, ripërtërihen në kohën e sulltan Ahmedit të Parë në vitin 1604, bile edhe me disa shtojca sepse edhe Holandës i lejohet ajo që i ishte lejuar Francës.

Franca, e cila kishte fituar kontratë të çmueshme prej Shtetit osman, nuk i ka mbrojtur të drejtat dhe interesat e osmanëve por ka lejuar që Austria, Polonia, Venediku, Malta e murgjive, Papa dhe Rusia të bashkohen e t'i shpallin luftë të shenjtë. Admirali Dokin i sulmonte gjiret osmane me anije dhe i dënonte, gjë që ndikonte në Shtetin osman. Franca largohet nga kontrata për ta përfunduar luftën e shenjtë që e kishtë proklamuar me nxitjen e Papës në vitin 1683, që përfundon me thyerjen e muslimanëve. Pastaj vjen Mustaf Pasha, në kohën e sulltan Sulejmanit të Dytë, ua kthen sulmet atyre shteteve dhe e rikthen shumicën e territoreve.

Në vitin 1709 Petri i Madh përgatitet për luftimin dhe shkatërrimin e Shtetit osman, mirëpo i kundërvihet Balltaxhi Muhammed Pasha në kohën e sulltan Ahmedit të Tretë me 200.000 ushtarë dhe e rrethon së bashku me bashkëshorten e tij Katarinën. Sikur të mos e mashtronte ajo me bukurinë dhe thesarin e saj, Rusia sot do të ishte vetëm emër e jo realitet.

Gjëja më e çuditshme që ka ndodhur tek osmanët, është se Franca, pas shkeljes së kontratës e shfrytëzon rastin e luftërave të shumta që i shpallte Evropa kundër Shtetit osman. Në vitin 1740 u ripërtërinë privilegjet e vjetra në kohën e Lujit të Pesëmbëdhjetë me disa lehtësime për Francën.

Pas vitit 1740 fillojnë të shpëputen prej territoreve të Shtetit të Lartë kështjellat dhe provincat njëra pas tjetrës, me intriga të

shteteve evropiane, me mashtrime deri në vdekjen e Petrit të Madh dhe me shpalljen e testamentit të tij të njohur, që do ta cekim më vonë, varësisht nga dëshira e All-llahut të Madhëruar.



## **PJESA E DYTË**

### **BASHKIMI EVROPIAN KUNDËR PERANDORISË OSMANE**

Lexuesi nga kjo që u cek pak më parë vëren se shtetet evropiane bashkoheshin dhe e nxitnin Papën për sulm kundër Shtetit osman e për ta dëbuar nga territoret që i ka çliruar, edhe atë duke e shfrytëzuar rastin e mosmarrëveshjeve, trazirave të brendshme dhe zhvillimin e luftërave mes Shtetit osman dhe disa shteteve të Evropës Lindore, Jugore e Qendrore. Tash mendojmë t'i cekim shkaqet e këtij bashkimi që ishin formuar nga zgjimi i mbarë Evropës.

Thamë se Papa i nxiste shtetet evropiane për ta luftuar Shtetin osman dhe se Franca kishte kontratë konsullare me Portën e Lartë. Kur Shteti osman kërkoi ndihmë prej Francës, Papa së bashku me të gjitha shtetet e Evropës e bindnin që të mos pranojë (Në opinionin e tyre, Franca ishte shtet tradhtar për shkak të kontratës së saj me një shtet islam që ishte armik i tyre), bile Papa i ishte kërcënuar Francës se do t'i ndërpresë të gjitha marrëdhëniet me te. Më në fund, mbreti Fransoa i Parë refuzon t'i ndihmojë shtetit aleat osman dhe kështu kjo luftë fillon të zhvillohet mes shteteve të bashkuara kundër vetëm një shteti.

Me ndihmën e All-llahut, pjesën më të madhe të Hungarisë dhe të Serbisë e rikthen edhe pse shtetet evropiane ishin kompakte që t'i çlirojnë nga ushtria osmane.

Derisa këto ngjarje zhvilloheshin në Evropën Juglindore për shkak të "zgjuarjes" së qeverive evropiane dhe përhapjes së "shpirtit progresiv në shoqëri", Evropa Jugperëndimore gjithashtu zbatonte të njëjtën metodë ndaj shtetit islam në Andaluzi, bile ishte edhe më e rreptë për shkak të dy faktorëve të rëndësishëm:

1. Grindja mes muslimanëve.

2. "Progresi" në pjesën më të madhe të spanjollëve e portugezëve si dhe depërtimi i shkencave dhe arteve arabe.

Nga fundi i vitit 1017 h. të gjithë muslimanët janë deportuar nga Siujdhesa e Andaluzisë, xhamitë janë shndërruar në kisha, kurse në Lindje Shteti osman luftonte me fuqi të çuditshme ngase ishte ende shtet i ri, përkundër shtetit të Andaluzisë që ishte mplakur dhe kishte mbushur 980 vjet.

Derisa pjesa më e madhe e banorëve të Evropës Perëndimore punonte në deportimin e muslimanëve prej vendeve të tyre shekullore islame dhe i luftonte në mënyra të ndryshme, herë me shpatë e herë me intriga, kurthe dhe mashtrime, një grup prej tyre lundronte nëpër dete për të "zbuluar" Indinë dhe rrugën që shpiente kah ajo, duke u mbështetur në literaturën arabe dhe artet që i kishin marrur prej arabëve, si p.sh. Kristofor Kolombo e "zbulon" Amerikën, Vasko de Gama "zbulon" Kepin e Shpresës së Mirë (në jug të kontinentit afrikan) e pastaj edhe rrugën e Indisë, ndërsa menjëherë pas "zbulimit" Afrika Lindore okupohet në vitin 1503.

Në vitin 1507 "zbulohet" dhe okupohet ujdhesa e Zanzibarit, kurse në vitin 1509 "zbulohet" India dhe okupohet në emër të qeverisë portugeze.

Prej atëherë, dashuria për kolonializim dhe ekspansion fillon të zgjerohet në shtetet e Evropës dhe kështu, Holanda, Anglia, Franca pastaj edhe Gjermania fillojnë ta imitojnë Spanjën dhe Portugalinë, ngase "rilindja evropiane zhvillohej shumë shpejtë pas depërtimit të shkencave të arabëve andaluzianë dhe joandaluzianë, dhe rrymat ideologjike në Evropë fillojnë të ndryshojnë prej një faze në fazë tjetër. Metoda luftarake e hershme e Evropës ishte mbrojtje me dorëzim mirëpo me ndryshimin e kohës, shndërrohet në metodë kolonialiste ekspansioniste.

Kështu, aspiratat e shteteve evropiane zgjerohen aq shumë saqë fillon edhe grindja mes tyre, p.sh. disa luftëra janë zhvilluar mes Anglisë, Francës dhe Spanjës. Me ardhjen e tij në skenën politike franceze, Napoleoni zhvillon luftëra të tmerrshme dhe e okupon pjesën dërrmuese të mbretërive evropiane.

Evropa nuk e harron shtetin islam osman në Lindje pas shkatërrimit të shtetit islam andaluzian në Perëndim, por orvatet t'i kthejë të gjitha vendet që i kanë çliruar muslimanët.

Në të vërtetë, prej zbulimeve të vendeve të panjohura nuk kishin kaluar as 100 vjet apo në vitin 1650 Evropa tashmë e kishte pushtuar mbarë Amerikën, pjesën dërrmuese të Indisë, dhe shumë siujdhesa e provinca afrikane. Çdo shtet evropian mori nga një pjesë për vete në të gjitha vendet e zbuluara.

Më vonë, "progresi qytetar dhe shoqëror" fillon të përhapet në Angli dhe Francë, qeveritë fillojnë të formohen me model të ri

që njihet sot si "parlament". Për këtë shkak janë zhvilluar disa revolucione në Angli, posaçërisht Franca ka derdhur shumë gjak dhe ka ndërruar shumë frone derisa stabilizohet gjendja në kohët tona, sipas kërkesave të këtyre dy popujve.

Më vonë, ky "progres" zhvillohet edhe te shtetet tjera evropiane derisa të gjitha shndërrohen në shtete "parlamentare".

Thamë më parë se shtetet e Evropës bënë përpjekje që ta shkatërrojnë Shtetin osman dhe t'i bëjnë ballë. Për ta realizuar këtë qëllim, janë mbështetur në tri metoda:

*METODA E PARË:* Zhvillonin luftëra kundër Shtetit osman pa kurrfarë shkakut ose motivi si p.sh. luftërat e Hungarisë që i kishin shpallur shtetet e Unitetit të shenjtë nën ndikimin e Papës. Si zakonisht, qëllimi dihet, pra, shkatërrimi i Shtetit osman dhe deportimi i muslimanëve nga Evropa.

*METODA E DYTË:* Gjatë konflikteve luftarake me Shtetin osman, Evropa përballohej me fuqi të jashtëzakonshme, dërgonte ambasadorë e emisarë në kryeqendrën e hilafetit dhe nënshkruante kontrata që përmbanin shumë intriga<sup>1</sup>, bile u ndihmonin edhe disa funksionarë të sulltanëve, të cilët shtireshin me Islam, ashtu siç kishte ndodhur me kontratën konsullare

---

<sup>1</sup>Edhe Franca, e cila kishte përfituar shumë prej Shtetit osman në kohën e sulltan Sulejman Kanunit, ka filluar t'u dërgojë ambasadorëve të vet mesazhe sekrete në kohën e sulltan Muhammedit të Katërt ku kërkohej prej tyre të thurin intriga brenda Perandorisë osmane. Veziri Kypyrli Muhammed Pasha ka zbuluar mesazhe të tilla në Edrene, dhe kur ka kërkuar prej ambasadorit (francez) t'i sqarojë, ai ka refuzuar. Kështu, shteti e ka burgosur të birin e ambasadorit për shkak të sjelljes jonjerëzore ndaj vezirit dhe prej këtij momenti Franca haptazi fillon t'u ndihmojë armiqve (të Shtetit osman);

mes Francës, Anglisë dhe Holandës, ndërsa vet Mustafa Pasha, kryeministër në kohën e Muhammedit të Katërt, ka deklaruar se ka shitur kontrata kundër shtetit ashtu siç shiten artikujt.

*METODA E TRETË:* Disa shtete të mëdha të Evropës: Rusia, Franca dhe Austria i dinin pozitën e dobët të Shtetit osman dhe pritnin rastin e volitshëm për ta sulmuar pikërisht në ato pozita, herë me shpatën e herë me lojërat e tyre politike, ngase shumica e vezirëve të sulltanëve osmanë kishin pak përvojë, bile ishin edhe fare pa përvojë në çështjet politike. Disa prej tyre nuk ishin të sigurtë, p.sh. ambasadori i Francës në kohën e sulltan Mahmut Hanit të Parë e udhëhiqte politikën lindore dhe perëndimore si dhe luante role të shumta në pallatin e sulltanit, derisa e ka obliguar Shtetin osman të nënshkruajë kontratë mbrojtjeje e sulmi me mbretërinë e Suedisë. Dihet se mbretëria e Suedisë shtrihet në Veri të Evropës, pra çfarë interesi ka prej kësaj kontrate? Ambasadori kishte për qëllim ta nxisë Rusinë në ndërmjetësim, eventualisht me Shtetin e Lartë.

Ai zakonisht i gënjente vezirët e shtetit, kinse Rusia do ta sulmojë Perandorinë osmane dhe do ta okupojë Konstantinopojën, kurse bashkimi i osmanëve me Suedinë e huton dhe e pengon Rusinë.

Edhe pse këto pretendime janë të realta sipas aspektit politik, qëllimi i ambasadorit ishte që Rusia ta shkatërrojë Shtetin osman.

Prej këtyre tri metodave të lartpërmendura konkludojmë se Shteti osman nuk ka patur baraspeshë mes diturisë dhe fuqisë; ai ishte i fuqishëm me ushtri por i dobët me funksionarë, gjë që

nuk ishte në rregull në një perandori të madhe e të fuqishme si ajo osmane.

Çfarë dobie ka prej çlirimit të vendeve me fuqi të madhe nëse nuk i adaptohen formës së civilizimit osman? Evropa në atë kohë kishte fuqi në funksionarët e saj por jo edhe në ushtri, pra rasti ishte krejtësisht i kundërt me atë osman, por me kalimin e kohës bëhet e fuqishme me funksionarë, ushtarë, financa dhe me çdo gjë që ka lidhje me jetë, ngase përpjekja për superioritet dhe autoritet e detyronte të vrapojë pas çdo gjëje të dobishme e të vlefshme. Me Shtetin osman ndodhte e kundërta, pra, u ishte dorëzuar faktorëve të dekadencës dhe injorancës derisa dallimi mes tij dhe Evropës është bërë sa prej toke deri në qiell.

Pashë Zotin, si mund t'u përballojë këtyre shteteve, prej të cilave në këtë kohë mvaret jeta apo vdekja e perandorisë?!

Në kohën e sulltan Muhmudit të Dytë, Abdurmexhidit, Abdulazizit dhe Abdulhamidit është ndier njëfarë zgjimi mirëpo është shuar dalëngadalë në kohën e Abdurmexhidit dhe Abdulazizit. Kur ka ardhur koha e Abdulhamidit, gjendja e shtetit është keqësuar edhe më tepër pas orvatjeve reformiste të Abdurmexhidit. Gjendjen e tillë e ka përjetuar edhe sulltan Reshadi.

Nga ky sqarim, lexuesi kupton se shkaqet e zgjimit evropian qëndronin pas moskujdesit tonë, përçarjes së muslimanëve dhe përqëndrimit evropian në shkencë.

Përçarja e shteteve muslimane dhe zgjimi i shteteve evropiane ia kanë mundësuar Perëndimit dominimin në Lindje pas një kohe kur Lindja dominonte në shtetet e Evropës me lehtësi të plotë.

Por, kjo është dëshira hyjnore dhe ndoshta do t'i kthehet  
Lindjes lindja e saj!  
All-llahu është i Plotfuqishëm!



**KREU I TRETË**  
**ISLAMI GJATË KOHËVE TË FUNDIT NË**  
**LINDJE**



---

## **SHKAQET E DOBËSIMIT TË SHTETIT OSMAN**

Pas rezymesë së gjendjes në Andaluzi dhe shktarrimit të saj si dhe çlirimeve të fundit islame në Lindje, mendojmë se jemi të obliguar t'i cekim shkaqet e dobësimit të vendeve islame në Lindje pas cekjes së shkaqeve të shkatërrimit të shtetit islam në Perëndim, eventualisht grindjet dhe përçarjet e vazhdueshme mes emirëve dhe sunduesve të Andaluzisë.

Në Lindje, gjendja ishte e kundërt dhe shkaqet ndaheshin në katër:

1. Presioni i Shtetit osman ndaj disa popujve evropianë.
2. Mbështetja në fuqi e zgjerim territorial dhe mosformimi i civilizimit islam në vendet e çliruara.
3. Trazirat brenda territoreve osmane, dhe
4. Zgjimi i Evropës, dorëzimi i popujve muslimanë dhe moskujdesi i udhëheqësve, sundimtarëve dhe emirëve muslimanë.

Para detajizimit të këtyre katër shkaqeve, globalisht do ta përshkruajmë gjendjen e vendeve tjera islame prej kohës së sulltan Sulejman Kanunit deri në kohën bashkëkohore.

Në kohën e sulltan Sulejmanit ekzistonin dy shtetet e para në Marokun e Perëndimit, shteti i Beni Tashefinit i dyti Shteti osman në Lindje.

Maroku ishte gjithmonë në luftë me mbretërit e Spanjës, kurse fiset luftonin ndërmjet vete edhe për shkaqe më të imëta, bile edhe sot gjendja është e njëjtë.

Shteti osman dominonte mbi të gjitha shtetet tjera islame si p.sh. Algjerin, Tunizin, Egjiptin, Emiratet, Irakun, Bagdadin, Persinë, Indinë, Emiratet turke dhe Emiratet e tatarëve, bile disa emirate kanë ngelur nën Shtetin osman deri në fillim të shek. XX, kurse disa të tjerë kanë fituar pavarësi dhe kanë shpëtuar prej sundimit osman me ndihmën e Evropës ose pa të.

Emiratet që kanë ngelur nën Shtetin osman janë: Algjeri, Tunizi, Egjipti, Iraku, kurse ato që kanë fituar pavarësi pa ndihmën e tjetërkujt janë: Persia, India, Emiratet turke dhe tatarë, si p.sh. Shagari, Bluxhistani, Hakandi, Karami, Turkistani, të cilët i kanë marrur Rusia dhe Anglia me fuqi.

Nuk mund të mohojmë se Shteti osman, në kohën e sulltan Sulejmanit i ka ngadalësuar këto emirate islame me dominimin e tij, ngase nuk u ka ofruar mundësi ta përforcojnë vetveten e as që u ka ndihmuar kundër sulmeve të armiqve, gjegjësisht të jenë nën mbrojtjen osmane. Sikur të vepronte kështu, të mos copëtohej shteti e të mos i sulmonte, sot do të ishte i zhvilluar, krenar, i fuqishëm dhe nuk do t'i jepte mundësi dominuese Evropës. Zgjerimi i Shtetit osman pa administratë dhe civilizim të pavarur ka shkaktuar lajthitje dhe shkatërrim në të gjitha emiratet derisa ka ardhur Evropa dhe i ka marrur për vete, p.sh. Shteti osman e ka sulmuar Persinë më shumë se dhjetë herë.

Persia nuk u qasej problemeve të brendshme, por vazhdimisht zhvillonte luftëra me osmanët.

Këto janë emërtimet e shteteve islame që ekzistojnë sot në tre kontinente: në Evropë, Azi dhe Afrikë, të varura e të pavarura deri në fillim të Luftës së Parë Botërore:

- I. Shteti osman - i pavarur,
- II. Maroku - i pavarur pastaj ka rënë nën sundimin e Francës pas kontratës së vitit 1911 mes Gjermanisë dhe Francës,
- III. Siria, Palestina, Jordani - pavarësi administrative, kurse politikisht nën Shtetin osman,
- IV. Algjeri - nën sundimin e Francës,
- V. Tunizi - nën sundimin e Francës,
- VI. Karmanët - nën sundimin e Ruisë,
- VII. Turkistani - nën sundimin e Ruisë,
- VIII. Kaukazi - nën sundimin e Ruisë.
- IX. Samarkanda, Hakandi, dhe Blukistani - nën sundimin e Ruisë,
- X. Afganistani - i pavarur,
- XI. Iraku - i pavarur,
- XII. Saudija - e pavarur,
- XIII. Zanzibari dhe Jemeni - nën sundimin anglez,

Këto janë shtetet islame që ekzistojnë deri në fund të famës islame ndërsa edhe pse ekzistojnë disa shoqëri islame, ato nuk kanë formë shteti ose emirati, disa janë të shpërndara nëpër ujdhesa e disa në Afrikë, por që të gjitha nën shtetet evropiane.

Na mbetet t'i analizojmë katër shkaqet e shkatërrimit të shteteve islame në Lindje, të cilat i cekëm në fillim të këtij kapitulli:

## **1. Presioni i Shtetit osman ndaj disa popujve evropianë**

Këtë presion që me të vërtetë është bërë, e gjejmë në historinë e betejave jeniçere në Ballkan, Hungari, Austri, pastaj edhe te emirët e detit si p.sh. Barbaros Hajrudin Pasha, Tor Gari, Ali Reisi, etj, të cilët bënë gabime që nuk i bëjnë njerëzit muslimanët, edhe pse udhëheqësit francezë, admirali italian Andrea dhe të tjerët bënë gabime edhe më të mëdha ndaj muslimanëve. Qëndrimet e tilla ishin traditë e asaj kohe mirëpo, udhëheqësit tanë kanë qenë të obliguar ta ndjekin rrugën e çliruesve të Islamit të hershëm për përfitimin e zemrave.

Sipas konkluzioneve historike, ne jemi të mendimit se këto gabime më vonë në qendrën e shtetit islam kanë ndikuar negativisht dhe e kanë rezultuar problemin e çështjes orientale dhe mbrojtjen e të krishterëve në Lindje.

Lexuesi hasë gabime të tilla më së shumti në periudhën e çlirimeve të sulltan Sulejmanit. Edhe pse sulltani nuk ishte dakord për ato çështje, ato ndodhnin pa dëshirën e tij dhe në kohën e mosprezencës së tij.

## **2. Mbështetja në fuqi e zgjerim territorial dhe moszhvillimi i civilizimit islam në vendet e çliruara**

Secili që e shfleton historinë e çlirimeve të Perandorisë osmane, eventualisht çlirimet e sulltan Sulejman Kanunit, vëren se Shtetit osman i mjaftonte vetëm çlirimi i ndonjë vendi ose

shteti dhe caktimi i guvernatorit osman ose obligimi me xhizje dhe haraç. **Shteti osman asnjëherë nuk ka bërë përpjekje që trojeve të çliruara t'ua imponojë gjuhën, fenë e as traditat dhe me kalimin e kohës t'i asimilojë në frymë islame, ashtu siç veprojnë sot shtetet kolonialiste me kolonitë e tyre!!!**

Osmanët kanë vepruar në mënyrë të tillë vetëm brenda territorit të tyre, si p.sh. te arabët, kurdët dhe shqiptarët ngase frikoheshin për hilafetin më shumë se çdo gjë tjetër. Si ta mbronin arabët hilafetin kur ata ishin dobësuar?

Sikur të vepronte kështu në të gjitha vendet që i kishte çliruar Sulejman Kanuni dhe pasardhësit e tij, të cilat vende shkëputeshin nga Shteti osman gjatë viteve të fundit të shek. XIX., ato sot do të ishin vende të pastra islame. Kështu vepronin sundimtarët arabë në çdo mbretëri që e çlironin.

Kemi shembullin e shtetit të Andaluzisë, Egjiptit, Etiopisë, berberëve, ku të gjithë muslimanët janë arabizuar individualisht dhe familjarisht me vullnet të lirë për shkak të pastërtisë së fesë islame dhe cilësive të saj.

Pas këtij pakujdesi të sulltanëve osmanë (kjo metodë është aplikuar në kohën e Muhammedit a.s., as'habëve (shokëve) të tij, halifëve emevitë dhe abasidë), vendet e çliruara ose të obliguara vetëm me haraç, në kohën e dobësimit të Shtetit osman janë ngritur kundër tij dhe gradualisht janë shkëputur aq shumë saqë mendohej se Shteti osman do të rikthehet në qendrën e tij origjinale në Azi.

Kush e analizon gjendjen e Maqedonisë sot dhe më parë, bindet në saktësinë e mendimit tonë, sepse bullgari, serbi e

greku dëshirojnë që shteteve të tyre t'u bashkangjitet ky shtet që ka fituar pavarësi.

Vijojnë emrat e shteteve që i ka çliruar Shteti osman e të cilat më vonë janë ngritur në kryengritje dhe në vite të ndryshme e kanë fituar pavarësinë:

I. Hungaria: ka fituar pavarësinë në vitin 1699 me kontratën e Karloviçit pas luftimeve,

II. Rumania: ka fituar pavarësinë në vitin 1878 me marrëveshjen e Berlinit,

III. Bullgaria e Rumelia Lindore: kanë fituar pavarësinë në vitin 1909 në kohën e proklamimit të kushtetutës osmane sepse e kanë shfrytëzuar gjendjen e trazuar në vendet osmane.

IV. Serbia: ka fituar pavarësinë në vitin 1878 me marrëveshjen e Berlinit,

V. Mali i Zi: ka fituar pavarësinë në vitin 1878.

VI. Greqia: ka fituar pavarësinë në vitin 1831 pas kryengritjes dhe ndërhyrjes së shteteve tjera.

Disa shtete dhe vende të tjera janë ndarë nën ndikimin e disa faktorëve të tjerë, e posaçërisht për shkak të dobësisë që e kishte kapluar Perandorinë osmane, mosaplikimit të sistemit të ri evropian dhe mungesës së bashkëpunimit me shtetet që ishin në zgjim e sipër. Shteti osman ua ka lëshuar shteteve tjera mundësinë e përparimit dhe progresit kurse vet i është dorëzuar dekadencës dhe pasivitetit.

Ato shtete janë:

I. Algjeri: Franca në vitin 1847 e ka okupuar atë nga Shteti osman, mirëpo, në kuptimin e osmanëve, ai konsiderohet ende shtet osman.

II. Tunizi: Franca e ka okupuar atë nga Shteti osman në vitin 1881,

III. Egjipti: është ngritur në kryengritje në vitin 1837, ka fituar pavarësinë administrative në vitin 1840 ndërsa në vitin 1882 bie nën okupimin anglez.

IV. Karamanet: i ka okupuar Rusia në vitin 1783, ndërsa e fituan autonominë në vitin 1884.

V. Persia: E okupoi Anglia në vitin 1908.

### **3. Trazirat brenda territoreve osmane**

Para se të vdesë sulltan Sulejman Kanuni (Zoti e mëshiroftë) nga dhembjet interne dhe vuajtjet e tij për shkak të vrasjes së djalit të tij Sheherzade Mustafa, grindjes së dy fëmijëve të tij, Selimit dhe Pajazitit, deri kur në fronin e sulltanatit erdhi sulltan Selimi i Dytë, trazirat e brendshme fillojnë të kulmojnë ngase ai, Zoti ia faltë, anonte kah jeta në shoqëri, kënaqësi dhe argëtim, pastaj shkonte me shokët e tij në pallatin e Xhubuklit dhe të Sulltanijes për të dëgjuar recitime e këngë. Sikur të mos ishte kryeministri i tij, Sokol Mehmet Pasha, pasojat e moskujdesit të tij do të kishin ndikim të madh në perandori.

Menjëherë pas vdekjes së tij dhe ardhjes së të birit, Muratit të Tretë, fillojnë trazirat në Persi dhe në ushtri të cilat ndikojnë shumë negativisht, dhe për fat të keq, qeveria nuk tregonte interesim për qetësimin e trazirave deri në kohën e sulltan Mahmudit i cili i qetëson mirëpo me vonësë sepse ato veçse e kishin dobësuar shumë perandorinë.

Më vonë merr hov edhe lëvizja vehabiste në juglindje të Anadollit, pastaj edhe kryengritja e Ali Pashë Tepelenës (i njohur në vendet shqiptare).

Problemi i katërt ishte ai egjiptas dhe kryengritja e Mehmed Ali Pashës (po ashtu shqiptar, N.A.), që kishte ndikuar tepër në organizimin e shtetit dhe e kishte lodhur.

Shteti osman pas qetësimit të ndonjë trazie, menjëherë ballafaqohet me trazira tjera.

Goditjet e fundit i mori prej kryengritjeve edhe luftërave të vazhdueshme sllave kundër Shtetit osman, derisa rezultoi problemi i çështjes orientale.

Kështu, Shteti osman dobësohet dhe paaftësohet derisa pas luftërave të rrepta merr fund çështja e tij.

#### **4. Zgjidhja e Evropës dhe pakujdesia e shteteve islame**

Derisa Shteti osman bënte përpjekje që t'i qetësojë trazirat e brendshme dhe derisa shtetet dhe emiratet tjera islame luftonin kundër njëri - tjetrit për çështje të kota, pra, derisa trazirat e kishin përfshirë tërë territorin islam, shtetet evropiane kishin filluar të zgjohen nga gjumi, të bashkohen, të përhapin shkencën, artin dhe industrinë dhe të udhëtojnë nëpër dete për zbulimin e vendeve dhe zgjerimin e tregtisë me qëllim pasurie dhe ekspansioni politik e fetar.

Sa herë që shtetet islame vonoheshin një hap në jetë, shtetet evropiane përparonin shumë hapa dhe kështu natyra e

relacionit mes Lindjes dhe Perendimit fillon të ndryshojë por në formë trishtuese.

Kur shtetet islame ishin shembull i përparimit, civilizimit dhe jetës së zhvilluar, Evropa ishte e thelluar në mosdije dhe dekadencë, kurse tash jemi shndërruar në Evropën e Mesjetës së errët dhe sot ajo luan rolin tonë.

Vetëm pas kalimit të disa viteve nga vdekja e sulltan Sulejmanit, u vërejtën këto dallime mes Lindjes e Perëndimit dhe është e ditur se deri ku kanë arritur ato sot dhe për këtë shkak historianët periudhën e sulltan Sulejmanit e konsiderojnë periudhë të fundit të çlirimeve islame dhe fillim i dekadencës së muslimanëve.

Mjerë për famën që e shkelëm ne me këmbët tona, për shtetet që i humbëm për shkak të injorancës dhe epsheve tona dhe arritëm në një nivel të ulët, kurse të tjerët na zëvendësuan dhe u ngritën në pedestalin e famës!!!

Vaj për gjendjen e Lindjes dhe për vendet islame!

All-llahut i mbështetemi dhe Atij i kthehemi!



**KREU I KATËRT**  
**REZULTATET E DOBËSIMIT**



## PJESA E PARË

### DEPËRTIMI I EVROPËS NË LINDJE

Depërtimi i vërtetë i shteteve evropiane në Lindje fillon në vitin 1760 gjatë kohës së sulltan Mustafa Hanit të Tretë dhe dalëngadalë i ka përfshirë katër të pestat e territorit islam, kurse vetëm një e pesta kanë ngelur vende tona (Zoti i mbroftë!).

#### *Periudha e parë: Kontrata e Kinarxhës*

Depërtimi i parë i Perëndimit në Shtetin osman fillon me sulmin e Ruisë në vitin 1774 që përfundon me marrëveshjen mes të dy shteteve e që njihet si Kontrata e Kinarxhës, sipas emrit të një qyteti në Rumuni dhe përmban 28 nene dhe dy nene sekrete.

Rezymeja e këtyre neneve është: pavarësia e vendeve të Karamanëve, Besarabisë, Tobanit dhe t'i dorëzohen Karamanit të gjitha vendet që i ka okupuar Rusia (të lehtësohet marrja e tyre në të ardhmen). Perandori rus e preferonte titullin "Padishah" gjatë bisedimeve të tij me Portën e Lartë dhe ua kishte kushtëzuar (osmanëve) këtë në kontratë. Osmanët kanë

qenë të obliguar t'i përgjigjen kërkesës së tij, pastaj anijet ruse të lundrojnë në Detin e Zi dhe në Mesdhe, Rusia të ndërtojë kishë në Alibejogllu - Stamboll dhe t'i mbrojë krishterët ortodoksë osmanë.

Padyshim, kjo kontratë është fitore e madhe e shtetit evropian ndaj atij osman edhe pse vërejtëm fuqinë (e Shtetit osman).

I pastër është Ndryshuesi i gjendjeve!

Dy nenet sekrete ishin këto:

1. Shteti osman obligohet të paguaj 15.000 qese si kompensim luftarak deri në fund të korrikut të vit. 1777,

2. Të lidhë kontratë me Rusinë se do t'i ofrojë ndihmë me kusht që Rusia t'i tërheq anijet prej ujdhesave bizantine.

Me këtë kontratë dhe injorancën e burrshtetasve osmanë në çështjet politike Rusia i ka realizuar të gjitha kërkesat e saj, e ka shkatërruar mbretërinë e Suedisë sipas këshillave të Petrit të Madh dhe kështu, para saj ka ngelur vetëm Shteti osman, ngase, sikur t'i kuptonte qëllimet e Ruisë dhe të bashkohej me Karlin e Dymbëdhjetë, mbret i Suedisë, i cili kishte ardhur në Stamboll, i kishte treguar qëllimet e Ruisë dhe kishte kërkuar të bashkohen për ta luftuar Rusinë, sot Rusia do të ishte e shkatërruar dhe nuk do të mendonin shtetet evropiane të na sulmojnë pas kësaj kontrate që e nënçmonte Shtetin osman me nenet e saj.

Më vonë u kuptua se Rusia kërkonte pavarësinë e Karamanit vetëm për t'ia bashkangjitur perandorisë pas përfundimit të luftës me osmanët.

*Periudha e dytë: **Bashkimi i disa shteteve evropiane për ndarjen e Perandorisë osmane***

Shtetet evropiane, qysh në kohët e lashta, ishin bashkuar fshehurazi për ta ndarë Perandorinë osmane dhe për ta shkatërruar. Rusia e realizoi qëllimin e saj me okupimin e vendeve të Karamanit dhe pas kontratës së Kinarxhës me të cilën garantohet pavarësia e Karamanit, ajo është përgatitur që ta sulmojë (Shtetin osman), mirëpo një shtet që ishte armik i Ruisë, e lajmëron Portën e Lartë të mos shpallë luftë për shkak të kontratës sekrete mes Ruisë dhe Austrisë<sup>1</sup>, që ishte lidhur ndërmjet perandores ruse Katarina dhe perandorit austriak Zhozefi i Dytë për ta sulmuar Shtetin osman dhe për të formuar qeveri të pavarur që do të qëndrojnë mes tyre dyve dhe Shtetit osman që do të përbëhej prej Felahit, Bagdadit dhe Besarabisë dhe do ta udhëheqë mbreti ortodoks, pastaj Rusia ta merr limanin Osakov dhe disa ujdhesa bizantine kurse Austria ta merr Serbinë, Bosnjën e Hercegovinën dhe Dalmacinë. Pasi që Austria i ka marrur të gjitha ato vende, Rusia e merr edhe Greqinë me dy ujdhesat: Kretën dhe Qipron, kurse Evropës do t'i japin pjesë tjera të Shtetit osman ashtu si do ta vendosin më vonë.

Nëse të dy shtetet korrin sukses dhe depërtojnë në Stamboll, do ta rikthejnë Perandorinë Bizantine ashtu siç ka qenë para

---

<sup>1</sup>Këtu qartësohet injoranca politike e politikanëve osmanë ngase ata nuk dinin se çfarë kontratash lidheshin në Evropë, ashtu siç kishte ngjarë edhe me Rifat Pashën, përgjegjës i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit osman, i cili nuk kishte njohuri për kontratën e vitit 1911 mes Ruisë dhe Gjermanisë për hekurudhën Bagdad - Iran;

zgjerimit osman, kurse Konstantini caktohet perandor me kusht që të tërhiqet nga Rusia që të mos i udhëheqë Perandorinë Ruse dhe atë bizantine vetëm një njeri...<sup>2</sup> Pas bindjes së Shtetit osman se ekziston një kontratë e tillë, nuk i shpallë luftë Ruisë por bashkëpunon me shtetin që e informon. Sipas historisë së Xhevdet Pashës, ky shtet ishte Franca, kurse sipas historisë së Muratit, mbretëria e Suedisë, apo mbreti suedez Gustavi i Tretë për shkak të dëmeve të mëdha të atëhershme nga Rusia.

Kur osmanlinjtë nuk i shpallin luftë Ruisë, ajo ia bashkangjet vetes vendet Karamane në vitin 1774. Pas abstenimit të Shtetit të Lartë, Rusia e rrethon kështjellën "Suastibul", përkundër kontratës së lidhur, dhe i dërgon spiunët e saj në Felah dhe Bagdan për t'i nxitur krishterët kundër shtetit me qëllim që të hyjnë në luftë me Shtetin osman dhe së bashku me Austrinë t'i realizojnë qëllimet e veta, të cilat i cekëm pak më parë.

Këto lëvizje armiqësore ruse preknin në nderin e Shtetit osman dhe për këtë shkak, Shteti osman vendosë ta befasojë Rusinë me një sulm të rreptë para se të përgatitet ajo për luftë. Për të gjetur shkak lufte, kërkon prej ambasadorit të ruisë në Stamboll të quajtur Xholkakof, në vitin 1787, që shteti i Ruisë t'ia dorëzojë Moro Kodanon, guvernator i Felahit, i cili ishte ngritur kundër Shtetit osman e pastaj ishte fshehur në Rusi dhe të tërhiqet (Rusia) nga Kaukazi ngase ai territor është nën mbrojtjen osmane. Gjithashtu i ka ndërruar konsujt e saj, pastaj ka vendosur që Porta e Lartë t'i kontrollojë anijet ruse

---

<sup>2</sup>Shiko: "Historia e Shtetit osman".

që kalojnë nëpër ngushtica, konfiskimin e armëve dhe municionin luftarak si dhe disa gjëra tjera të vështira.

Si do t'i pranonte Rusia këto vendime kur dihet se ajo, në kohën e Katarinës, e cila i ngjante Petrit të Madh, ndjekte një politikë kategorike? Pas refuzimit të Ruisë, Shteti osman i shpallë luftë Ruisë, mirëpo në të njëjtën kohë, Austria i shpallë luftë Shtetit osman, dhe kështu ky shtet lufton kundër dy amiqve të rreptë, kurse në anën tjetër, Gustavi i Tretë, mbret i Suedisë, i shpallë luftë Ruisë për t'i kthyer territoret e humbura.

Kështu, me ndihmën e All-llahut, Shteti osman korrë fitore dhe e shkatërron Austrinë në kështjellën e Timishoarës dhe Beogradit, kurse perandori Zhozefi i Dytë ikë dhe e braktisë tërë ushtrinë në vitin 1789.

Gjatë këtyre ngjarjeve, vdes sulltan Abdulhamidi i Parë (në vitin 1203/h) kurse në vend të tij vjen sulltan Selimi i Tretë. Megjithatë, zjarri i luftës mes Shtetit osman dhe dy shteteve (Rusia dhe Austria) nuk është shuar. Pas një kohe, udhëheqësi rus dhe ai austriak i bashkojnë ushtritë, e sulmojnë ushtrinë osmane dhe korrin fitore. Rusët e okupojnë pjesën më të madhe të Melahit, Bagdanit dhe Bisarabisë, kurse austriakët Beogradin dhe e çlirojnë pjesën më të madhe të territorit të Serbisë.

Shteti osman bie në një fatkeqësi të madhe sepse lufton kundër dy shteteve të fuqishme, kurse shpëtimi mund të vijë vetëm prej All-llahut!

Pas vdekjes së Zhozefit të Dytë, perandor i Austrisë, në fillim të vitit 1790, në vend të tij vjen Leopoldi i Dytë, i cili ishte i obliguar të kërkojë ndërmjetësimin e disa shteteve për ta

ndalur luftën me Shtetin osman dhe t'i qaset pengimit të revolucionit të brendshëm që mund të reflektohej nga revolucioni francez në kohën e Luit të Gjashtëmbëdhjetë, dhe kështu, lidhin kontratë më 4 gusht 1791, me të cilën Austria ia kthen të gjitha vendet Perandorisë osmane.

### **Kontrata e Zeshtvisë**

Vijon teksti i rezymuar i kontratës:

1. Lidhet kontrata e përhershme paqësore në tokë e në det mes Shtetit osman dhe Austrisë, amnestohen të dënuarit politikë të të dy palëve, e posaçërisht ata të Bosnjës, Malit të Zi dhe Serbisë;
2. Marrëdhëniet mes dy mbretërive do të zhvillohen ashtu siç kanë qenë në kohën e kontratës së lidhur në Beograd dhe kontratës së 7. majit të vitit 1775, me të cilën tërhiqet nga Bukvini.
3. Shteti osman do t'i mbrojë anijet tregtare të Austrisë dhe Gjermanisë nga kesarët e Perëndimit, tregtarët e Austrisë do të kenë liri të plotë në të gjitha viset e Shtetit të Lartë dhe të gjitha vendimet dhe fermanet të aplikohen.
4. dhe 5. Austria do t'ia kthejë Shtetit osman të gjitha vendet dhe kështjellat që i ka okupuar prej tij, municionin e konfiskuar dhe kështjellën e Shotimit kur të përfundojë lufta osmano-ruse.
6. Këto kështjella do t'i dorëzohen Shtetit osman brenda 30 ditëve, të vendosen kufijtë e mëparshëm dhe të rrënohen kështjellat e ndërtuara gjatë periudhës së luftës, edhe atë gjatë afatit dymujorë.

7 dhe 8. Pasi që shteti austriak ia kthen të gjithë ushtarët dhe civilët e robëruar Shtetit osman, atëherë edhe Porta e Lartë ia kthen të gjithë robërit austriakë që gjenden brenda Shtetit osman, ashtu që të mos mbetet asnjë nën shtetin e tjetërkujt përpos atyre që janë islamizuar dhe krishteruar, muslimanët mbeten në Shtetin osman kurse të krishterët në shtetin austriak.

8. Të drejtat e tregtarëve kthehen ashtu siç kanë qenë, huadhënësi ka të drejtë të kërkojë atë që i takon qoftë edhe para lufte dhe gjyqet obligohen t'i verifikojnë këto procese.

10. dhe 11. Të dy shtetet do të orvaten t'i mbrojnë kufijtë e vet dhe t'i qetësojnë trazirat që mund të shkaktohen brenda të dy shteteve si dhe t'u ndihmojnë banorëve vendas e të huaj (austriakëve në Shtetin osman dhe osmanëve në Austri) gjatë udhëtimeve tregtare.

12. Liria e praktikimit fetar katolik, liria e priftërve, restaurimi i kishave dhe liria e vizitës së vendeve të shenjta në Jerusalem (Kudus), mbrojtja e këtyre vendeve dhe vizita e tyre dhe se Porta e Lartë i ripërtërinë të gjitha privilegjet e fesë katolike që janë garantuar me kontrata dhe fermane të hershme.

13. Secila palë i dërgon njëra-tjetrës ambasadorë që i prezantojnë shtetet e tyre dhe trajtohen me respekt të plotë. Ata dërgohen për t'i ripërtërirë marrëdhëniet mes dy shteteve, kurse Shteti osman do të bëjë përpjekje që të sigurojë lumturinë e atyre që vijnë nga pallati austriak në vendet osmane.

### *Periudha e tretë - Kontrata e Bashit*

Rusia vazhdimisht e ka luftuar Shtetin osman, e ka okupuar qytetin Ismaili dhe i ka maltretuar banorët e tij aq shumë sa që e tejkaloj maltretimin italian në Tripoli. Për këtë, Shteti osman është shqetësuar mirëpo ndërhyjnë Anglia, Gjermania dhe Holanda dhe më në fund çështja përfundon me lidhjen e kontratës në vitin 1792/ 1206/h. me të cilën Ruisë i mbeten vendet Karamane, një pjesë e Kaukazit, Bisarabisë dhe provincat mes lumenjve Buxh dhe Deniber dhe kërkohet tërheqja e Shtetit osman nga qyteti Osakov.

Kjo marrëveshje njihet si "Kontrata e Bashit", sipas emrit të qytetit ku është nënshkruar.

Pas përfundimit të këtyre luftërave Shteti osman përqëndrohet në reforma të brendshme, mirëpo me një vonesë të madhe, ngase shtetet e Perëndimit veçse e kishin tejkualuar në shumë periudha. Kështu fillon me sistemimin e ushtrisë sipas modelit evropian, me instruktorë evropianë, gjë që ndikon negativisht në ushtrinë jeniçere, e cila revoltohet pas vdekjes së sulltan Sulejman Kanunit, gjatë kohës së Abdulhamidit të Parë, Selimit të Tretë dhe Mustafës së Katërt. Ushtria jeniçere nuk mund t'u bënte ballë ushtrive të sistemuara evropiane në një anë, e as që i respektonte urdhërat e emirëve dhe sulltanit në anën tjetër. Kështu, shpeshherë shprehnin revoltën dhe protestën në mënyrë publike.

Sipas historianëve, revolta e jeniçerëve konsiderohet si një ndër shkaqet e decadencës së Shtetit osman gjatë shekujve të fundit si dhe e kanë nxirrë historinë e tyre të hershme të bardhë

e përplotë me trimëri dhe fuqi gjatë çlirimeve të sulltanëve, në kohën e Kanunit dhe të tjerëve.

Anulimi i ushtrive të vjetra në kohën e sulltan Mahmudit të Dytë për shkak të çrregullimit dhe josistematizimit të tyre të brendshëm, ka shkaktuar katastrofë që ka mundur ta shkatërrojë Perandorinë osmane.

Kur sulltan Selimi i Tretë përpiqej të aplikojë disa arte dhe zbulime të reja ushtarake në vendin e tij dhe kishte hapur fabrika për prodhimin e armëve si p.sh. pushka e topa etj, përpos reformave tjera të nevojshme për shtetin që të barazohet me shtetet evropiane në progres, papritmas befasohet me kryengritjen e Osman Pashës, vali në Serbi i cili njëherit edhe i inkurajon lëvizjet kryengritëse në emirate dhe vilajete, herë mes vete e herë kundër sundimtarëve të tyre, gjë që ka shkaktuar dobësimin dhe dekadencën.

Sulltani ishte i obliguar ta qetësojë këtë gjendje të rrezikshme me plotësimin e kërkesave të këtij valiu, eventualisht e caktoi si vali deri në vdekje. Ashtu ka vepruar edhe me emirët dhe valitë tjerë duke u premtuar se do t'i realizojë kërkesat e tyre.

### *Periudha e katërt: Sulmi i Napoleonit*

Derisa ngjarjet në Perandori zhvilloheshin ashtu siç u cek më parë papritmas përhapet lajmi i hyrjes së Napoleonit në Egjipt në vitin 1798/1213 h. me ushtri dhe me anije të mëdha, edhe atë duke e okupuar Aleksandrinë, Kajron dhe Port-Saidin pas pengesave të vogla me memelukët.

Napoleoni deklarohet se nuk ka ardhur në Egjipt për t'i edukuar memelukët (argument më i keq se mëkati, sepse

memelukët nuk kanë qenë kryengritës!). Kur kupton Shteti i Lartë, hidhërohet nga ky sulm për shkak se me Francën ishin aleatë të ngushtë, e ndiente veten të sigurt prej saj dhe këshillohej me te në rastet kritike. Kjo befasi ishte e mirëseardhur për të sepse i anulon kontratat dhe e drejton ushtrinë kah Egjipti në koalicion me Anglinë dhe Rusinë. Anglia i bashkohet Shtetit osman për shkak të frikës nga depërtimi i Napoleonit në Indi, kurse Rusia për t'u hakmarrë ndaj armikut të saj. Kështu fillon lufta mes Nelsonit (admiral anglez) i cili me sukses e shkatërron flotën franceze dhe e fundosë në betejën Ebu Kajr, kurse Napoleoni rrethohet në Egjipt.

Kur dëgjon Napoleoni për fundosjen e flotës së tij dhe bashkimin e osmanëve, anglezëve dhe rusëve për ta luftuar atë, dëshiron ta sulmojë Sirinë për t'i penguar qëllimet e Shtetit osman dhe kështu nisët për në Palestinë me 13.000 ushtarë, e okupon Gazën, Remlin, Jafan dhe Akkan në vitin 1213 h, mirëpo në vazhdim pëson disfatë dhe detyrohet të kthehet në Kajro pa e realizuar qëllimin. Pastaj udhëton papritmas në Francë. Nën kontrollin e Anglisë ushtria osmane dhe angleze fillojnë t'i deportojnë francezët nga Egjipti në vitin 1801 me anije angleze, kurse Egjipti sërisht bëhet osman, ashtu siç ishte më parë.

Napoleoni nuk shqetësohet por kontakton përsëri me Shtetin osman (pasi që caktohet kryetar në Republikën e Francës) dhe lidhë kontratë në vitin 1801<sup>3</sup>. Kjo kontratë përbëhet prej katër neneve vijuese:

---

<sup>3</sup>Shiko: "Kamus ibni Xhel-ladin"

1. Lidhet paqja mes të dy shteteve dhe francezët i gëzojnë privilegjet që u jepen të huajve në Egjipt,
2. Republika e Francës pranon formimin e Republikës së Algjerit dhe të vendeve të hershme të Venedikut,
3. Dy shtetet vendosin mënyrën e caktimit të pasurisë së konfiskuar para lufte dhe lirohen të gjithë të burgosurit,
4. Ripërtërihen kontratat e hershme mes Portës së Lartë dhe Francës ndërsa të drejtat tregtare vazhdojnë ashtu siç kanë qenë më parë.

### *Periudha e pestë: Trazirat e brendshme*

Pos trazirave të jashtme që zhvilloheshin në Perandorinë osmane gjithashtu edhe trazirat e brendshme luanin rol të rëndësishëm, e posaçërisht ato të vitit 1217-h/1803 në kohën e sultan Sellimit të Tretë, që përfundojnë me revokimin e sultan Selimit të Tretë dhe me ardhjen e Mustafës së Katërt në vend të tij. Më vonë edhe ky revokohet dhe e zëvendëson sultan Mahmudi i Dytë.

Këto trazira të brendshme janë pasojë e intrigave të të huajve e posaçërisht në territoret e serbëve dhe shqiptarëve, sepse gjatë luftës osmano-ruse shumë njerëz prej Maqedonisë emigronin në Hungari dhe luftonin me Austrinë kundër Shtetit osman. *Pas përfundimit të luftës kthehen në vendlindje por të mbushur në zemrat e tyre me shembuj të të huajve për kërkim të pavarësisë, kurse jeniçerët i maltretonin për shkak të këtyre ideve, dhe më në fund, serbët çohen në kryengritje dhe e fitojnë pavarësinë.*

*Në të njëjtën kohë, territoret e shqiptarëve ishin përplot trazira e kryengritje, p.sh. valiu i Shkodrës dhe ai i Delvinës çohen në kryengritje kundër shtetit për të fituar pavarësi por nën ndikimin dhe nxitjen e Ruisë. Mirëpo Shteti osman i qetëson me sukses pas përpjekjeve të mëdha. Pastaj është ngritur udhëheqësi i Maqedonisë, Ali Pasha i cili ishte me prejardhje romake, i ka luftuar kryengritësit që i kishte nxitur Rusia me intrigat e veta dhe i ka nënshtruar derisa shteti e cakton vali të Rumelisë. Pasi që ky post ishte i lartë, vendosë të kërkojë pavarësi dhe ndahet në Epir - Janinë, mirëpo pushteti e vret Ali Pashën dhe gjendja qetësohet. Pas një kohe në Rumeli paraqiten grupe të armatosura e të fuqishme, të cilat i shkatërron shteti pas përpjekjeve të shumta. Menjëherë pas qetësimit të gjendjes në Rumeli, serbët ngrihen në kryengritje në vitin 1806 dhe kërkojnë pavarësi. Kështu, intrigat evropiane e posaçërisht ato ruse vazhdimisht përhapeshin në Maqedoni dhe popujt e ballkanit çoheshin në kryengritje të kohëpaskohshme kundër Shtetit osman derisa ky i shpall luftë Ruisë.*

Para se ta paraqesim zhvillimin e kësaj lufte, të përqëndrohemi në veprimin e jeniçerëve. Ata, edhe pse ekzistonin trazirat dhe tronditjet në shtet, çohen në kryengritje kundër Shtetit osman për shkak se sulltan Selimi i Tretë e aplikonte sistemin ushtarak evropian. Sulltani detyrohet t'i plotësojë kërkesat e tyre, mirëpo ata e tejkalojnë kufirin e normales dhe e revokojnë atë në vitin 1807/1223-h.

Në luftën osmano-ruse, që shpallet për shkak të intrigave të dyta në Maqedoni, bashkohet Anglia me Rusinë kundër osmanëve për ta shkatërruar Napoleonin që kishte lidhur

kontratë me osmanët. Kështu, flota angleze depërton në Dardanele dhe lokalizohet para Kelipotit nën udhëheqjen e admiralit Arbonthot, i cili për herë të fundit ia tërheq vërejtjen sulltanit dhe kërkon prej tij t'ia lëshojë vilajetet e Falahit dhe Bagdanit të Ruisë, kurse ambasadori i Francës (Sebastijani) dëbohet, e në anën tjetër u shpallë luftë osmanlinjve.

Sulltani refuzon një kërkesë të tillë dhe fillon të përgatitet për pengimin e kthimit të flotës angleze, gjë që e frikon admiralin anglez dhe e detyron të ikë në Detin Mesdhe. Admirali për t'u hakmarrë, e sulmon Egjiptin por pëson disfatë dhe kthehet i mposhtur me humbje të mëdha kah fundi i marsit të vitit 1807, edhe atë, duke iu falënderuar trimërisë së Mehmed Ali Pashës (shqiptar, N.A.) vali i Egjiptit. Gjatë kësaj lufte janë vrarë 600 ushtarë dhe janë djegur dy anije luftarake.

Rusia, edhe pas largimit të admiralit anglez nga Dardanelet, vazhdimisht luftonte kundër osmanëve në Falah dhe Bagdan...

Trazirat jeniçere, revokimi i sulltan Selimit të Tretë dhe caktimi i Selimit të Katërt në vend të tij në një anë dhe përgatitja e Ruisë kundër Napoleonit në anën tjetër, përfundojnë luftën osmano-ruse sepse ndërhyrja Napoleoni dhe Rusia obligohet ta braktisë Falahin dhe Bagdanin, mirëpo pas një kohe, ajo përsëri kthehet në ato dy vilajete dhe e rifillon luftën me osmanët.

Rusia hyn në luftë për shkak të marrëveshjes sekrete që ishte lidhur mes Aleksandrit të Parë, car i Ruisë dhe Napoleonit, perandor i Francës, dhe me të cilën ishte vendosur që Franca të bashkohet me Rusinë nëse Porta e Lartë nuk i plotëson kërkesat e tyre dhe t'i armatosin të gjitha vilajetet e Shtetit osman në Evropë (përveç Stambollit) duke i caktuar edhe

Austrisë një pjesë të vogël. Me atë kontratë parashihej që Franca ta merr vilajetin e Bosnjës, territoret shqiptare, greke, maqedone, pastaj Austrisë t'i jepen territoret arabe kurse Rusisë Falahi, Bagdanin Bullgaria dhe territori deri në lumin Marica<sup>4</sup>.

Ky është komploti i dytë i shteteve të Evropës për ndarjen e territoreve osmane, por, ku janë marrëveshjet e Napoleonit me osmanët dhe ndihmat e duarve të pastra që i ishin ofruar atij dhe Francës!?!...

E gjithë kjo përfundon me ambiciet bonapartiane politike e pastaj edhe me ato të republikës franceze, mirëpo këtu ekziston një mësim për osmanlinjtë që të mos i besojnë ndonjë shteti evropian ngase Evropa nuk ia dëshiron të mirën Shtetit osman. Më mirë do të ishte sikur të mos mbështetej në këto shtete, që dëshironin vetëm përfundimin e Perandorisë osmane; ajo mendon ndryshe e punon ndryshe, gjë që e vërteton vet historia!

Gjatë rrjedhave politike, zhvillohen edhe trazira të brendshme, gjegjësisht jeniçerët çohen në kryengritje kundër sulltan Mustafës të Katërt dhe e revokojnë për shkak të reformave ushtarake sipas metodave evropiane, pra edhe ky sulltan përfundon sikur sulltan Selimi i Tretë. Ai revokohet më 5 Xhumadijël-ula 1223 dhe në vend të tij caktohet vëllai i tij sulltan Mahmudi i Dytë i cili nuk kalon më mirë se dy sulltanët e mëparshëm, Selimi dhe Mustafa, ngase jeniçerët ende vazhdojnë kryengritjet e tyre e posaçërisht kur dëgjojnë se sulltan Mahmudi i Dytë do ta aplikojë parimin e sulltanëve të

---

<sup>4</sup>Shiko: "Tarih Lafalija anid-devletil-uthmanijeti",

mëparshëm në sistemimin e jeniçerëve dhe do t'i ushtrojë me taktikat moderne ose do t'i anulojë për shkak të paaftësisë së tyre gjatë luftës osmano-ruse dhe mosnjohjes së taktikave ushtarake. Kështu, kur dëgjojnë një gjë të tillë, vendosin ta revokojnë sulltan Mahmudin e Dytë pas vrasjes së Mustaf Pashës, udhëheqës i lëvizjes reformiste.

Edhe pse ushtria e rregullt qeveritare orvatet t'u përballojë, jeniçerët vendosin ta djegin Stambollin nga disa anë dhe kështu, pasi që sulltan Mahmudi i Dytë frikohet nga shkatërimi i kryeqendrës, detyrohet t'i pranojë kërkesat e tyre. Pastaj u qaset lidhjeve paqësore me Anglinë dhe Rusinë që përfundojnë me kontratën e Bukureshtit për ta reformuar territorin e tij të brendshëm.

Me këtë kontratë, Rusia ia kthen Shtetit osman vilajetet Falah dhe Bagdan dhe vendet serbe mirëpo shpejton dhe e merr Besarabinë, gjë që ndikon negativisht në popullin serb dhe kështu çohet në kryengritje, mirëpo shteti e qetëson pas formimit të "Sobranjes" në krye me Millosh Obrenoviçin, edhe atë në vitin 1817.

Koha nuk e lejon këtë shtet t'i rregullojë çështjet e brendshme dhe të jashtme sepse vazhdimisht fillojnë të zhvillohen trazira, probleme politike dhe kryengritje derisa dobësohet fuqia e tij dhe dominojnë shtetet që kishin ambicie kundër këtij shteti. Këto çështje që zhvillohen nuk mund t'i përshkruajë as lapsi!

Gjatë kësaj periudhe paraqitet një problem i ri i njohur si "Çështja lindore", vetëm për shkak se Shteti osman nuk e ka përhapur gjuhën dhe civilizimin e tij nëpër territoret evropiane që ishin nën dominimin e tij.

Trazirat zhvilloheshin herë mes muslimanëve e herë mes shtetit dhe vendeve të çliruara. Menjëherë pas përfundimit të kryengritjes serbe, sulltan Mahmudi ballafaqohet me kryengritjen e vehabitëve prej vitit 1228 deri më 1234 sipas hixhretit. Vehabitët përfaqësojnë një lëvizje që e udhëhiqte Shejh Abdulvehabi i Hixhazit. Ai ishte arab i shkathët, i sjellshëm dhe ka bërë ixhtihad pas hulumtimeve të shumta në bazat e katër shkollave juridike islame dhe në parimet parësore e dytësore të usuli fikhut, posaçërisht në medhhebin hanefit. Shumë arabë i bashkangjiten dhe për këtë shkak, sulltan Mahmudi duke u frikuar nga trazirat dhe përçarjet e muslimanëve, e dërgon Mehmed Ali Pashën (vali i Egjiptit) për t'i luftuar, kurse valiu i Egjiptit e autorizon Tosun Pashën për sulm ushtarak në Hixhaz kundër vehabitëve, që ishin ngritur në kryengritje (sepse valiu Mehmed Ali Pasha ishte lodhur me memelukët në Egjipt).

Tosun Pasha pasi që nuk ka patur sukses në sulmet e tij, kthehet në Egjipt, kurse në vend të tij, Mehmed Ali Pasha e dërgon Ibrahim Pashën. Ibrahim Pasha udhëton deri në Nexhd, i rikthen të gjitha territoret e Perandorisë osmane, e zen udhëheqësin e vehabitëve, Shejh Abdull-llah ibn Sa'udin dhe e dërgon në Stamboll, ku edhe vdes.

Ibrahim Pasha pas kryerjes së misionit të tij kthehet në Egjipt. Se pas çdo trazire shkaktohej trazira tjetër argumenton edhe e dhëna se pas nënshtrimit të vehabistëve, sulltan Mahmudi ballafaqohet me kryengritjen e Ali Pashës në Epiros (të cilin e cekëm pak më parë). Ai fortifikohet në malet e Epirosit, mirëpo Shteti osman e vret dhe e masakron pas refuzimit të

respektimit të urdhërave të sulltanit, pos asaj që ai kishte lidhje me udhëheqësit e kryengritjes së Greqisë.

Për këtë, sulltani urdhëron të dërgohet një ushtri e fuqishme, nën udhëheqjen e Hurshid Pashës, i cili e rrethon, e zen dhe ia pren kokën të cilën pastaj e dërgon në Stamboll.



## **PJESA E DYTË**

### **ÇËSHTJA ORIENTALE**

#### *Faza e parë: Fillimi i çështjes orientale*

Cekëm më parë se sulltan Mahmudi i Dytë i ka përjetuar kryengritjet e kurdisura që zhvilloheshin në të gjitha viset e Perandorisë dhe çdoherë kur bënte përpjekje për reforma shtetërore, fillonin trazira në ndonjë vend. Pas vrasjes së Ali Pashës dhe qetësimit të trazirave të tjera, udhëheqësit e Greqisë janë ngritur në kryengritje për të kërkuar liri dhe pavarësi publikisht, kurse në realitet dëshironin të çlirohen nga Shteti osman. Këtë lëvizje e ka nxitur Aleksandri i Parë, car i Rusisë, për të shkaktuar trazira të brendshme në Shtetin osman dhe ta arrijë qëllimin, eventualisht ta "çlirojë" Stambollin, për të cilin kishte porositur Petri i Madh. Këtë e argumenton edhe formimi i shoqatës sekrete greke "Hiterija" nga vet cari rus edhe atë në Kijev dhe në Odesë, bile vetë ai e financonte me të madhe me të hollat e tij personale. Kjo shoqatë aktivizohet në mbarë Greqinë ndërsa numri i anëtarëve të saj në vitin 1821

arrinë në më tepër se 20000 vetë dhe shumica e tyre i takonin "rinisë" përparimtare greke.

Pasi që udhëheqësit e kësaj shoqërie e vërejnë preokupimin e Shtetit osman me Ali Pashën e Janinës, çohen në kryengritje kurse Shteti osman e dërgon Hurshid Pashën, vrasësin e Ali Pashës mirëpo pëson disfatë në Dhul-hixhxe të vitit 1237/gusht 1822<sup>1</sup>, gjë që e pikëllon shumë dhe bën vetëvrasje.

Marinarët grekë me sukses e kishin djegur flotën osmane në Sakuzë dhe kishin vrarë tre mijë ushtarë osmanë, kurse osmanët, të prekur shumë, fillojnë t'i vrasin dhe t'i masakrojnë banorët e ujdhesave Samos dhe Sakuzë sepse u kishin ndihmuar grekëve, si dhe i rikthejnë të dy ujdhesat prej grekëve, mirëpo jehona e kësaj ngjarjeje depërton në Evropë dhe i nxitë disa shtete të ndërhyjnë (siç do të shohim në vazhdim). Prej këtu fillon çështja orientale, eventualisht prej vitit 1821/1236 h.

## **Ç'është çështja orientale**

Çështja orientale do të thotë ndërhyrja e shteteve të mëdha evropiane në çështjet e shtetit lindor evropian (osman) gjatë kryengritjes së Greqisë, e pastaj gjatë kryengritjeve ballkanike krishtere që zhvilloheshin me intrigat e disa shteteve evropiane kundër Shtetit osman derisa t'u mundësohet një intervenim i

---

<sup>1</sup>Në historinë e Sinoposit, transmetohet se një udhëheqës grek, i quajtur Karadijas, ka sulmuar në vitin 1821 në Ruman, gjeçjesisht në Kahlas, i ka shkatërruar xhamitë dhe publikisht ka kërkuar vrasjen e muslimanëve.;

tillë në çështjet e brendshme të Shtetit osman, me pretekst se duan t'i mbrojnë krishterët në Lindje duke u mbështetur në kontratat e sulltanëve osmanë me ato shtete.

Çështja ishte e tillë sipërfaqësisht kurse në thelb qëllimi i tyre për mbrojtjen e krishterëve në Lindje ishte vetëm për ta copëtuar Perandorinë osmane, dhe këtë e verejtëm edhe para fillimit të çështjes orientale kur Rusia dhe Austria bashkohen në një anë dhe Rusia me Francën në anën tjetër për ta copëtuar territorin osman.

Çështja orientale i prezentonte idetë e Evropës në mënyrë publike, pasi që ishin harruar një kohë dhe kishin qenë të përkufizuara vetëm në qytetet e mëdha kurse tash Rusia, Austria, Franca, Anglia, Italia dhe Gjermania fillojnë t'i kërkojnë territoret osmane. Disa prej tyre kërkonin Maqedoninë, disa Egjiptin kurse disa Tripolin e kështu me radhë, dhe sikur të mos grindeshin në kërkesat e tyre, do të zhdukej Shteti osman mirëpo, All-llahu xh.sh. shkakton mosmarrëveshje mes tyre në kohë të ndryshme dhe e mbron shtetin prej intrigave të tyre.

Çështja orientale është formuar në vitin 1821 gjatë kryengritjes së Greqisë, posaçërisht gjatë masakrave që kanë ndodhur mes muslimanëve dhe jomuslimanëve ngase Aleksandri i Parë rus i ka shprehur ngushëllimet e veta sulltan Mahmudit të Dytë kurse në anën tjetër, i ka thirrur shtetet evropiane të mbajnë kongres në Petrograd. Kështu, kongresi mbahet në janar të vitit 1824, kur Rusia kërkon ndarjen e Greqisë në tre emirate të pavarura, mirëpo kërkesa e saj refuzohet dhe mbaron vetëm me pranimin e Shtetit osman dhe grek në mënyrë të lirë e jo të imponuar edhe atë në prill të vitit 1825. Në këtë kongres caktohet Anglia

të ndërmjetësorë me sulltan Mahmudin e Dytë që t'i plotësojë kërkesat e grekëve edhe atë me ndihmën e Ruisë. Për ta realizuar këtë qëllim, Sir Willingtoni, ambasador i Anglisë në Petrograd, lidhë kontratë me Rusinë dhe e lajmërojnë Portën e Lartë. Në atë kontratë kërkohej që sulltan Mahmudi i Dytë t'u ofrojë grekëve administratë të pavarur, me kusht që t'i paguajnë Shtetit osman xhizje normale çdo vit.

Kur arrinë kjo kontratë te Porta e Lartë, ajo e refuzon kategorikisht, ngase nuk pranon ndërhyrjen e shteteve në çështjet e Shtetit osman. Për shkak se kjo përgjigje ndikon shumë në shtetet evropiane, bashkohen rreth kësaj çështje<sup>2</sup> në prill të vitit 1827.

### **Beteja e Navarinit dhe Kontrata e Edrenesë**

Rusia, Anglia dhe Franca i kanë dërguar anijet e tyre në gjirin grek Navarin për t'u bërë ballë anijeve osmane e egjiptase dhe i kanë dërguar Portës së Lartë paralajmërim për përfundimin e luftës në Greqi, si dhe t'i jep Greqisë pavarësi administrative. Porta e Lartë ka refuzuar dhe është shqetësuar për shkak të ndërhyrjes joligjore. Shtetet evropiane pas refuzimit të Portës së Lartë, e kanë sulmuar flotën osmane dhe e kanë fundosur më 2. tetor 1827.

Franca, Rusia dhe Greqia janë gëzuar nga ky rezultat dhe kanë organizuar festivale argëtuese popullore përpos popullit anglez, i cili ka shprehur keqardhje për këtë katastrofë, kurse qeveria

---

<sup>2</sup>Shiko: "Historia politike" e Karl Senijojos.;

angleze pos ngushëllimeve e ka ndërruar admiralin e vet mirëpo turpin e Evropës nuk kanë mundur ta fshijnë asnjëherë.

Kjo ngjarje ka ndikuar në sulltan Mahmudin e Dytë aq shumë sa që menjëherë u shpallë luftë këtyre shteteve dhe ka kërkuar prej tyre kompensim e falje, mirëpo ato nuk i janë përgjigjur dhe kështu ka shpërndarë në popullin osman një proklamati në të cilën thuhej: "Shtetet e huaja duan të ndërhyjnë në çështjet e perandorisë sonë në emër të fesë e jo të politikës, ngase ne jemi shteti i vetëm islam që ka ngelur në Evropë dhe Azi, mirëpo si të luftojë një shtet kundër tre shteteve të mëdha e të bashkuara". Ata ende janë në luftë me grekët, Franca ka dërguar 15.000 ushtarë dhe e ka okupuar Greqinë Jugore, Rusia i ka okupuar disa vende në Anadoll kurse me një ushtri tjetër edhe Rumelinë deri në Edrene, kurse Anglia e ka bindur Ibrahim Pashën egjiptas (me prejardhje shqiptare), të cilin e kishte autorizuar Shteti osman në vitin 1825 për t'i luftuar grekët, që të kthehet në Egjipt dhe është kthyer në gusht të vitit 1828.

Kështu, Shteti osman bie në gjendje kritike ngase pjesa më e madhe e territorit të tij ishte nën okupimin e Ruisë dhe të Francës dhe detyrohet të lëshojë pe para këtyre tri shteteve dhe atë me nënshkrimin e kontratës së Edrenesë me Rusinë në shtator të vitit 1829, gjë që shkakton problemin e çështjes orientale, kurse Rusia fillon t'i realizojë ambiciet e saj në Lindje.

Çështja orientale vazhdon të zhvillohet edhe më tepër prej vitit 1832 e deri më sot.

Transmetohet se Nikolla i Parë, car i Ruisë, pas realizimit të këtij qëllimi, e ka vizituar Anglinë, ku u ka propozuar

politikanëve ta copëtojnë shtetin e "sëmurë" (Shtetin osman), mirëpo Anglia ka refuzuar jo nga dashuria ndaj osmanlinjve por nga frika se mos zgjerohet autoriteti rus në Lindjen e Afërt e t'ia rrezikojë kolonitë në Indi.

Me kontratën e Edrenesë, është formuar çështja orientale, Evropa ka korrur sukses kundër Shtetit osman, disa vilajete osmane janë copëtuar, anijet osmane janë djegur në Navarin për shkak të intrigave evropiane dhe udhëheqësi egjiptas, Ibrahim Pasha është obliguar ta braktisë Greqinë dhe të kthehet me ushtarakët e tij në Egjipt.

Me kontratën e Edrenesë kërkohet që Greqia të fitojë pavarësi brenda kufijve të caktuar.

Shtetet e mëdha e kanë pranuar pavarësinë e saj në vitin 1830 në Kongresin e Londrës. Në të kërkohet gjithashtu pavarësia administrative e arabëve, Falahit dhe Bagdanit, kurse t'i jepen Rusisë disa ujdhesa të Danubit, Shteti osman të mos i pengojë anijet ruse në grykën e Bosforit dhe të Dardaneleve, liria e tregtisë ruse në të gjitha limanet e Detit të Zi, pastaj Shteti osman t'i jep dëmshpërblim lufte Rusisë.

Për shkak të dobësimit të pasurisë shtetërore, Shteti osman ia ka mundësuar Rusisë t'i realizojë qëllimet e saja politike.

Një ndër faktorët tjerë që e detyruan Shtetin osman ta pranojë kontratën e Edrenesë është edhe kryengritja e jeniçerëve. Ne cekëm më parë se trazirat e brendshme e kanë dobësuar trupin e perandorisë, bile konsiderohen edhe si faktorë të rënies dhe dekadencës së saj.

Në fund, sulltan Mahmudi vendosë, pas ngjarjeve të kurdisura që i cekëm më parë, t'i eliminojë këta njerëz të dëmshëm nga Shteti osman dhe urdhëron të vriten deri në fund.

Më 8 Dhul-ka'de 1240 ose në vitin 1826 e shkatërron këtë njësi të dëmshme dhe e zëvendëson me ushtri moderne sipas sistemit evropian, pastaj ndërton akademi ushtarake dhe përpiqet të aplikojë reforma të mëdha mirëpo papritmas shqetësohet nga Mehmed Ali Pasha, vali i Egjiptit ngase ky kërkon pavarësi.

Me këtë kërkesë të Mehmed Ali Pashës, çështja orientale prezentohet në një formë të dytë: "Për shkak të kërkesës së këtij valiu përsëri ndërhyjnë shtetet e Perëndimit".

### *Faza e dytë: Çështja orientale*

#### **Kryengritja e Mehmed Ali Pashës**

Ende pa e përfunduar luftën me Rusinë dhe vrasjen e jeniçerëve, sultan Mahmudi i Dytë fillon të interesohet për reformimin e çështjeve të Perandorisë, sepse si një mjek i shkathët e me përvojë, komponon një civilizim të lartë me civilizimin evropian dhe atë islam, fillon me reformat në ushtri, e ndërton uniformën e vjetër turke me atë të ushtrisë së huaj, e përdorë fesin (torbushin), bile në vitin 1837 ka caktuar ligj për mjekrën dhe mustaqet, mirëpo kur i qaset reformës administrative shtetërore nuk gjenë në mesin e muslimanëve "elitë përparimtare".

Derisa ai mendonte për metodat e reformës dhe anulimin e nënçmimit nga kontrata e Edrenesë e befason Mehmed Ali Pasha, vali i Egjiptit, i cili e dërgon ushtrinë nën udhëheqjen e

të birit Ibrahim Pasha në Siri. Shkaku i kryengritjes së Mehmed Ali Pashës qëndron aty se ai ka kërkuar prej sulltan Mahmudit kompensim për ushtrinë tokësore dhe detare që ia kishte ofruar Shtetit osman gjatë luftës me Greqinë, mirëpo nuk ka mundur ta plotësojë premtimin për shkak të okupimit të territorit grek nga ushtritë e tri shteteve.

Muhammed Alia i ka kërkuar territoret e Shamit kurse sulltani nuk ka pranuar dhe nuk i ka lejuar të luftojë për ekspansionizëm, mirëpo ai nuk e ka dëgjuar dhe kështu, ka filluar të depërtojë në vendet tjera arabe dhe të veprojë si të ishte sulltan legjitim për shkak të famës dhe tiranisë së tij.

Kur sulltani e refuzon kërkesën e tij nisat dhe e okupon Akkën, mirëpo Porta e Lartë, për të mos e vlerësuar një akt të tillë, e konsideron si grindje mes valiut të Egjiptit dhe atij të Akkës, dhe e urdhëron të kthehet me ushtrinë e tij në Egjipt. Mehmed Ali Pasha insistonte në kërkimin e vilajetit të Sirisë dhe bashkangjitjen e tij Egjiptit dhe për këtë, sulltani urdhëron edukimin e tij. Ibrahim Pasha e kishte realizuar dominimin në Akkë, Tripoli dhe Haleb vetëm me 30.000 ushtarë në vitin 1832, kurse sulltan Mahmudi i dërgon 60.000 ushtarë nën udhëheqjen e Husein Pashës, mirëpo Ibrahim Pasha ngadhënjën vetëm brenda 20 ditësh.

Jehona e kësaj kryengritjeje depërton në Evropë, posaçërisht pas kërkesës së Mehmed Ali Pashës drejtuar sulltanit që ta merr Sirinë dhe Anadollin ose të luftojë në Stamboll.

Sulltan Mahmudi dërgon një ushtri të re nën udhëheqjen e Reshid Pashës kundër Ibrahim Pashës dhe konfrontohen në Konja, mirëpo Reshid Pasha pëson disfatë kurse ushtria e tij robërohet, dhe kështu, Mehmed Ali Pasha sundon në Anadoll,

Siri, Egjipt dhe në vendet tjera, edhe atë me ndihmën e fanatizmit të dervishëve në territoret osmane që kërkonin të vazhdojë gjendja ashtu siç ka qenë para periudhës së reformave në kohën e sulltan Mahmudit. Ata e nxitnin popullin kundër shtetit dhe e preferonin sundimin e valiut Mehmed Ali Pashës.

Ibrahim Pasha gjatë udhëtimit të tij për në Anadoll thotë: "Do të shkoj deri te kufijtë e fundit ku lexohet gjuha arabe", dhe siç dihet, gjuha arabe përfundonte në lumin Danub të Evropës Qendrore ngase pjesa dërrmuese e muslimanëve e njihnin gjuhën arabe, qoftë edhe vetëm leximin arab.

Ibrahim Pasha i afrohet gradualisht Stambollit ndërsa edhe Evropa frikohet prej luftës së përgjithshme.

Ndër më të gëzuarit për fitoret e Mehmed Ali Pashës ishte populli francez, i cili e quante "Napoleoni i Lindjes", por me qëllime të tërthorta, kurse cari i Ruisisë, Nikolla i Parë, mendonte ndryshe sepse frikohej prej çlirimeve të komandantit egjiptas dhe hyrjes së tij në Stamboll. Kështu ai ia rrënon të gjitha ëndrrat për okupimin e kësaj kryeqendre dhe ia bashkangjet Anadollin Egjiptit.

Për këtë shkak vendosë t'i bëjë ballë Ibrahim Pashës dhe t'i ndihmojë Shtetit osman, që pas fitores ta shfrytëzojë dobësinë e Perandorisë e të kërkojë kërkesa më të levërdishme. Për ta realizuar këtë ide, i ka ndihmuar edhe depërtimi i Ibrahim Pashës me ushtrinë e tij në Brusë, gjë që e shqetëson shumë sulltan Mahmudin dhe e detyron të kërkojë ndihmë prej Ruisisë. Cari i Ruisisë, Nikolla i Parë, veçse ishte duke pritur një kërkesë të tillë dhe menjëherë dërgon 12.000 ushtarë në Stamboll dhe i përqëndron në Yskydar, një flotë ruse kah

hyrja në Stamboll dhe 30.000 ushtarë tjerë hyjnë në Maqedoni nga Rumania.

Suksesi i Rusisë në Lindje i shqetëson Francën dhe Anglinë, kurse Austria nuk ka reaguar ngase ka kërkuar prej Rusisë t'i lejojë të zgjerohet në Gjermani dhe Itali.

Franca fillon ta shfrytëzojë autoritetin e saj në Stamboll me ndihmën e ambasadorit, admiralin Rusen, që ta pengojë Portën e Lartë e të mos kërkojë ndihmë prej Rusisë, kurse në anën tjetër, kërkon prej Mehmed Ali Pashës të mos depërtojë në Anadoll.

Anglia praktikon metodë tjetër për pengimin e qëllimeve të fshehta të Rusisë ndaj Shtetit osman dhe kështu vendosë së bashku me Rusinë dhe Austrinë që ta detyrojë Muhammed Aliun ta pranojë ofertën e Portës së Lartë, ndërsa Muhammed Aliu insiston në bashkangjitjen e Sirisë dhe Adanës me Egjiptin.

Kur ai sheh<sup>3</sup> se ushtria ruse është vendosur në disa vise të Anadollit dhe se anijet angleze që lundronin në ujërat e Aleksandrisë i kërcënoheshin me sulm, atëherë pranon t'i jepet

---

<sup>3</sup>Disa thonë se ai pretendonte fronin e sulltanit, kurse disa të tjerë se ai nuk i ka theksuar të metat e administratës osmane dhe korrupsionin e funksionarëve. Mehmed Ali Pasha gjithashtu u ka thënë evropianëve që ishin në Aleksandri: "A e dini rezultatin në qoftë se copëtohet territori osman? I gjithë populli islam ikë prej meje e në krye të tij edhe i biri im, mirëpo sulltani nuk din se ç'vepron dhe e gjithë kjo është dënim prej Zotit". Historiani i njohur austriak Ostin thotë se Muhammed Aliu i ka thënë përfaqësuesit anglez në Egjipt kur ka kërkuar prej tij (Muhammedit) të shpallë pavarësinë: "Unë dua të jem shërbyes i sulltanit edhe në qoftë se hyn i biri im Ibrahim i në Stamboll".

Siria atij kurse vilajeti i Hirmanit djalit të tij, Ibrahim Pashës, ashtu siç kërkonin shtetet prej Portës së Lartë.

Kështu Ibrahim Pasha kthehet tek i ati i tij me ferman të sulltanit edhe atë pas kontratës së Kotahisë të lidhur më 5 maj 1833. Ushtria ruse tërhiqet nga Stambolli më 10 korrik 1883 pas kontratës së Ankarasë mes Portës së Lartë dhe Ruisë, që është lidhur më 8 korrik 1833, kur Rusia vendosë t'i ofrojë ndihmë eventuale ushtarake gjatë periudhës së ardhshme tetëvjeçare, kurse Porta e Lartë vendosë ta mbyllë ngushticën por jo edhe për anijet ruse që lundronin me liri të plotë.

Me këtë kontratë Shteti osman tërthorazi bie nën mbrojtjen e Ruisë.

Nëse dëshirojmë t'i shqyrtojmë shkaqet e kryengritjes së Mehmed Ali Pashës dhe rezultatet e saj, do ta theksojmë vetëm atë që e ka thënë historiani austriak Ostin. Sipas tij, shkaqet e kësaj lëvizje janë: administrimi i gabuar dhe reformat shtetërore, mirëpo sipas historianëve osmanë, *kryengritja e Mehmed Ali Pashës kundër hilafetit, në realitet është rezultat i intrigave të funksionarëve francezë që jetonin në shoqërinë e tij*, ngase Franca, sipas historisë politike të Evropës, dëshironte ekspansion në Lindje, posaçërisht pas okupimit të Algjerit, dhe për këtë kërkonte prej francezëve që ishin në Egjipt ta nxisin Ali Pashën për okupimin e Sirisë. Ata e quanin "Napoleoni i Lindjes" dhe i premttonin ndihmë ushtarake, përsosjen e ushtrisë së tij dhe zgjerimin e flotës, derisa bie në kurthë e çohet në kryengritje kundër halifit. E gjithë kjo përfundon me ndërhyrjen e shteteve evropiane dhe me ripërtërirjen e problemit të çështjes orientale.

Mehmed Ali Pasha e vëren rrezikun e pozitës së Sulltanatit të Lartë dhe zhgënjimin e vet me intrigat e të huajve, e posaçërisht me ato franceze dhe fillon të deklarojë atë që e transmeton historiani austriak, eventualisht, e mohon copëtimin e territorit osman, deklaron se ai është shërbyesi më i sinqertë i sulltanit dhe kënaqet vetëm me kërkimin e Sirisë dhe vilajetit të Adanës. Qëllimi i ardhshëm i Francës ishte gjithashtu okupimi i Egjiptit dhe Sirisë.

Sulltan Muhmudi i Dytë pasi e vëren qëllimin serioz të Mehmed Ali Pashës dhe e ndien veten të nënçmuar për shkak të okupimit të Muhammedit në tri vilajete osmane, në vitin 1839 përgatitë një ushtri nën udhëheqjen e Hafidh pashës.

Kur ushtria osmane arrinë në vendin Nesibejn, më 11. Rebi'uth-thani 1253 ose në vitin 1839, konfrontohet me ushtrinë egjiptase, ku pas një beteje të ashpër, ushtria osmane pëson disfatë të thellë kurse Ibrahim pasha ngadhënjën.

### **Sulltan Abdurmexhidi**

Kur në Stamboll arrinë lajmi i disfatës së ushtrisë osmane, sulltan Mahmudi i Dytë veçse kishte vdekur kurse në vend të tij ishte caktuar sulltan Abdurmexhidi edhe atë më 20. Rebi'uth-thani 1255.

Qëndrimin e Shtetit osman ndaj Mehmed Ali Pashës e keqëson edhe më tepër përgatitja e një flote nën udhëheqjen e Ahmed Pashës për rrethimin e bregdetit të Egjiptit dhe dorëzimi i këtij udhëheqësi detar në duart e Mehmed Ali Pashës pa kurrfarë konflikti luftarak. Shteti osman për pak do t'i pranonte kërkesat e Muhammed Aliut: caktimi i udhëheqjes

së tre vilajeteve për pasardhësit e tij (me nxitjen e Francës, ashtu siç cekëm më parë), mirëpo Anglia ndërhyrë dhe nuk e lejon një pëlqim të tillë. Shteti osman, nga frika se mos fillon përsëri lufta në Anadoll, kërkon ndihmë prej Ruisë, sipas kontratës së Ankarasë, e cila eventualisht mund të hyjë në Anadoll e të mos kthehet. Ndërkohë, Austria kërkon prej shteteve evropiane që Porta e Lartë të mos vendosë pa këshillimin me Evropën<sup>4</sup>. Kërkesa e saj pranohet dhe informohet Porta e Lartë mirëpo një vendim i tillë nuk i pëlqen Francës dhe fshehurazi përpiquej ta bindë Mehmed Ali Pashën të mos pranojë. Ajo tentonte që sundimi i Anadollit, Sirisë dhe i Egjiptit të kalojë në duart e fëmijëve të Mehmed Ali Pashës, mirëpo Morstoni, ministër i Punëve të Jashtme të Anglisë, në vitin 1840 i tubon të gjithë ambasadorët e shteteve në Londër, përpos ambasadorit të Francës dhe nënshkruajnë një kontratë që përbëhej prej pesë neneve.

1. Mehmed Ali Pashës i lejohet vetëm sundimi i Egjiptit dhe i Shamit Jugor,
2. Anglia dhe Austria kanë të drejtë ta dëbojnë ushtrinë e Egjiptit prej bregdetit të Sirisë,
3. Flotat luftarake të Anglisë, Ruisë dhe Austrisë kanë të drejtë të hyjnë në Stamboll për ta mbrojtur prej Mehmed Ali Pashës dhe Ibrahim Pashës.
4. Askush nuk ka të drejtë të hyjë në Stamboll derisa nuk i kërcënohet Stambollit rreziku.
5. Të gjitha shtetet ta miratojnë këtë kontratë gjatë afatit dymujor.

---

<sup>4</sup>Shiko deri ku ka arritur ndërhyrja evropiane në Lindje për shkak të kryengritjes së Mehmed Ali Pashës.

Franca me këtë vendim shqetësohet aq shumë saqë ishte në gjendje të luftonte kundër atyre shteteve, mirëpo i dështojnë shpresat kur hyjnë anijet e Anglisë dhe të Austrisë në Bejrut më 3. tetor 1840, të cilat e detyrojnë Ibrahim Pashën të kthehet në Egjipt.

Pastaj ia kanë dorëzuar Mehmed Ali Pashës vendimin e sundimit të tij vetëm në Egjipt dhe kanë kërkuar prej tij që flotën osmane t'ia dorëzojë Portës së Lartë duke ia zëvendësuar atë me sundim trashëgues, Porta e Lartë të mos ndërhyjë në zgjedhjen e trashëgimtarëve pas vdekjes së Mehmed Ali Pashës kurse Shteti osman të merr prej të ardhurave të Egjiptit vetëm një të katërtën si dhe Egjipti të mos caktojë eprorë pa vullnetin e sulltanit.

Pasi që Mehmed Ali Pasha të gjitha këto vendime i refuzon, ndërhyjnë Franca dhe shtetet tjera evropiane dhe zgjidhet mosmarëveshja kurse sulltan Abdulmexhidi shkruan edhe një ferman më 1 qershor të vitit 1841<sup>5</sup>.

Shtetet pastaj e shpallin përfundimin e çështjes egjiptase me vendimin e katërshit, kurse me kërkesën e Francës dhe Anglisë, lidhet kontrata e Ngushticës mes shtatë shteteve të mëdha më 23. Xhumadijel-ula 1257 apo në vitin 1841 në vend të kontratës së Hankarit që lidhet mes Ruisë dhe Shtetit osman.

---

<sup>5</sup>Pastaj, vijojnë caktimet e kufijve, etj.

Në atë ferman theksohej që ushtria e Egjiptit të ketë vetëm 18.000 ushtarë, hadijevitët të kenë të drejtë zgjedhjeje deri në gradën e admiralit, të mos ndërtohen anije luftarake pa lejen e Portës së Lartë dhe t'i paguaj çdo vjet një shumë prej 10.000.000 frankash.

Kjo kontratë përbëhet prej katër neneve, të cilat Rusia i pranon me vërejtje.

1. Ekselenca e sulltanit ka të drejtë të pengojë hyrjen e secilës anije luftarake në ngushticë gjatë kohës së paqes, kurse gjashtë shtetet e mëdha obligohen ta respektojnë vendimin e ekselencës së sulltanit.

2. Sulltani ka të drejtë të shkruaj fermane për lejimin e kalimit të disa anijeve të vogla luftarake që janë në shërbim të ambasadave me lidhje shoqërore.

3. Ekselenca e sulltanit ka të drejtë të kërkojë prej shteteve tjera që kanë marrëdhënie shoqërore të veprojnë sipas kësaj kontrate,

4. Shtetet e interesuara për këtë çështje e aprovojnë këtë kontratë pas kalimit të afatit dymujor nga nënshkrimi i saj në Londër.

Nga e gjithë kjo që u cek, lexuesi e kupton mënyrën e formimit të çështjes orientale në fazën e dytë, që është më katastrofale se në fazën e parë, mirëpo në anën tjetër edhe pozitive, ngase ndërhyrja e disa shteteve ishte deri diku në favor të sulltanatit osman.



## **PËRFUNDIM**

### **KUR DO TA RIPËRTËRIJNË MUSLIMANËT FAMËN E TYRE TË LARTË**

Pasi që populli musliman sot i imiton popujt e Perëndimit dhe largohet nga elementet që mund t'ia kthejnë autoritetin dhe famën, mendimi korrekt është ai i çrrënjosjes së dekadencës dhe dobësisë prej çështjeve tona të brendshme e politike dhe aplikimi i metodave të shëndosha që shpiejnë në bashkim dhe udhëheqje, që janë më se të nevojshme sot.

Nëse vendosim të përparojmë derisa të arrijmë në nivel të njëjtë me popujt e civilizuar dhe ta rikthejmë pozitën tonë që është e zhytur në thellësitë e moskujdesit dhe copëtimit qysh para disa shekujve, atëherë obligohemi që pos asaj që theksova në këtë libër, t'i hedhim një vështrim kritik gjendjes sonë të tashme.

Nëse kthehemi pak prapa apo para pesë shekujsh dhe e vështrojmë gjendjen politike dhe pozitën e Evropës dhe Amerikës, gjejmë se përpjekja për liri dhe kryengritja kundër tiranisë për të fituar pavarësi me ndihmën e bashkimit, kanë qenë një ndër detyrat më të rëndësishme për pjesën dërrmuese të të dy kontinenteve, eventualisht për këtë kanë luftuar: Xhorxh Uashingtoni në Amerikë, Garibaldi në Itali, Bismarku

në Gjermani, Lenini në Rusi etj., dhe kanë mundur të formojnë vend të fuqishëm e të bashkuar dhe popuj të bashkuar që as koha nuk mund t'i ndajë, as periudhat e turbullta e as befasitë politike, pa marrë parasysh sa i madh është rreziku dhe sa vazhdojnë katastrofat, edhe atë duke iu falënderuar udhëheqjes së tyre të fuqishme.

Edhe sipërfaqja dhe numri i banorëve të Siujdhesës Arabike nuk mund të krahasohen me ato të Ruisë apo të Amerikës, por a thua vallë ka aftësi kjo siujdhesë ta realizojë shpresën e secilit arab, që është uniteti i vendeve arabe prej Oqeanit deri në Gji, e prej Jemeni deri në Toros!

Kjo përpjekje e rëndësishme dhe fisnike shpresoj se së shpejti do të realizohet dhe se do të mbretërojë fama, fuqia dhe autoriteti!

Bota e muslimanëve rrotullohet në gjithësi dhe në fund të rrotullimit do të jetë fillimi, nëse All-llahu dëshiron!

O vend i shenjtë, zgjohu!

*Aty ku bie hilafeti, aty edhe ringjallet* (N.A.)

Recensent:  
Nuredin AHMETI

Lektor-korrektor:  
Fatmire AJDINI - HOXHA

Përgatitja kompjuterike dhe shtypi: *FOCUS*

Spored misleweto na Ministerstvoto za kultura br.08-1845/2 od 09.03.1995 za *Islamot vo tekot na poslednite vekovi vo Andaluzija i Osmanskoto carstvo* se pla]a povlastena dano~na stapka.

Sipas mendimit të Ministrisë për Kulturë nr. 08-1845/2, të datës 09.03.1995 për *Islami gjatë shekujve të fundit në Andaluzi dhe në Perandorinë Osmane* bëhet pagesa e lehtësuar tatimore.